



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 PRILL 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. APRILA 2019. GODINE**

**PRILL - APRIL
2019**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me zbrazjen e vendit nga të rinjtë, si rreziku më i madh që i kanoset vendit që nga paslufta

Dnevni red

2. Parlamentarna rasprava u vezi odlaska mladih sa Kosova, kao najveća opasnost koja preti zemlji nakon rata

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme me kërkesë të 41 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në sallë të pranishëm janë aktualisht 62 deputetë, mund të vazhdojmë.

Të nderuar deputetë,

Para se të procedojmë me rendin e ditës të kësaj seance, ju njoftoj me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, për ish-deputetin Nezir Çoçaj, i cili zëvendësohet nga deputeti Rafet Rama.

E ftoj deputetin Rafet Rama që ta japë betimin.

Unë do ta lexoj tekstin e betimit, ndërsa deputeti në fund e shqipton fjalën “betohem”.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!

RAFET RAMA: Betohem!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit! Lus deputetin që personalisht ta nënshkruajë tekstin e Deklaratës së betimit dhe menjëherë t’ia dorëzojë Sekretarisë së Kuvendit.

Menjëherë po e shfrytëzoj këtë moment, në bazë të nenit 63 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i PDK-së propozon për anëtar të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë deputetin Rafet Rama, në vend të deputetes Xhevahire Izmaku, është votim formal.

Votohet, nuk është askush kundër. Faleminderit!

Jemi në debat parlamentar, me pikën e vetme të rendit të ditës, e kemi seancë të jashtëzakonshme:

1. Debat parlamentar lidhur me zbrazen e vendit nga të rinjtë, si rreziku më i madh që i kanoset vendit që nga paslufta

Të nderuar deputetë,

41 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me zbrazen e vendit nga të rinjtë, si rreziku më i madh që i kanoset vendit që nga paslufta.

E ftoj zotin Fidan Rekaliu, si iniciator të kësaj ideje që në emër të propozuesit të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debat parlamentar.

Urdhëro, deputet i nderuar!

FIDAN REKALIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në angazhimet tona si deputetë, ndodh të ballafaqohesh me tema dhe fakte, të cilat shpesh dëshirojmë edhe të mos i pranojmë si të tilla.

Por, fatkeqësisht ato qëndrojnë, madje edhe të vërtetuara e të shifruara nga institucione vendore e ndërkombëtare, siç është së fundmi dukuria e braktisjes së Kosovës nga qytetarët e saj.

E, veçanërisht është brengosëse ikja e të rinjve.

Krahas problemeve të shumta dhe sfidave nëpër të cilat po kalon vendi, ikja e qytetarëve nga shteti i tyre është gjëja më e keqe që po i ndodh Republikës së Kosovës.

Në angazhimet e mia, si deputet, kryesues i Grupit Joformal të deputetëve të rinj, por edhe si kryetar i Forumit të Rinisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, pjesë kryesore e punës time është bashkëpunimi me të rinj, të angazhuar qoftë në forume rinore politike, shoqëri civile, organizata studentore dhe të rinjtë në përgjithësi.

Në turneun tim të fundit të vizitave nëpër regjione të ndryshme të Kosovës, gjatë bashkëbisedimit me të rinj, temë dhe shqetësim kryesor ishte çështja e ikjes së të rinjve nga Kosova, për në shtetet e Evropës, në kërkim të një jete më të mirë.

Secili nga ne i kemi të njohura arsyet pse të rinjtë tanë po largohen nga Kosova. E ajo kryesorja është paperspektiva për një jetë normale. Kurse brengat e shqetësimet fillojnë që nga cilësia e

dobët e arsimit që ofrohet në të gjitha nivelet në vend, e deri te problemi kryesor - pamundësia për ta siguruar një vend të punës, pasi të kenë mbaruar nivelet më të larta të studimeve universitare.

Gjendja e krijuar nga afera e skandale të punësimeve familjare e grupe partiake, me të vetmin kriter çelësin partiak e familjar, është edhe një faktor shtesë që vret motivin dhe ëndrrën e fundit për të qëndruar në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është i dhimbshëm fakti se Kosovën po braktisin edhe të rinj të shkolluar e të profesionalizuar, të cilëve vendi i tyre nuk ua dha as mundësinë më të vogël për t'u dëshmuar.

Për me keq, nga vendi po largohen edhe njerëz të punësuar, bile edhe në institucione publike. Po largohen mjekë e inxhinierë, jo pse nuk e kanë të siguruar ekzistencën materiale.

Ata po ikin, sepse institucionet e vendit të tyre nuk garantojnë as arsim cilësor, as mbrojtje të duhur shëndetësore, as perspektivë për fëmijët e tyre.

Bazuar në publikimet e fundit nga institucionet e respektuara statistikore, del se qytetarët e Kosovës prijnë sa i përket dëshirës së tyre për t'u larguar nga vendi.

Të nderuar politikëbërës,

Pavarësisht përpjekjeve për të minimizuar këtë problem, pavarësisht vrapit për të bërë krahasime me vitin 2014 dhe 2015, kur po ashtu kishim një valë migrimi, pavarësisht nxjerrjes së shifrave e statistikave, çfarëdo qofshin ato, që do të provonin të tregojnë të kundërtën, nga Kosova po largohen qytetarë të moshave e profesioneve të ndryshme.

Shqetësimi kryesor është dëshira për të ikur nga ky vend pjesa më vitale dhe e ardhmja e vendit. Kosovës po i ik rinia, Kosovës po i ik e ardhmja!

Së bashku me kolegë deputetë thirrëm këtë seancë të jashtëzakonshme, duke e ditur se pas saj nuk do të ndodhë mrekullia, e ndoshta as ndonjë ndryshim në kokat e atyre që kanë ndarë mendjen të kërkojnë çdo rrugë e mundësi për të ikur nga ky vend. Mirëpo nuk guxojmë të mbylлим sytë e të bëhemi sikur gjithçka është mirë dhe asgjë nuk po ndodh.

Shumica e të rinjve po largohen me viza dhe për qëllime pune në shtete të ndryshme të Evropës. Dhe, është e drejtë fundamentale e secilit të kërkojë një jetë më të mirë, duke e ditur paperspektivën që vendi i tyre ua ofron dhe duke marrë për bazë faktin se ne mbetemi vendi më i izoluar në Evropë.

Kjo që po ndodh do të duhej të ishte një nxitje për më shumë vullnet e dëshirë që ta përdorim këtë seancë për të kërkuar nga secili prej nesh, e veçmas nga Ekzekutivi i vendit të ndërmerren hapa të shpejtë dhe konkretë që rrisin mundësitë e të rinjve për punësimin dhe trajtim të dinjitetshëm në vendet e tyre të punës.

Në punësimet në sektorët publikë të heqim dorë nga kriteri familjar e politik. Të fokusohemi në kuadro të shkolluara e profesionale, të cilët mund t'i japin shumë vendit, duke iu dhënë atyre shpresë dhe mundësi.

Ikja e të rinjve nga vendi është një problem që tejkalon përmasat e angazhimit të një individi, një subjekti apo institucioni.

Kjo çështje kërkon angazhimin e të gjithëve, sepse kemi të bëjmë me rrezikun më të madh që po i kanoset Kosovës që nga paslufta. Zbrazja e Kosovës është e keqja më e madhe që mund t'i ndodhë këtij vendi.

Për fund dua të kërkoj nga të gjitha grupet parlamentare politike, të cilat janë në Kuvend, që ta propozojnë bashkërisht një rezolutë unifikuese për mbrojtjen dhe avancimin e të rinjve në Republikën e Kosovës.

Faleminderit, i nderuar kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Naser Rugova, në emër të grupit parlamentar.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ishte vërtet momenti i fundit që Kuvendi i Republikës së Kosovës, ne si të zgjedhur të popullit, që nga ky tempull dalin edhe institucionet kryesore të këtij vendi, t'i adresojmë brengat, problemet, arsyet dhe trendët jashtëzakonisht shqetësues të ikjes së pjesës më vitale të qytetarëve të vendit tonë, përfaqësues të të cilëve jemi ne këtu.

Deputeti Rekalju, si i ri dhe si deputet ndër më të rinjtë me moshë këtu, në konsultim edhe me grupin tonë parlamentar, por edhe me kolegët e tjerë deputetë këtu, që përfaqësojnë moshën e re në Kuvendin e Republikës së Kosovës, vërtet duhet sot që nga kjo seancë e jashtëzakonshme që nuk presim mrekulli, të tentojmë të dërgojmë mesazh unifikues, pa marrë parasysh pozitë apo opozitë, te njerëz të rinj, te profesionistët, te teknokratët, të cilët çdo ditë po e lëshojnë Kosovës, po i lënë bosh vendet e tyre të punës, e në veçanti në sektorin e shëndetësisë, të arsimit, mësimdhënës të spikatur universitarë dhe teknokratë të tjerë, për të cilët kjo shoqëri, ky vend, me

mund ka investuar, i ka edukuar, janë bërë profesionistë të lëmenjve të veta dhe në momentet kur më së shumti i duhen vendit, ikin në adresa të tjera.

Prandaj, pa dashur të adresoj kritika, pa dashur të bëj me gisht në adresa institucionale, sepse të gjithë si klasë politike, përfshirë edhe mua kemi hise, nëse mund të shprehem me zhargonin popullor, në këtë degradim moral politik, institucional, kulturor, socio-kulturor, akademik, çfarëdo quani.

Prandaj, zoti kryetar i Kuvendit, fatkeqësisht këtu nuk është, përpos ministrit të Mjedisit, as kryeministri dhe asnjë pjesëtar tjetër i Qeverisë që kanë përgjegjësi direkte. Ku është ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ku është ministri i Arsimit që ka një peshë të jashtëzakonshme për temën që sot po e diskutojmë, por s'dua ta ashpërsoj gjuhën, duhet të unifikohemi dhe kësaj rinie dhe një pjesë të studentëve që i kemi në lozhë atje, t'u tregojmë që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet të jenë të hapur, transparent, të ndikojnë në subjektet e tyre politike, te mekanizmat dhe ministrat që i kanë në institucione që të mos e vrasin shpresën se kjo rini e ditur, e shkolluar, me ambicie, me ëndrra do vetëm trajtim të barabartë. Në Kosovë është vlarë shpresa viteve të fundit me vendime paradoksale, me punësime, me degradim të sistemit arsimor, ju lutem, kemi më shumë universitete publike se sa shkolla profesionale dhe ku ndodh kjo në botë? Edhe në vendet më të zhvilluara, me demokraci të zhvilluar, vetëm 25 deri 30% e studentëve elitë vazhdojnë studimet, dalin profile profesionale, e ndihmojnë vendin, i avancojnë ato fusha dhe ecin tutje.

Mbase, e kemi dëmtuar shumë klimën e investimeve, investimet e huaja direkte, pa të cilat ky vend nuk do të mund të ecë tutje. Është përmendur shumë edhe izolimi i Kosovës, i rinisë, i profesionistëve, i popullit, i bizneseve. Nuk është problemi i vetëm liberalizimi i vizave dhe nga kjo foltore u bëj apel Bashkimit Evropian, miqve tanë ndërkombëtarë jemi populli më i vjetër i kontinentit të vjetër, i vetmi shtet i izoluar. Pse po ndodh kjo?

Prandaj, këto që i thashë, besoj që i tha edhe deputetë Rekalit dhe kolegët e tjerë që do t'i thonë këtu, duhet të këndellemi si klasë politike, si njerëz të zgjedhur, si njerëz që populli dhe në veçanti rinia pret nga ne që në këtë vend të krijojnë kondita normale të shkollimit, shërbimit shëndetësorë, punësimit dhe ky shtet thjesht të jetë shtet ligjor dhe të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi, shef i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë desha t'i them disa çështje që ndërlidhen më pak me temën, më shumë me procedurën.

Pa dyshim që kjo temë është shumë e rëndësishme, që e ka merituar edhe më herët edhe tash dhe asnjëherë nuk besoj që është tepër të diskutohet dhe kjo është arsyeja që ftesën e seancës e kanë mbështetur edhe deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, por besoj edhe nga grupet e tjera parlamentare. Besoj që kjo është ndoshta treguesi i asaj që pa dallime kemi shqetësime të përbashkëta në lidhje me temën që ndërlidhen me migrimin e të rinjve nga Kosova në vendet e tjera.

Por, meqenëse përmenda procedurën, desha të shpjegoj dhe të qartësoj ndoshta më shumë për opinionin publik, sepse deputetët e dinë që kjo seancë realisht është thirrur krejtësisht papritmas dhe nuk besoj që ka qenë mënyra e duhur për t'u vendosur në një shpejtësi kaq të madhe për një temë kaq të rëndësishme, kur kihet parasysh që kërkesa iniciale dhe nënshkrimet e deputetëve janë dhënë ndoshta që 2 javë, ne kemi mundur që këtë ta trajtojmë edhe në një nga seancat e rregullta ose së paku t'i njoftonim deputetët që kjo seancë e jashtëzakonshme mbahet me këtë datë, por disa ditë më herët. E them këtë, sepse ju e dini që sot këtu shumica dërrmuese besoj e deputetëve, përveç ndoshta atyre që kanë qenë të involvuar direkt te thirrja e seancës, kanë ardhur për një seancë tjetër, të përgatitur për të diskutuar apo trajtuar pika të tjera, dhe meqenëse deputetët nuk kanë qenë të informuar me kohë për këtë seancë, deri sot në këto momente, realisht bile ftesa zyrtare ju ka ardhur para nja 20 minutave me e-mail, unë kam frikë që shumica e tyre nuk janë të përgatitur në mënyrën më të mirë për të diskutuar. Tani ne e dimë që secili prej nesh këtu mund të flasë e të thotë diçka me shpresën që kjo seancë nuk do të degradojë në sulme, pavarësisht pozitë-opozitë, të kësaj kohe apo të asaj kohe.

Por, sidoqoftë besoj që tema të tilla duhet të kenë me të vërtetë një trajtim më serioz edhe prej neve që i ftojmë, edhe prej të gjithë të tjerëve që marrin pjesë. Po e përmend vetëm një fakt, është kjo seanca e 13-të e jashtëzakonshme që thirret për tre muaj. Në tre muajt e fundit kjo është seanca e 13-të e jashtëzakonshme, nëse dikush nuk është i njoftuar me gjendjen dhe me situatën në Kosovë dhe nëse vetëm këtë fakt ia themi që Parlamenti i Kosovës i ka thirrur 13 seanca të jashtëzakonshme për më pak se 100 ditë, kur kihet parasysh që ne e kemi filluar sesionin në gjysmën e dytë të janarit, i bie që ne ose jemi në ndonjë gjendje lufte, me ndonjë konflikt të afërt, ose diçka e jashtëzakonshme vërtetë po ndodh me vendin tonë. Unë besoj që nga këto 13 seanca disa me të vërtetë kanë qenë të jashtëzakonshme dhe është dashur me u trajtua, por nuk ma merr mendja që ky është precedenti më i mirë i mundshëm duke pasur parasysh edhe krejt rekomandimet që na kanë ardhur vite me radhë edhe nga ato institucione që monitorojnë punën e Kuvendit.

Andaj, unë shpresoj shumë që nuk është qëllimi të krijojmë lajme ditore dhe të bëhen statuse për Facebook, por që s'jam i sigurt që substanca e diskutimeve duhet të jetë më e duhura, duke pasur parasysh mosinformimin me kohë. Fenomeni i ikjeve pa dyshim që është shumë shqetësues për secilin prej nesh, duhet thënë që ky nuk është fenomeni i ri, as nuk është ngjarje e ditëve të fundit apo e vitit të fundit. Të gjithëve na kujtohet që ndoshta kriza më e madhe kur është dashur edhe

të trajtohet dhe që është trajtuar kjo çështje ka qenë pikërisht fillimi i vitit 2015, kur kanë qenë me dhjetëra-mijëra njerëz që e kanë lëshuar Kosovën. Fatmirësisht, nga informatat zyrtare dihet që shumica prej tyre janë kthyer, sepse ka qenë imigrim ilegal, për dallim prej asaj që sot po ndodh më shumë, që quhet “migrim legal”. Sidoqoftë, unë thashë që nuk do të flas shumë për temën, meqenëse do t’u lë hapësirë deputetëve, të cilët e kanë shprehur interesimin që të mbahet kjo seancë, edhe nga grupi ynë dhe nga grupet e tjera, por dua të shpreh edhe një herë qëndrimin e Partisë Demokratike të Kosovës që jemi të interesuar që bashkërisht me iniciatorë dhe me grupe të tjera parlamentare të dakordojmë një rezolutë konkrete, e cila me të vërtetë mund të propozojë hapa, të cilët mund ta përmirësojnë situatën, me theks të veçantë te të rinjtë e vendit tonë, të cilët sot po marrin një vendim që mendoj nuk është aspak i lehtë për ta lëshuar vendin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Arbër Rexhaj, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje!

Të nderuar qytetarë,

Është shqetësuese mosprania e kryeministrit në këtë seancë, sepse tema është e jashtëzakonshme, për arsye se situata në Kosovë rreth migrimit është situatë e jashtëzakonshme. Prandaj, është e papërgjegjshme që kemi mungesë të kryeministrit në veçanti, por edhe të ministrave, prandaj edhe kjo është e pafalshme.

Në një publikim të Eurostatit mbi migrimet nga viti 2007 deri në vitin 2018, qytetarët tanë janë minus, pra 15.4% të popullsisë në Kosovë, ndërsa më poshtë saj vijnë Lituania, Letonia, Bosnja, e në vendet më poshtë janë Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe vendet e tjera. Ndërsa, kur e vërejmë migrimin legal e ilegal të shpërfaqur qartë nëpër fshatra dhe lagje të Kosovës, të cilat dukshëm janë të kategorizuara si ikje kryesisht nga të rinjtë, po ashtu edhe ikje familjare, është e çuditshme se si institucionet tona nuk i kanë rënë kambanave të rrezikut kombëtar. Mbi 2 mijë nxënës më pak janë evidentuar gjatë kontrollit sistematik që organizon Drejtoria e Shëndetësisë në Prizren dhe kjo ikje ka të bëjë me disa klasë të shkollave fillore, pa përmendur shkollat e mesme dhe këtu, megjithatë, domethënë kur ikin fëmijët e shkollave nënkupton që ka ikje familjare dhe kur e sheh këtë, pra 2 mijë nxënës të shkollave fillore kanë ikur brenda një viti, që nënkupton kanë ikur 2 mijë familje. Dhe, tash paramendojeni këtë në tërë Kosovën. Klasat e kombinuara nëpër fshatra, kryesisht vijnë edhe si pasojë e kësaj. Ikja nuk po ndodh vetëm nga të rinjtë, por prej qytetarëve të Kosovës. Kjo qeveri e hajnisë dhe krimin institucional do duhej ta shpallte gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë institucionalisht dhe të kërkonte rrugë për dalje nga kjo gjendje e pashpresë.

Tash, shtrohet pyetja pse nuk e bën? Dihet mirëfilli se Kosova kësaj Qeverie i nevojitet pa këta njerëz të pakënaqur, sepse kjo qeveri nuk e do pakënaqësinë, aq më pak të pakënaqur aq më mirë për ta, sa më pak njerëz këtu, aq më mirë për ta. Çdo ditë na dalin të punësuar djem e vajza të

ministrave, zëvendësministrave, kryetarëve të komunave, deputetëve të PAN-it, në fakt, e mbipopulluan Telekomin dhe gjithandej Qeverinë e ministritë, paranë publike e shpërdorjnë sa herë që mundën, krijojnë koordinatorë të punësimeve nëpër hierarkitë e partive të tyre politike dhe e kanë kapur në përgjithësi shtetin, duke e partitizuar skajshëm çdo pore të institucioneve. Më një anë klientela dhe nepotizmi dhe në një anë tjetër hajnia e krimi institucional, pastaj, vijjnë deklaratat “mos e lëshoni Kosovën”, të cilat dalin naive dhe ironike për veshin e qytetarëve tanë. Prandaj, qytetarët e Republikës së Kosovës jo vetëm nga kjo qeveri, por edhe nga qeveritë e kaluara janë ngufatur skajshëm. Ikja masive po bëhet për shkak të mungesës së perspektivës, para së gjithash të fëmijëve. Kanë shkolla ku të edukohen, por nuk kanë program e cilësi ku të shkollohen. Nuk kanë spitale ku të shërohen, prandaj gjejnë zgjidhje në rajon, pra fatkeqësisht në Serbi, Maqedoni, por edhe në Shqipëri. E, për qeveritarët tanë të sëmurë, shumë afër është Evropa, por jo edhe për qytetarët tanë.

Shumë më shqetësuese është fakti që po largohen edhe ata që kanë një punë, të cilët nuk e ndiejnë veten të sigurt në këtë vend, sepse nuk kanë sigurime shëndetësore, punojnë me orar të stërzgatur si skllëvër të Mesjetës, pa pushime javore, mujore, vjetore. Humbin gjymtyrët e jetët e tyre pa dhënë llogari askush. Buxheti i shtetit është bërë buxhet i skemave, ku sektori publik e ka mbytur konkurrencën, domethënë ndaj sektorit privat. Ku paga mesatare në sektorin privat nuk mund të jetë më e madhe se 300 euro. Situatë më e vështirë është edhe për vajzat dhe gratë në Kosovë, ato kanë probleme shtesë. Nëse punëdhënësi, pra në sektorin privat merr vesh që një punëtore e tij është shtatzënë, atëherë e largon atë me automatizëm nga puna, prandaj ato detyrohen edhe ta shtrëngojnë barkun, fatkeqësisht. Qytetarët tanë po ikin jo nga Kosova, por nga varfëria, sepse jetën ju ua keni bërë tym e zi, nuk u keni dhënë ditë të bardha e as shpresë, prandaj me ju nuk ka shpresë.

Ju duhet të ikni që të na kthehet shpresa, prandaj me këtë rast edhe ditë të bardha. Disa nëpër burgje, disa të pensionuar, e disa të skuqur që nuk keni bërë asgjë. Shpallni gjendje të jashtëzakonshme, sepse edhe ashtu është gjendje e papërballueshme dhe e jashtëzakonshme. Të hyjmë në një proces demokratik zgjedhor dhe ta kthejmë shpresën me Vetëvendosjen, sepse vetëm ajo mbeti pa u provuar në këtë vend, sepse vetëm ajo jep shpresë për qytetarët.

Na vodhët fitoren duke u bërë bashkë të zinjte me të zi, prandaj është ky largim. Asnjëra qeveri nuk e ka pasur si synim zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Privatizuat egër dhe përplot me korrupsion krejt ndërmarrjet në Kosovë, duke ua dhënë partiakëve dhe familjarëve tuaj, e kapët shtetin duke mos menduar që ky vend nuk është vetëm juaji, por i tërë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Prandaj, është momenti i duhur dhe i fundit që ta bëjmë kthesën historike dhe politike, përndryshe ky vend do të mbetet vetëm i atyre që e zhvatën dhe po e zhvatin në konsistencë dhe sistematikisht Kosovën. Lejoni ata që vërtet e duan këtë vend, dhe jo ju që e dëshmuat se po e largoni me shpejtësi qytetarin që as Serbia nuk mundi ta bënte dot me vrasje, masakra, gjenocid dhe deportim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Një njoftim për deputetët. Seanca e cila ka qenë e paraparë për sot, është shtyrë për të hënë, ta keni parasysh, në orën 10:00. Nesër vazhdon seanca tjetër.

Zonja Teuta... Zoti Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës. Më fal, PSD-ja, të lutem Muhamet! Se paskan lëvizur gjërat, 12:12, ma kanë vënë në protokoll të Aleancës para, si zakonisht, po më thotë sekretari se qenka 12:12.

Po atëherë, Ahmet Isufi. Po mirë, po mendova, kërkoj falje. Në protokoll e paskam të shkruar kështu, do të shkoj tash...

AHMET ISUFI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Rini e pranishme në këtë seancë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot është një seancë e jashtëzakonshme, e cila vërtet ka për diskutim një temë të jashtëzakonshme që është migrimi i popullatës së Kosovës jashtë vendit dhe që kjo dukuri nuk është e sotme, është e vazhdueshme. Duke mos llogaritur periudhën e okupimit serb, kur një milion shqiptarë u detyruan ta lëshojnë vendin nga terrori dhe gjenocidi në kohën e okupimit. Pas luftës e kemi një gjendje ekonomike sociale të rënduar në vend dhe normalisht që ka ndikuar që të rinjtë tanë ta braktisin vendin. Meqë u përmendën edhe statistikat e EUROSTAT-it, unë e kam për obligim jo vetëm atë pjesën që i konvenon dikujt, por edhe pjesën tjetër ta kemi parasysh. Dhe një studim nga EUROSTAT-i që është i pranishëm tani, është për të kërkuarit e azilit në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vendet e Shengenit, ku shihet që nga periudha 2015 deri në periudhën 2018, kemi një dallim shumë të madh të migrimit të popullatës së Kosovës jashtë vendit.

Derisa në vitin 2015 kanë migruar 67 545 banorë, në vitin 2016 kemi një rënie me 9 410, në vitin 2017 kemi 5 455 dhe në vitin 2018 kemi 3 515. Prandaj, shihet një rënie e daljes së qytetarëve të Kosovës jashtë vendit. Nuk është mirë të shërbehemi me propagandë, e cila veç stimulon migrimin, por përkundrazi duhet këtu në Parlamentin e Kosovës të jepen ide, sugjerime, dhe po ashtu edhe mendime të cilat mund ta ndalojnë këtë dukuri, duke e kritikuar Qeverinë normalisht që me ato që janë elemente që përmirësohet situata, duhet të bëhet, ndërsa të jepen edhe ide që e përmirësojnë gjendjen. Dallimi në mes të kaluarës dhe të tashmes është se atëherë kemi pasur ikje ilegale të depërtimi nëpër kufij, të arrestimit dhe mbajtjes nëpër azile të shteteve të tjera siç ka qenë Hungaria. Por tani është një mënyrë tjetër e shkuarjes në botën e jashtme e që bëhet përmes kërkesës së vizave në ambasada për një jetë më të mirë, për punësim dhe për studim normalisht të studentëve, të cilët kanë nevojë të profesionalizohen dhe t'i ngrenë kapacitetet e tyre.

E mira do të ishte që të krijojmë kushte në Kosovë që ata të kthehen në vendin e vetë, t'i shërbejnë vendit të vetë, se Kosova ka nevojë për ta, por duhet ide kreative sesi mund të dalim nga kjo gjendje, dhe meqë Qeveria këtë vit ka shpallur 'Vitet e ekonomisë', atëherë duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat që të stimulojë prodhimin vendor, të ngre kapacitetet e ekonomisë së vogël dhe të mesme, të mundësojë përmes bursave dhe angazhimit të drejtpërdrejtë në arsimin e lartë, në mënyrë që studentët tanë të studiojnë këtu, të shërbejnë këtu, të aftësohen këtu dhe normalisht nesër të punësohen këtu, në mënyrë që t'i japin kontribut vendit të tyre.

Nuk është mirë që në këtë Kuvend vetëm të shihet zi, sepse ne kemi edhe të punësuar jashtë vendit të cilët mbajnë familjet e tyre me remitencat që i sjellin në Kosovë dhe kjo normalisht e ka mbajtur Kosovën për kohë të gjatë, por ka e justifikuar se duhet stimuluar kjo mënyrë e daljes jashtë vendit. Megjithatë, kërkitimi për liberalizimin e vizave është një e drejtë e garantuar e të gjithë qytetarëve të Evropës, përveç Kosovës e që i bëhet një padrejtësi e madhe, sepse pamundëson ndërlidhjet ekonomike që do të mund të ndodhnin në mes të kompanive të Kosovës dhe atyre të jashtme. Do të mundësonin që të rinjtë tanë të dalin të angazhohen në studime, në profesionalizëm dhe t'i kthehen vendit të tyre. Ajo që është më kryesorja, duhet të bazohemi në resurset që i kemi që duhet ngritur dhe përmes tyre të stimulojmë vende të reja të punës që kishin pasur mundësi të zbusin këtë dukuri të daljes jashtë vendit.

Prandaj, kërkoj edhe nga kolegët deputetë që të ketë racionalizëm në këtë drejtim, të mos përdorin shprehje të cilat nuk i takojnë këtij Kuvendi, por bashkërisht pozitë-opozitë, t'i shohim mundësitë sesi mund të ndalet ikja e të rinjve jashtë vendit.

KRYETARI: Faleminderit! Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Të nderuar qytetarë,

Mendoj që kjo temë që po e diskutojmë sot në këtë seancë të jashtëzakonshme, edhe me mënyrën sesi u shpreh nga propozuesi, edhe nga deputetët e tjerë, në këtë produktin final të kësaj seance, mendoj që nuk do asgjë tjetër, përveçse na jep një hapësirë secili prej nesh të flasim, duke konstatuar, e shpeshherë edhe duke qarë, për shkaqet e jetën kaq të rëndë në Republikën e Kosovës, që po i detyron qytetarët e Republikës ta lëshojnë vendin, sepse kjo gjendje të cilën e kemi ne sot këtu natyrisht që nuk mund të shpresohet se do të zgjidhet me një rezolutë që do ta prodhojmë nesër, edhe nëse i merr votat e të gjithë deputetëve të Kuvendit, edhe nëse është abstrakte, edhe nëse është konkrete si rezolutë. Sepse, për mendimin tim, të paktën, kur i shohim statistikën, edhe trendin përgjatë viteve të qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët largohen nga Republika e Kosovës, shumë lehtë mund të konstatojmë se nga përcaktim individual,

migrimi është duke u bërë gati se vendim e vullnet kolektiv. Dhe, në këtë drejtim duhet ta analizojmë se cilat janë shkaqet e këtij migrimi.

Pra, kur ka numër në rritje të qytetarëve të cilët duan ta lëshojnë vendin, atëherë nuk ka sesi të mos konstatojmë se shkaqet qenkan strukturore. Pra, nuk është këtu vullneti ose përcaktimi individual për një jetë më të mirë siç thuhet, edhe pse natyrisht lëvizja dhe migrimi gjithnjë bëhen për një jetë më të mirë. Pra, edhe ata që kanë ikur nga Siria gjatë luftës për në Evropë kanë ikur për një jetë më të mirë, sepse jeta në Siri ka qenë e pamundshme. Dhe në këtë drejtim, me këtë fjali mendoj që relativizojmë shumë, kur themi që qytetarët po ikin për një jetë më të mirë.

Po, në anën tjetër edhe ky grupi tjetër, që ballafaqohet me relativizuesit, e të cilët thonë që ky është apokalips dhe u shkatërrua Republika e Kosovës, meqë qytetarët e Republikës së Kosovës po zgjedhin që të gjejnë vende pune e po e ndjekin një jetë më të mirë nëpër vende të tjera, pra ata grup që i kisha quajtur popullistët, edhe këta e mbithjeshtojnë mendoj unë çështjen dhe e pamundësojnë diskutimin.

Pra, në këtë drejtim konsideroj që të dyja skajet ekstreme kur flasim për këtë gjë e kanë gabim. Dhe, cila është mënyra më e mirë për të diskutuar për këtë çështje, është mendoj unë identifikimi i shkaqeve kryesore të cilat e kanë shndërruar jetën në Kosovë nganjëherë të papërballueshme për një pjesë të madhe të qytetarëve të Republikës. Dhe, në këtë drejtim mendoj që po ashtu duhet të diskutohet jo vetëm numri i njerëzve që po e lëshojnë vendin, po sa pastaj nëse ka të tillë qytetarë të cilët po kthehen për të jetuar në Kosovë, duke e sjellë këtu edhe dijen e përvojën që e kanë fituar nëpër vende të tjera shumë më të zhvilluara se Kosova dhe kështu duke e ndihmuar edhe ekonominë e Republikës së Kosovës.

Tash, meqë po flasim për vështirësitë me të cilat ballafaqohen qytetarët në përditshmërinë e tyre në Republikën e Kosovës, atëherë domosdoshmërisht duhet të flasim edhe për historikun e këtyre vështirësive, sepse gjendja aktuale nuk është e dhënë që ka nisur sot në mëngjes dhe në anën tjetër duhet të flasim edhe për përgjegjësinë të instancave të ndryshme të pushtetit dhe institucioneve publike që shkojnë përtej Qeverisë, sepse mendoj që nëse e partikularizojmë këtë çështje vetëm në qeverinë aktuale dhe veçanërisht nëse e partikularizojmë në njërin prej ministrive, siç dëgjova këtu nga disa deputetë, mendoj që është absurd që të diskutohet çështja e migrimit në këtë drejtim.

Pra cilat janë shkaqet kryesore që mendojnë që po e lëshojnë ose po i detyron qytetarët e Republikës së Kosovës që ta lëshojnë vendin. Natyrisht një prej problemeve kryesore në Republikë sot është niveli i lartë i papunësisë dhe perceptimi i qytetarëve për këtë nivel të lartë të papunësisë. Në këtë drejtim konsideroj që dy probleme madhore lidhen me këtë. Pra jo vetëm papunësia si e tillë, e cila natyrisht që ua pamundëson njerëzve që ta kenë një jetë të dinjitetshme me punën e tyre në Republikën e Kosovës, po domosdoshmërisht e veçanërisht edhe kushtet e

vështira të punës në të cilat ose me të cilat ballafaqohen qytetarët e Republikës së Kosovës të punësuar në Republikën e Kosovës. Dhe, këtu pastaj ndërlihen siguria në punë, kushtet e punës, niveli i ulët i pagave, paga shumë e ulët minimale, për të cilën ne kemi kërkuar një interpelancë tash e sa kohë, e s'po vjen në rend, e kështu me radhë. Dhe të ndërlihdura me këto, pastaj është edhe siguria sociale, prej sistemit të shëndetësisë, te sistemi i arsimit e deri te çështjet që ndërlihen me sigurinë publike.

Me një fjalë, nëse dëgjohen gjithnjë ata që po e lëshojnë vendin, nëpër intervista që i kemi parë edhe gjatë vitit 2015 e 2016, e që po i shohim edhe sot, vërehet një dallim mendoj unë cilësor në natyrën e migrimit të sotëm, nëse ta zëmë e krahasojmë këtë migrim me vitet e '90-ta. Pra, në vitet e '90-ta, një prej shkaqeve kryesore ka qenë represioni nga okupatori serb në atë kohë dhe shumica e njerëzve që kanë ikur nga Kosova në atë kohë, kanë ikur me pretendimin dhe me vullnetin se do të kthehen në Kosovë. Pra, po shkojmë derisa të përmirësohet gjendja në Kosovë, dhe pastaj do të kthehemi. Dhe tash nëse i shohim shumica e njerëzve, të paktën sipas deklaramëve të tyre, që e lëshojnë Kosovën, nuk e lëshojnë më për t'u kthyer. Po thonë që do të zhvendosemi nga Kosova njëherë e përgjithmonë. Kjo për mendimin tim tregon një nisje të humbjes së besimit në perspektivën në këtë vend. Pra, konsideroj që përtej shkaqeve edhe vështirësive të aktualitetit që ndërlihen me ekonominë dhe shtetndërtimin në përgjithësi, ka edhe një humbje në rritje të besimit se Republika e Kosovës do të bëhet ndonjëherë republikë e jetueshme.

Në këtë drejtim, konsideroj që kjo nëse është e vërtetë gjithnjë po flas, sepse këto megjithatë janë kështu statistika nga ana ime që është goxha spekulativ, pra nëse kjo është e vërtetë, atëherë mendoj që ky është problemi kryesor të cilin duhet ta adresojmë. Për çfarë mënyre mund ta kthejë te qytetarët e Republikës së Kosovës dhe bashkë me ta një entuziazëm dhe optimizëm të ri për ta ndërtuar Republikën e Kosovës si një republikë të qytetarëve të barabartë.

Në këtë drejtim, konsideroj që diskutimi i sotëm do të duhej të fokusohet. Pra, natyrisht që nisemi nga vështirësitë e aktualitetit, mirëpo gjithnjë duhet ta kemi parasysh se cilat do të jenë ato masa institucionale dhe politike të cilat e krijojnë një Kosovë që do të jetë e aftë të ballafaqohet, e konkurrenente me të ardhmen e rajonit e të Bashkimit Evropian, ku synojmë që të integrohemi.

Në këtë drejtim konsideroj që në politikat tona partiake dhe politikat tona programore, secila prej partive synon ta mirëmbajë sistemin dhe modelin aktual ekonomiko-politik të vendit dhe njëkohësisht qanë për largimin e qytetarëve nga ky vend, atëherë mendoj që kjo është hipokrizi.

Qartazi, problemet të cilat i kemi ne këtu në Republikën e Kosovës sot, natyrisht që edhe mund të lidhen me emra të përveçëm kur duam, mirëpo të gjithë e dimë që kjo nuk është e vërteta. E

vërteta është te një model i gabuar ekonomik të cilin e kemi aplikuar e në të cilin për çdoherë e më shumë po rritet hendeku ndërmjet të varfërve dhe të pasurve.

Për çdoherë e më shumë, ata që nuk i kanë punët mirë ekonomikisht dhe nuk kanë status social, po përjashtohen nga jetë publike dhe mundësia publike, dhe në këtë drejtim, kjo pastaj edhe po e shkakton humbjen e besimit për perspektivë në vend.

Kur ta konstatojmë gjendjen dhe kur nuk e konstatojmë drejtë gjendjen, atëherë natyrisht që në këtë konstatim do duhej edhe të propozonim se çka konkretisht do duhej të ndodhte në Republikën e Kosovës në mënyrë që besimi në të edhe në mundësinë e saj të kthehet.

Për mua dhe për Partinë Socialdemokrate, gjëja më e rëndësishme që duhet të ndodh në Republikën e Kosovës, vjen nga tre faktorë kryesorë. E para është, ta kemi një model ekonomik që bën trajtim të barabartë të qytetarëve dhe që bën rishpërndarje më të barabartë të pasurisë sesa akumulimi e përqendrimi aktual që e kemi të shumicë së pasurisë së këtij vendi në duart e një pakice të superpasur.

E dyta, çështje më e rëndësishme është që barazia karshi institucioneve publike edhe karshi sistemit të gjyqësorit të mos jetë vetëm slogan që tingëllon mirë, po të fillojë të bëhet realitet në Republikën e Kosovës.

Dhe e treta, ta përdorim veçanërisht sistemin arsimor të Republikës së Kosovës, në mënyrë që qytetarët e Republikës t'i pajisim me dijen dhe aftësinë që të jenë jo vetëm konkurrentë nëpër tregjet për të cilat po flasim, po të jenë të aftë dhe të gatshëm që të ballafaqohen me kërkesat ekonomike të së ardhmes e jo vetëm të tashmes, e cila globalisht është duke përfunduar shumë shpejt.

Edhe një gjë për fund...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi nga Nisma e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë,

Përshëndetje të reja dhe të rinj që jeni atje lartë duke na përcjellë rreth asaj se çka do të themi për temën që nuk ju përket vetëm juve, por na përket edhe neve.

Më kujtohet në kohën kur kam qenë në Zvicër ka qenë një bankë e sapo themeluar dhe moton e saj e ka pasur; suksesi barabartë me tërësia e vendimeve të drejta apo tërësia e vendimeve të

drejta barabartë me suksesin. Nuk po e them në gjuhën gjermane, sepse mjafton në gjuhën shqipe.

E kundërta e kësaj, dështimi është tërësia e vendimeve të gabuara. Fatkeqësisht sot jemi në fazën, në momentin kur ne korrim atë që e kemi mbjellë. Dhe, çka kemi mbjellë për këto 15 vjet s'po them më shumë, të gjithë e dimë.

Çka kemi mbjellë, sot po korrim. Pra, kemi mbjellë iluzione po korrim deziluzione. Ka ardhur koha e deziluzionimit. Me këtë sistem ekonomik, me këtë sistem arsimor, me këtë potencial të vendit, me mënyrën qysh i kemi trajtuar mundësitë tona, natyrisht që nuk ka pasur kurrfarë mundësie që për të gjithë të ketë një vend pune.

Ka vende shumë më të zhvilluar dhe nuk ka për të gjithë. Është krejt normale pastaj që secili si pjesë e tërësisë të kërkojë një zgjidhje për vetveten.

Migrimi nuk është se na ka gjetur sot në befasi. Këtë ditur ta bëjmë që 60 vite më së miri fatkeqësisht. Që nga vitet e '70-ta kur largoheshin prindërit tanë atëherë për Gjermani, Zvicër, Austri, Norvegji me punë të përkohshme jashtë vendit, ju kujtohet kjo thënia e famshme.

Dhe ajo punë e përkohshme u bë 50 vjet. Dolën në pension, madje u detyruar t'i marrin edhe familjet me vete në mënyrë që vendi i përkohshëm të bëhet vend i përhershëm i tyre.

Cilat mësimet duhet t'i nxjerrim nga ajo? Edhe pse vendi ynë ka kaluar nëpër tri faza, fazën e migrimit ekonomik në vitet e '70-ta, fazën e migrimit siç u tha nga dhuna sistematike dhe nga represioni i Serbisë në vitet e '90-ta, tani koha fatkeqësisht është e brezit i cili nuk ka represion ndaj tij. Ka hapësirë dhe mundësi arsimit dhe shkollimi më shumë sesa në çdo vend tjetër, por nuk ka mundësi punësimi.

Shumëkush punësimin po e lidh vetëm me punësimin në shërbimin publik. Jo. Besoj që të gjithë këtu edhe të rinjtë që janë lartë edhe deputetët këtu edhe qytetarët jashtë vendit dinë që punësimi masiv ndodh në ekonominë e tregut. Në ekonominë private. Jo në shërbimet publike.

Nuk di që ka ndonjë vend në botë që punëson më shumë se 5% të fuqisë punëtore, qoftë ajo profesionale, intelektuale apo nëpërmjet ndërmarrjeve publike edhe fizike, që punëson më shumë se 5 deri në 5% të popullsisë, 90% e saj punësohet në ekonominë private, në ekonominë e tregut, në kompanitë private.

Unë po sjell këtu ndonjë risi, e kur e them këtë, të gjithë e dimë.

Tash, cila është detyra e shtetit, e Qeverisë, e qeverive në përgjithësi, që kësaj ekonomie të mos ia zërë frymën, kësaj ekonomie t'i japë liri dhe mundësi të zhvillohet në mënyrë që të rehat dhe të rinjtë të gjejnë hapësirë për ta ushtruar profesionin e tyre brenda kompanive private.

Kryetari i Kuvendit edhe disa deputetë e dinë, kemi qenë këtu në sallë kur i kemi pritur disa mërgimtarë këtu në këtë sallë, para një viti ose një vit e gjysmë. Aty ka thënë një fjali që më duhet ta përsërisë këtu; nëse ne nuk ua hapim dyert mërgimtarëve të cilët kanë marrë atje një arsimin të lakmueshëm, që kanë krijuar kompani të suksesshme, nuk ua hapim dyert që të vinë këtu, edhe dijen edhe potencialin e tyre ekonomik dhe organizativ ta sjellin këtu, nëse ne nuk ua hapim dyert atyre, ata do t'i hapin dyert për fëmijët tanë.

Tani jemi para një situatë kur, po ata po i hapin dyert për fëmijët tanë. Dhe fëmijët tanë, nëse nuk merren masa urgjente në atë që ekonomia private, kompanitë private, qoftë përmes formave të subvencionimit siç e kanë bërë shumë vende, Gjermani për shembull e ka aplikuar modelin kur ka pasur një krizë të madhe të punësimit deri në 10%, dhe 10% për Gjermaninë janë shumë, sepse një i papunë në Gjermani i kushton rreth 2 mijë euro shtetit. Një punë në Kosovë i kushton zero euro shtetit.

Prandaj, kam përshtypjen që shteti nuk shqetësohet shumë për të papunët. Kanë aplikuar modelin kur shtetit, Qeveria në bashkëpunim me kompanitë kanë hapur vende pune duke ia mundësuar kompanisë që t'ia paguajë për 1 vit një punëtor me kusht që ai ta aftësojë pastaj ta mbajë për 3 vjetët e ardhshme.

Pra, nuk është se këtu nuk ka mundësi që të krijohen vende pune dhe t'u krijohet hapësirë kompanive për t'u zhvilluar, po këtu duhet një strategji e përbashkët ku Qeveria, kapitali vendor, kompanitë vendore dhe të jashtme do të përfshiheshin në një plan të përbashkët për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit dhe për ta nxitur punësimin.

Këtë e kanë bërë me sukses dhe sot të gjithë e dimë që nëpërmjet këtij plani edhe nëpërmjet veprimeve të tjera, Gjermania ka arritur që papunësinë ta zbusë deri në përmasa saqë të kërkojë pastaj edhe punëtorë jashtë vendit.

Po ashtu e keqja e këtij migrimi nuk është vetëm humbja e njerëzve fizik, por humbja edhe atyre që, sepse bëhet fjalë për migrim legal, pra për një vajzë apo një djalë që ka një zanat të mirë dhe tregu i Gjermanisë apo i Zvicrës apo i cilitdo vend tjetër e pranon, e merr për shkak se ai do të kontribuojë në atë shoqëri. Do të kontribuojë në ekonominë e atij vendi.

Unë vetëm po e them edhe një gjë, duhet që urgjentisht kjo Qeveri t'u përshtatet jo vetëm nevojave të ekonomisë së vendit, por edhe t'i harmonizojë politikat e zanateve, zejeve dhe profesioneve në raport me atë që e kërkon tregu i jashtëm.

Shumë të rinj sot që e njohin informatikën, programerë, e dinë që duke qenë në Kosovë mund të fitojnë shumë më shumë sesa duke shkuar jashtë, por për atë duhen shkolla të veçanta të programimit.

Unë i kam të dy djemtë të orientuar në programim dhe ata thonë që edhe 100 000 programerë t'i ketë Kosova, që 100 000 do të gjejnë punë. Pse atëherë nëse 100 000 programerë mund të gjejnë punë në Kosovë pa shkuar fare jashtë, të mos e ndërtojmë një kurrikulë, një shkollë dy vjeçare apo 18-muajshe ku do t'i aftësonim njerëzit për punësim.

Pra, le të jetë edhe kjo një nga sfidat apo mënyrat përmes të cilave do të mund të përballemi me këtë sfidë. S'ka një vajzë apo një djalë të ri i cili nuk e njeh anglishten. Dhe jam i sigurt që nga ato 5-6 gjuhë programore, të programimit që sot janë në treg të kërkuar, të gjithë, pa përjashtim të rinjtë edhe të rejtat mund ta mësojnë.

Por, të jeni të sigurt që nuk do të ketë punë asnjëherë në Kosovë për të gjithë këta juristë, për të gjithë këta ekonomistë, por le të bëjmë përpjeke së bashku që të orientohen fëmijët tanë, vajzat dhe djemtë e rinj në zejet në zanatat, në profesionet të cilat ai menjëherë mund të gjejë punë, madje shpeshherë edhe pa e përfunduar shkollimin.

Unë, pashë një ditë një reklamë të një kompanie ku thotë para një muaji e kam kërkuar një programer e tash më duhen dy, ju lutem lajmërohëni. Dhe, kompania tjetër i komenton në faqen e tij i thotë, nëse i gjen tre, një ma dërgo mua.

Pra, le t'ju ndihmojmë të rejave dhe rinjve që të orientohen në profesione, të cilat jo vetëm që nuk do të kenë nevojë për të kërkuar punë, por tregu do t'i kërkojë ata kudo që janë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar 6+.

FIKRIM DAMKA: Sayın Başkan, Değerli Milletvekilleri

Kosova'da son dönemlerde gençlerimizin hızlı bir şekilde Kosova'yı terketmeleri, geleceğimizin açısından son derece endişe verici bir durum olduğu ortadadır. Bu, yıllardır devam eden ve biriken sorun olduğu herkes tarafından bilinmekte ve görülmektedir.

Kosova'da kurulan hükümetlerin ekonomi ağırlıklı bir çalışma yapmadıkları için bugün bu gençlerimiz kendi topraklarını terk edip, daha güzel bir hayat için Avrupa yollarına ittiğimizin farkında olmalıyız ve bu durumdan herkes sorumludur.

Maalesef Kosova'ya gelen iş adamlarını komşu ülkelere kaptırarak, burda yatırım yapmaları için olanak yaratmadık, ya rüşvet talep edildi, ya da tehdit edilip araç istendi ve gelinen nokta bugün ortadadır, işsizlik oranı yüzde 50-lerde.

Bu kaçış Kosova'nın gelecekte nüfus ile ciddi sorunlar yaşayacağını da işaretidir, bunu her gün okullarımızda azalan öğrenci sayısı en iyi şekilde göstermektedir.

Bundan sonra gelecek iş adamlarına da kalifiyeli eleman ve genç çalışan da bulamayacağız, ekonomide kısır dongu oluşturup ülkemizin geleceği de tehdit altına alınmaktadır.

Konu ile ilgili grup olarak acil alınması gereken tedbirler ve kararlara ihtiyaç olduğunu görmekteyiz. Bu yönde desteğimizi her platformda sunacağımızı da bildirmek isterim, ki bir günde de çözüm üretileceğinden emin değiliz ve bugün burda çıkacak olan bir karar ile gençlerimizi durduramayacağız. Hükümetin acil olarak ekonomiyi canlandıracak teşvik edici programlar geliştirmesi şarttır, ki bu desteklerin gerçekten üretene verimesini sağlamamız lazım, dost, akraba ve tanıdıklara değil. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, ashtu-kështu ju nuk e lini pa shkuar në pauzë. A shkojmë tash në pauzë dhe pastaj vazhdojmë me deputetët?

Shkojmë në pauzë deri në orën 14:00 dhe e vazhdojmë debatin pastaj. Pushim deri në orën 14:00.

* * *

Vazhdim i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala

KRYESUESI: Të nderuar kolegë,
Në radhë është përfaqësuesi i Qeverisë, por meqë Qeveria s'ka asnjë përfaqësues të pranishëm, kalojmë te pjesa e fjalës së deputetëve.

Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I respektuar Kabinet, asnjë prej kabinetit nuk është këtu.

Atëherë, ky debat i thirrur nga kryetari i Grupit të të Rinjve të deputetëve, zotit Rekalii, është jashtëzakonisht i arsyeshëm të diskutohet për gjendjen e të rinjve në Republikën tonë apo edhe ikje. Kjo ikje e të rinjve është dukuria më e keqe që mund t'i ndodhë Kosovës.

Ikja e të rinjve është sepse në Republikën tonë nuk po shohin perspektivë dhe nuk po kanë arsye që të qëndrojnë në Kosovën e tyre të dashur.

Nuk është mirë t'i jepet shumë hapësirë mediatike dhe të vajtojmë këtu bashkërisht se si po ikin të rinjtë, sepse pa dashur të akuzoj njëren parti apo tjetren, bashkërisht jemi të gjithë fajtorë për ikjen e të rinjve dhe ikja e të rinjve nuk është një problem i sotëm, po është problem i kamotshëm dhe të gjithë bashkërisht duhet të kontribuojmë. Mirëpo përgjegjësia i bie më shumë Qeverisë aktuale për gjendjen e krijuar në Kosovë.

Nuk është problem i vogël, është problem shumë i madh mosperspektiva e të rinjve në Kosovë.

Ne e kemi një rini të shëndoshë, një rini të mrekullueshme, vetëm se të gjithë duhet të reagojmë dhe t'i japim hapësirë të investojmë, të thërrasim investitorë, t'i lehtësojmë procedurat e investitorëve, të investojmë më tepër në shkolla profesionale, të fillojmë me prodhime, me investime më shumë në gjeneratat e reja.

Këtu u fol zakonisht prej shumë deputetëve, kolegëve të mi, edhe për profilet, domethënë të nxënësve, programerë edhe shumë të tjerëve, mirëpo nuk është e lehtë të gjendet një rrugë apo një punë në Republikën tonë për të rinjtë, edhe për ata të cilët e kanë notën mesatare dhjetë, sepse nuk janë krijuar kushte dhe mundësi dhe nuk ka vende të lira të punës aq sa edhe kemi rini.

Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë hapësirë dhe mundësi t'i stimulojnë bizneset e të rinjve në forma të ndryshme, të hapin mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës dhe të mos e

hedhim fajin nga njëra parti në tjetrën, po të bëhemi bashkë dhe të nxjerrim disa rekomandime me këtë rezolutë dhe dua të besoj që kjo rezolutë nuk do të mbetet vetëm në letër, sikur rezolutat e tjera dhe ky debat të mos shkojë në vesh të shurdhur, po të merret me seriozisht bashkërisht të gjithë dhe të bëjë një zgjidhje sa më të mirë për të rinjtë tanë, sepse kjo është një e keqe që po i ndodh Kosovës prej pas luftës.

Nuk dua të zgjatem, por po jap disa rekomandime, të cilat vlerësoj që janë të arsyeshme.

Për shembull, duhet të ketë siguri në punë, duhet të rregullohet paga minimale në Kosovë, duhet të rregullohet sektori privat dhe duhet të përafrohet me atë publik, të investohet më tepër në shkolla profesionale.

Dhe, krejt në fund, unë rekomandimet të cilat do të dalin nga kjo seancë do t'i përkrah edhe unë bashkërisht dhe në vazhdimësi dua të besoj që kjo Qeveri të zgjohet nga gjumi dhe të investojë më tepër në vende të lira të punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa, nuk është i pranishëm. Nait Hasani, po ashtu nuk është. Fatmire Kollçaku, nuk është. Arbërie Nagavci, nuk është. Sipas radhës, Drita Millaku.

Jo, sipas kësaj, nuk më keni dhënë një listë.

DRITA MILLAKU: Të nderuar qytetarë,

Të gjithë atyre që e udhëhoqën Kosovën për 20 vjet nuk iu kujtua se këtij popullit i vodhën çdo gjë.

Vonë, shumë vonë t'i bëhet thirrje rinisë të mos ikin. Kur e keni shkatërruar ekonominë, kur i keni privatizuar e përvetësuar të gjitha ndërmarrjet publike, vlera e të cilave arrin miliarda euro.

Në Prizren janë privatizuar e përvetësuar mbi 50 ndërmarrje, ku i keni kthyer në magazina, markete e banesa. Vetëm në Prizren janë larguar mbi 25 mijë punëtorë, e të mos flasim për gjithë Kosovën. Vonë, shumë vonë t'i bëhet thirrje tani rinisë, ku krejt buxhetin e keni orientuar në asfalt, e s'keni menduar për perspektivën e rinisë.

Sa për dijeni, vetëm në investime në autostrada deri më tani kanë stagnuar mbi 120 vende të reja pune, pra më mirë ka qenë të hapen 100 mijë vende pune, sesa të shtrohet asfalt që nuk ka qenë urgjente.

Megjithatë, ky asfalt e ka një të mirë, ia keni lehtësuar rinisë të ikë prej Kosovës për asfalt. Pra, kjo është strategjia juaj.

Mjekët, arkitektët, inxhinierët po largohen, sepse nuk po shohin perspektivë dhe të vetmen mundësi për punë kanë kamerierë apo shitës të marketeve të mëdha.

Krijuat mekanizma të shumtë për të fituar privilegje për vete, po asnjë mekanizëm për të mbrojtur qytetarin.

Lirinë e konsideruan si mundësi, shtetin si plaçkë, e popullin si skllav.

Injorantët e kanë kapur shtetin, thirren në emër të shtetit dhe veprojnë si duan vetë.

I kanë blerë prokurorët, gjykatësit, komandantët e policisë, i kanë kapur mediat publike, kanë blerë portale e analistë. Kanë krijuar institucionin e reklamës dhe suksesit fals.

Privatizimi i mbrapshtë, betonimi i tokave bujqësore, shkatërrimi i blegtorisë dhe industrisë ushqimore krijoi parakushtet që shoqëria jonë të shndërrohet në shoqëri konsumuese të ushqimeve të dyshimta të importuara.

Krejt kjo jo pa qëllim, kur dihet që importuesit kryesorë të këtyre ushqimeve janë njerëzit kryesorë të pushtetit.

Edhe ju pronarë e shefa të bizneseve kosovare, jeni shumë vonë për t'i bërë thirrje rinisë kosovare për të mos ikur.

Përveç tjerash, shumica prej jush nuk keni as të drejtë morale për një thirrje të këtillë. I shfrytëzuat punëtorët tuaj për 20 vjet me radhë në kushte skllavërie dhe i shumëfishuat milionat për vete.

Rinia nuk po i beson më sinqeritetit të thirrjes suaj, sepse kjo thirrje është bazuar në frikën, e jo në mirësinë tuaj.

Para disa ditësh takova një të ri, i cili ishte në pritje për të ikur nga Kosova. Ai ishte rritur pas luftës dhe nuk kishte asnjë lidhje as farefisnore, as biznesore, por as politike. E kishin mashtruar me diplomë të shkollës së mesme, pastaj me diplomë të fakultetit, e së fundi me titullin master.

E në fund fare e kuptoi se atij këta sundimtarë ia kishin vjedhur rininë, ia kishin vendosur në udhëkryq të ardhmen dhe e kuptoi se diploma e vetme për punësim ishte librezja partiake.

Ju pushtetarë që sot po i bëni thirrje rinisë të mos ikë nga Kosova, e keni vetëm një mundësi. Është koha e fundit që të ikni ju nga Kosova, e populli të vendosë të qëndrojë e të veprojë në Kosovë. Lëvizja Vetëvendosje, bota e vërtetë intelektuale dhe akademike, njerëzit e tjerë të

vullnetit të mirë që e duan me shpirt e me zemër këtë vend, kanë të drejtë morale t'i bëjnë thirrje popullit për mobilizim në mënyrë që pushtetarët e paskrupullt të mos luajnë më me fatin e tyre.

Është koha që t'i dërgojmë në pakthim të gjithë ata që na shëmtuan vendin, na vodhën dhe po përpiqen të na rrënojnë edhe të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj, nuk është. Shkumbim Demalijaj, Rasim Selmanaj, Donika Kadaj-Bujupi, Blerim Kuçi, nuk janë. Lus regjinë t'i largojë nga lista. Fjalën ia jap deputetes Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, për korrektësinë dhe respektimin e Rregullores.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sinqerisht seanca e thirrur e jashtëzakonshme mbetet një temë tjetër, por tema që trajtohet në këtë seancë mendoj që është shqetësim i të gjithëve.

Por, që në fillim të fjalës sime, më duhet të them që kjo seancë e thirrur nga kryetari i të rinjve, kolegu deputet në Parlamentin e Kosovës, nuk është që përfaqëson këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës kryetarin e Forumit Rinor të LDK-së, për mua është një sugjerim juaj që nuk duhet ta thoni tjetër, e keni thënë në fillim fjalën tuaj.

Prandaj, është shqetësuese sot të kemi të rinj e të reja që e lëshojnë vendin e tyre, po, në një pjesë të madhe secilit prej nesh, nëse hyjmë në historik na kujtohen ditët më të dhimbshme kur vendin e lëshuam pa vullnetin tonë, por të shtyrë nga regjimi serb.

Por periudha dhe skenat që vërtet na kthyen edhe neve si Kuvend ishin në periudhën sidomos në vitin 2015, kur që të gjithëve na shqetësoi dhe u bashkuam edhe një herë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për t'i diskutuar, pra me një kërkesë të grupit tim parlamentar, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pra më 26 janar dhe 5 shkurt të vitit 2015.

Me qëllim mora rezolutën e atij debati të thirrur dhe kemi 17 pika të kësaj rezolute, të nderuar kolegë deputetë, nga të cilat ne si Kuvend i Republikës së Kosovës do të duhej thërrasim në përgjegjësi, ashtu siç i kemi shënuar vetë në harmoni të plotë me të gjitha grupet parlamentare dhe asnjëherë detyrën tonë si deputetë nuk po e kryejmë, sepse nuk i kemi thirrur edhe në përgjegjësi edhe aktorët kryesorë, për çka i kemi të shënuar në pikat e rezolutës së vitit 2015.

Po, pse skenat më trishtuese ishin në vitin 2015. Sado që ne atëherë ishim opozitë, mirëpo vërtet të gjithë bashkë, kush pozitë e kush opozitë, kemi shkuar dhe i kemi vizituar familje të tëra, të cilët i shitën krejt çka patën dhe u nisën në një rrugë pa krye dhe çka ndodhi, u kthyen edhe më të varfër, ngase u detyruan të kthehen dhe nuk kishin më edhe ato pak mjete që kishin më parë.

Tani, a po ndodh dalje, po, a është shqetësuese që para ambasadave kudo po shohim të rinj e të reja, të cilët edhe po shpenzojnë taksa, kohë pas kohe dhe nuk po marrin një vizë, qoftë ajo vizë pune apo qoftë edhe një vizë që kërkojnë lëvizje të lirë që po na mohohet padrejtësisht nga Brukseli.

A i kemi kryer detyrat tona, duhet këtu të ndalemi. Nëse i kemi kryer detyrat tona si shtet dhe nëse nuk i kemi kryer, prapë duhet t'i thërrasim në përgjegjësi ata që nuk i kanë kryer.

Por unë konsideroj që ky problem i pandalshëm dhe po na dërgon edhe më tutje, edhe pse në shifra të kontrolluara që janë bazuar në ato që janë të shkruara, preferoj të thirrrem në shifra të shkruara nga institucionet e Republikës së Kosovës, që kjo dalje ishte mbi 167 mijë e sa qytetarë në vitin 2015, për të rënë në 3 554 në vitin 2018.

Por, për mua shqetësuese është edhe një numër shumë më i vogël, në qoftë se vërtetë kërkojnë ta lëshojnë vendin.

A kemi krijuar ne kushte që të ndalim? Unë konsideroj që jo, nga se nuk mund të krijojmë kushte për një vit as dy vjet, as tre vjet, e tha edhe kolegja parafolëse më herët që kjo situatë e krijuar është përgjegjësi e secilit prej neve ndër vite dhe e falënderoj Valentinën që e tha në fillim.

Por, unë kam një propozim konkret sot. Në qoftë se ne si kolegë, si deputetë të të gjitha subjekteve politike, nuk po ndalemi në dokumentet që po i nxjerrim vetë për të kërkuar përgjegjësi prej secilit institucion, nuk po i kryejmë detyrat tona si deputetë, por dokumentet që po i nxjerrim këtu po i lëmë vetë fjetur.

E tani i kam dy propozime konkrete. Për të parë hapat më të shpejtë që mund t'i marrë Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Propozoj që, nën një: Të gjithë deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës, gjatë mandatit të deputetit në këtë legjislaturë të heqin dorë nga ushtrimi i profesionit tjetër përpos deputetit, në mënyrë që t'u jepet mundësi të rinjve dhe të rejave të diplomuar, e që janë të shumë në Kosovë dhe nuk po kanë mundësi të punësohen. Pra, deputetët, deputetët të heqin dorë nga profesioni tjetër, me përjashtim të deputetit, ta bëjmë një sakrificë ne si deputetë.

Dhe, e dyta që propozoj, që nga sot të gjitha grupet parlamentare ta kenë nga një përfaqësues në një grup që kisha dashur ta quaj një komision të ngritur, në mënyrë që deputetët vullnetarisht të heqin dorë nga mëditjet dhe ato mëditjet t'i çojmë në një buxhet, në një buxhet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të shkonte qoftë për favorizimin e bizneseve, të cilët do të punësonin të rinj apo vetë Kuvendi do të hartojë politika se ku do ta dërgonte këtë buxhet.

Pra, janë dy kërkesa që unë prej sot kërkoj që deputetët të deklarohen a do ta bëjmë një hap që ne e kemi në dorën tonë, pa u ndal në thirrjen e përgjegjësisë të secilit ministër dhe Qeverisë në tërësi.

Pra, duke bërë një hap më konkret, ne japim një mesazh të qartë, ngase rrjetet sociale po i përdorim dhe është krejt normale, po në fund të fundit, nuk është bash mirë dhe bash lehtë kur ne postojmë çdo ditë postimet tona nga cilido vend i Evropës, por jo edhe vetëm, deri në Amerikën e Kanada.

Në qoftë se të rinjtë e të rejtat tona të diplomuara dhe në pamundësi për të shkuar dhe për ta vizituar një vend të vetëm, atëherë ne të paktën, edhe nëse e kemi mundësinë për të qenë vizitorë në cilindo vend, atëherë po heqim dorë nga privilegjet e mëditjeve, duke i dedikuar në vend të caktuara, qoftë në biznese apo edhe në punësime të këtyre të rinjve, duke filluar me institucione që do t'i merrni ata për t'u ndihmuar të paktën qoftë edhe për përvojën e punës që mund ta bëjnë, por edhe një pagesë simbolike.

Unë besoj që nuk është buxhet bash i vogël, por të paktën këtë mund ta bëjmë dhe ejani ta bëjmë sot!

Pra, megjithatë, pa hequr përgjegjësinë, sepse doktori është i gatshëm, besoj, sepse mund të ketë edhe një ordinancë, edhe mund ta ketë profesionin e mjekut, mund të kenë shumë të hyra të tjera, janë dy mjekë. Pra, edhe një herë asnjë nuk përjashtohet për të dhënë kontributin e vet.

Andaj, kolegë, unë besoj që ne të gjithë së bashku mund të bëjmë të paktën një hap, kjo është në dorën tonë, pa hequr përgjegjësinë asnjëherë, sigurisht nuk ishe i vëmendshëm, nga ministrët, ministrat apo nga Qeveria në tërësi, pra për të kërkuar çdo ditë në raportim.

Në rezolutën e vitin 2015 i kemi 17 pika, por nuk i kemi kryer detyra duke i thirrur në përgjegjësi edhe komisionet, ku është edhe pikë e veçantë në këtë rezolutë.

Edhe një herë, unë besoj fuqishëm që vullneti i deputetëve do të jetë për ta bërë një hap, të cilin ne e kemi në dorën tonë dhe ne mund të flasim për veten tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputetja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, nënkryetar!

Në fakt, isha në dilemë a të flas apo jo, sepse këto tema të ngritura, sidomos në këto seancat e jashtëzakonshme po përdoren më shumë për një fushatë zgjedhore, për të cilat nuk dimë a kemi zgjedhje a jo, edhe për akuza e kundëraakuza se kush ka më shumë e kush ka më pak faj për gjendjen në të cilën jemi, e jo cilat janë zgjidhjet që ne ofrojmë për të dalë nga situata, në këtë

rast edhe për të pasur një strategji të qartë se çka duhet të bëjnë institucionet tona, në mënyrë që Kosovën ta bëjmë një vend të dëshirueshëm jo vetëm për njerëzit që janë aktualisht këtu, po edhe një numër të madh të njerëzve që kanë dalë më herët, e po të kishte ndoshta politika të drejta do t'u mundësonin atyre që të paktën një kapital të vogël që e kanë kursyer nga puna me dekada që e kanë bërë në vendet ku kanë shkuar, e kanë shkuar për arsye krejt të tjera për çfarë po dalin sot fëmijët ose nipërit e mbesat e tyre, ata do të mund të vinin dhe t'i investonin ato mjete këtu.

Po, prapë seancat janë vetëm akuzë dhe kundërakuzë. Kështu që për temën veç u dhanë edhe akuzat, edhe kundërakuzat, e asnjë zgjidhje konkrete.

Vërejtja ime më e madhe shkon për Kryesinë e Kuvendit, sepse agjendën e Kuvendit më shumë po e përcaktojnë portalet me titujt e tyre, e aty-këtu dikush me statuset e tyre në Facebook, se sa Kryesia e Kuvendit, e cila do të duhej të mblidhej çdo javë, do të duhej të thërriste seance çdo javë, e në rend të ditës do të duhej të ishin ligje e programe të tjera për të cilat Kuvendi ka përgjegjësi.

Janë mbi 60 pika të rendit të ditës, të cilat po barten disa prej tyre prej qershorit të vitit të kaluar dhe ne nuk po arrijmë as të diskutojmë për to, e le më t'i votojmë, sepse ndoshta aty është zgjidhja që do të parandalonte ikjen e qytetarëve prej vendit.

Së fundit, ta zëmë, si shembull, e kemi një ministre të re të Bujqësisë, është koha e pranverës, kur në bujqësi është vlugu më i madh i punëve ndoshta, më mirë do të ishte që të organizonim, nëse është e nevojshme edhe seancë të jashtëzakonshme, të shohim cili është plani, si do t'i ndihmojë fermerët që të mos ikin në Gjermani e në Zvicër e kudo tjetër, po të mund ta punojnë tokën e tyre dhe të krijojnë të hyra këtu.

Shumë shpejt vjen fundi i vitit shkollor, po ne kemi diskutuar për orët e humbura, por a nuk do të duhej të diskutonim edhe për programet e reja, qoftë në universitete, qoftë në shkolla profesionale, e të cilat do t'i nxisnin të rinjtë që t'i ndiqnin ato shkolla, qoftë profesionale apo programet e universiteteve, të cilët do t'u ndihmonin ta gjenin një vend pune apo ta krijonin një vend pune këtu në Kosovë e të mos kërkonin të ikin. Unë nuk besoj se ky debat i sotshëm ua mbush mendjen atyre njerëzve që janë duke pritur për viza pune që të mos ikin, sepse ne sot u kemi ofruar atyre një zgjidhje. Përkundrazi, unë mendoj që edhe kjo seancë është edhe një arsye më shumë që ata që e kanë mendjen në dysh të rrinë apo të shkojnë, më shumë do të vendosin të shkojnë, të ikin, se sa të rrinë këtu, sepse ne nuk po ofrojmë zgjidhje.

Kuvendi është shndërruar në vend akuzash e kundërakuzash, të cilat shpeshherë bëhen edhe me gjuhë fyese, por asnjëherë duke ofruar zgjidhje, le që Qeveria nuk po e bën, por as deputetët dhe krejt këto seanca më shumë po shërbejnë për një shou se sa për të ofruar zgjidhje konkrete, qoftë afatshkurtër, qoftë afatgjatë, edhe atëherë kur ne kemi tentuar të bëjmë ndonjë zgjidhje, së shpejti

kemi për t'i parë pasojat se kemi bërë më shumë keq se sa mirë, ta zëmë, siç është rasti me Ligjin për lojërat e fatit, ne e votuam, i ndaluar ato, por tani kanë vërshuar kërkesat, akuzat, për të cilat ndoshta Qeveria do të jetë e detyruar të paguajë, sepse nuk ka pasur strategji se si me të vërtetë duhet t'i ndalim ato. Kështu që çdo diskutim i pamenduar, i paanalizuar mirë, por vetëm si reagim i titujve të portaleve dhe çdo vendim, i cili nuk analizohet edhe për përfitimet që mund t'i ketë një vendim, një politikë e tillë, por edhe për pasojat që mund t'i ketë, kam frikë se vetëm do ta përkeqësojë gjendjen në këtë vend e nuk do të ofrojë zgjidhje. E, kështu po më vjen keq, por po e shoh edhe seancën e sotshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Veton Berisha.

VETON BERISHA: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë jam një prej nënshkruesve të iniciativës për t'u mbajtur kjo seancë e jashtëzakonshme, për shkak se iniciativa ka dalë nga Grupi joformal i të Rinjve, si çështje me të cilën ne kemi filluar të preokupohemi dhe arsyet e gjendjes të jashtëzakonshme tani të krijuar në Kosovë, po konsiderojmë që ka qenë e nevojshme të mbahet kjo seancë e jashtëzakonshme.

Unë domethënë në fjalimin tim paraqes vetëm qëndrimin tim, domethënë si përfaqësues i komunitetit egjiptian në Kuvendin e Kosovës dhe normalisht që kjo mbetet shqetësuese, domethënë çështja në fjalë e largimit të qytetarëve nga Kosova po ashtu mbetet shqetësuese edhe për komunitetin tim egjiptian dhe kjo nuk është vetëm aktuale, domethënë e ditëve të sodit. Unë me këtë problematikë jam ballafaquar që nga viti 2014, domethënë qysh prej asaj kohe jam marrë me problematikën e largimit të njerëzve dhe, fatkeqësisht, në atë kohë ka qenë periudhë kur njerëzit dhe familjet janë nisur dhe janë larguar nga Kosova në rrugë ilegale. E mira e kësaj është tash në këtë vit që po flasim që largimi po bëhet në rrugët legale, të paktën njerëzit po sigurojnë një kontratë pune, po sigurojnë një rrugë legale të largimit dhe aq më tepër nuk rrezikohet jeta e tyre gjatë largimit nga Kosova.

Sigurisht, ikja e të rinjve nga Kosova është shqetësuese, pasi që trendit të ikjes nuk i përjashtohen edhe të rinjtë nga radhët e komunitetit egjiptian. Mungesa e vendeve të punës dhe humbja e shpresës për një jetë më të mirë, janë arsye kryesore për lëshimin e vendit për të siguruar një jetë më të mirë. Ne duhet të bëjmë krejt çfarë është e mundshme, duke filluar nga institucionet lokale dhe qendrore, fillimisht për të kthyer besimin e qytetarëve në institucionet tona, do të punohet në një plan në nivel shtetëror për të krijuar vende pune dhe për të ofruar trajtim të barabartë për të gjithë, e në veçanti për komunitetet. Mendoj që gjendja e akumuluar dhe situata e krijuar më bën të shqetësohem për faktin që ndryshimet dhe pozicionimi i komunitetit egjiptian në institucionet publike, sidomos në implementimin e Ligjit për shërbimin

civil që nga ndërprerja e mbikëqyrjes ndërkombëtare nuk shohim një lëvizje të institucioneve të Kosovës në drejtim të implementimit të ligjeve në fuqi.

Kosova ka krijuar mekanizëm ligjor edhe po konsiderohet që është vendi më i sigurt, edhe i cili ka garantuar të drejta edhe mundësi për komunitetet, por vërtet praktika nuk po e dëshmon të njëjtën dhe që nga viti 2008 e tutje kemi mosvullnet ose mosiniciativa proaktive të institucioneve në raport me implementimin e ligjeve që janë në fuqi. Po u referohem statistikave të shërbimit civil, akoma mbeten vetëm 14 të punësuar në nivel qendror dhe lokal, e për komunitetin egjiptian normalisht që mbetet shqetësuese. Ditëve të sodit ka qenë aktuale përfshirja e komunitetet egjiptian në institucionet e sigurisë, e në veçanti në Policinë e Kosovës, ku në mesin e 80 kandidatëve, të cilët kanë qenë kandidatë në Policinë e Kosovës, ka arritur të kalojë vetëm një i tillë dhe ai akoma është në faza testuese, ku deri në fund të përgatitjes së tij mund të largohet. Pse po e them është shqetësuese, për shkak që Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës ka pasur bazë të mjaftueshme kushtetuese dhe ligjore që të ngre nivelin e përfaqësimit, sidomos në institucionet e sigurisë, e me këtë rast në Polici, për faktin që Kushtetuta thotë që në secilin vendbanim ku ka komunitete të caktuara, ministria duhet të parashohë, të krijojë politika që të ketë edhe policë në proporcion me numrin e banorëve.

E njëjta ndodh edhe në Doganat e Kosovës, në Forcën e Sigurisë, si gardian e tjerë. Mosrespektimi i Ligjit për shërbimin civil dhe mospërfillja e infrastrukturës ligjore, Rregullores 04/2010, na bën të shqetësohemi për faktin që me këtë Rregullore, ligji dhe Rregullorja i ka dhënë mundësi Ministrisë së Administratës Publike që të ndërmarrë veprime dhe të japë mundësi të barabartë ose të favorizojë pjesëtarët e komuniteteve që të jenë të punësuar.

Aktualisht nuk shohim një praktikë të tillë, aq më tepër ministria ka shkuar në ndryshim të ligjit që vërtet na bën të ndihemi akoma më të pasigurt. Arsye tjetër pse largohen të rinjtë e komunitetit egjiptian është cilësia e jetesës, mënyra e vendbanimit si jetojnë, kushtet e krijuara, mospajtimet në pronat e tyre publike dhe, në një formë, domethënë i bënë të pasigurt që aty të ketë një jetë më të mirë. Po ashtu, mbesim të shqetësuar edhe me sektorin privat thjesht, duke paragjykuar mbi bazën etnike, prejardhjes etnike, ne numërojmë shumë pak të punësuar edhe në sektorin privat, pavarësisht se punët e tilla në sektorin privat mund të kryhen nga secili pjesëtar i komunitetit tonë. Jemi dëshmitarë të reagimit të secilit aktivitet që bëhet prej komunitetit tonë nga shoqëria kosovare, ku në secilin rast, qoftë në portale, media, rrjetet sociale, kudo në rrugë ka qasje inferiore të qytetarëve ndaj neve dhe aq më tepër paragjykuese, me gjërat, të cilat janë të pabaza dhe të cilat nuk qëndrojnë fare në mesin tonë. Dhe, unë nga këtu i bëj thirrje secilit institucion që vërtet të ndikojë pozitivisht në ndryshimin e kësaj qasjeje në raport me vlerësimin tonë që na bëhet në shoqëri, ku na jepen epitete që vërtet secilin qytetar nuk do ta bënë të ndihet mirë.

Arsye tjetër, ndahen shumë grante, qoftë në bujqësi dhe subvencione për start up, për bizneset e vogla dhe nëse i mbledhim statistikën, vërtet këto ndarje të këtij buxheti janë minimalisht që arrijnë te komuniteti ynë. Janë forma tepër të vështirësuar dhe asnjëherë shoqëria jonë e komunitetit egjiptian nuk ka arritur të jetë e barabartë dhe të aplikojë barabartë, sepse nga vetë institucioni nuk ofrohet mundësi që të ketë më tepër qasje te këto grante. Duke mos qenë person që dëshiron largimin e qytetarëve nga Kosova, pa dallim, me këtë rast unë u lutem institucioneve të Republikës së Kosovës, kryeministrit Haradinaj dhe ministrive të linjës që të ndërmarrin çfarëdo veprimi për implementim të Kushtetutës dhe ligjeve dhe të krijojnë perspektivë për të gjithë qytetarët, pa dallim, e në veçanti për komunitetin egjiptian. Unë nga këtu mendoj që duhet të ketë vullnet politik, sepse mjafton që ka bazë kushtetuese dhe ligjore dhe është mirë që dëshmohet që shteti, ligjet dhe Kushtetutën që e ka bërë, e ka bërë me dëshirën e vet, pa presion ndërkombëtar, pa u detyruar për t'u treguar i afërt me komunitete dhe mendoj që një shoqëri do të vlerësohet pozitivisht nëse komunitetet pakicë të tyre në shtetin e tyre janë dhe ndjehen mirë. Kështu që, faleminderit zoti nënkryetar dhe shpresoj të dalim me një rezolutë, e cila sadopak do të ketë efekt në sensibilizimin e institucioneve në raport me pozicionimin e komuniteteve tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e ka deputeti Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, nënkryetar!

Kolegë të nderuar,

Shpërngulja apo sfida e shpërnguljes mendoj që nuk është një gjë tragjike duke marrë parasysh që viteve më herët janë shpërngulur edhe në formën më të keqe se sot, tani qytetarët tonë janë duke e kërkuar një jetë më të mirë.

Cila është arsyeja që ata shpërngulen? Kjo është e rëndësishme. Arsyeja është mosedukimi cilësor, pabarazia, papunësi e madhe, pasiguria, punësimi me ngjyra apo me grupe, natyrisht është një standard i dyfishtë, sikur që është edhe nëpër universitete, prandaj, çdo i ri dhe jo vetëm të rinjtë e kërkojnë një jetë më të mirë. Njeriut kur t'i humbë shpresa, natyrisht që lyp rrugë alternative dhe kjo nuk është vetëm sot, kjo është që pasluftës e deri më tani, do të thotë nuk është asgjë që është krijuar tani në këtë Qeverinë e tashme apo vetëm në të kaluarën, por në shumë faza qeveritare janë grumbulluar. Një shembull i thjeshtë, nëse një njeri sot punon dhe atij i skadon kontrata e punës, cila është shpresa për ta? A është fondi i punësimit, i cili atij ia vazhdon edhe gjashtë, tetë muaj apo edhe një vit, sikur që është në Perëndim, jo. Për çka atëherë i paguan ato taksa? Prandaj të gjitha këto grumbullime e krijojnë një shpresë për të shkuar jashtë vendit. Ne duhet t'i falënderohemi Bashkimit Evropian, e në veçanti shtetit gjerman, i cili u ka ofruar mundësi që ata të shkojnë në mënyrë legale, në mënyrë të rregullt dhe të punësohen. Ajo është gjysma e asaj që ne po qajmë sot me lot krokodili. Ne duhet t'u sjellim kushte që dikush të vazhdojë këtu.

Cila është, për shembull, një bujk sot, cilën shpresë e ka tek ne? Atje kur garon diku me një subvencion dhe sigurisht që përfitues është ai i cili nuk e ka fare tokën dhe pastaj kthehet i thotë: “A do ta shes unë kultivatorin, se unë e kam marrë”. Ai i cili s’ka pasur tokë. Domethënë, standarde të dyfishta, pabarazia, pasiguria, kjo do të nxisë ende më shumë largimin. Unë mendoj se në Kosovë është mundshme të jesh i punësuar vetëm në pjesën e bizneseve private, e ajo në institucionet publike mendoj që është e stërngarkuar dhe është e pamundshme, e nëse vjen deri te ajo, vjen me ngjyrë politike dhe me përkrahje të partive të ndryshme, por në asnjë mënyrë me kualitet, me cilësi nuk vjen në shprehje, nuk bëhet e mundshme. Prandaj, unë kisha lutur që ne çfarëdo rezolute që të nxjerrim, të kërkojmë të jemi të barabartë kudo që të jemi, si në studime, punësim, si në çfarëdo institucioni, prandaj po të rregullohej kjo, sigurisht që nuk do të kishte shpërngulje, por shpërngulja e sotme nuk është në mënyrë ilegale, është në mënyrë të drejtë, me punësim dhe secili qytetar ka të drejtë që ta kërkojë një jetë më të mirë.

Unë kisha bërë apel që ne të reflektojmë, të mos keqpërdorim, të mos flasim vetëm fjalë këtu në Parlament, por kudo që punojmë, si te deputeti, ministri, profesori, doktori, si te të gjithë, të bëjmë punën të drejtë. Ju duhet kuptuar që gati të gjitha partitë janë të përfshira nëpër komunat e Kosovës, cila komunë nuk ka shpërngulje sot? Le të më tregojë këtu një, le të thotë ky është fajtori. Fajtori është i përgjithshëm dhe ne duhet kërkuar këtë të përgjithshmin. Nëpër të gjitha komunat sot kemi shpërngulje, prandaj problemi është i të gjithëve dhe ne duhet si tërësi të reflektojmë dhe të ndryshojmë qasjen tonë ndaj qytetarit, qasjen tonë ndaj rinisë, rinia lyp jetë më të mirë, por jo vetëm të gjejë prindin apo dikë atje që duhet ta përkrahë, se përndryshe, edhe pse i plotëson kushtet, nuk vjen në shprehje, ne duhet të reflektojmë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, nënkryetar Shala!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, nuk ka temë pothuajse që po sillen këtu në Kuvend dhe nuk po e lëshojmë në nivel të diskutimeve, rreth asaj se cilët eventualisht mund të fitojmë ndonjë votë në terren. Unë mendoj që kjo është tema ndër më të ndjeshmet në Kosovë dhe që në fakt, duhet të jetë tema e cila duhet të na bashkojë të gjithëve, sepse jam i sigurt që as pushtetit dhe as opozitës nuk i duhet një Kosovë e zbrazët.

Ne mund të bëjmë garë, a më 2015 kanë ikur më shumë apo me 2018-2019 po ikin më shumë, po kjo s’na bën nder askujt, sepse rezultati final është: Kosova po zbrazet. Në fakt, unë po e shoh më tepër si një dështim komplet i elitave tona politike, kulturore, sociale dhe të gjitha fushave, të cilët ne i kemi pasur që nga paslufta e deri sot në realizimin e shtetit të Kosovës. Tash normalisht që disa kanë faj më shumë, disa kanë faj më pak, por sidomos ata që kanë qenë gjatë në pushtet faji më i madh bie mbi ta. Si është e mundur që 20 vjet pas luftës në Kosovë pothuajse çdo i dyti

njeri që jeton në Kosovë ta projektojë të ardhmen e tij jashtë Kosove? Unë i mora disa të dhëna nga Ambasada Gjermane dhe e pashë që diku vetëm për vitin 2017-2018 janë lëshuar 39 mijë viza pune, ndërkohë e kuptova që edhe 79 mijë janë në proces. Domethënë, po flasim vetëm Ambasada Gjermane 120 mijë kërkesa për vizë pune, 79 mijë në trajtim, ndërkohë afro 35 mijë veç i kanë lëshuar dhe tash njerëzit po realizojnë këtë të drejtë dhe të mos flasim edhe për ambasadat e tjera.

Unë po i shoh dy fenomene këtu, e para po ndodh për shkak që disa njerëz të rinj, dhe jo vetëm të rinj, po ikin nga varfëria, por ka edhe njerëz të tjerë, të nderuar deputetë, që po ikin për shkak të mbytjes së shpresës. Dhe, mbytja e shpresës nuk është akt, nuk është një akt i izoluar që ndodh: sot u mbyt shpresa dhe njerëzit dalin e ikin. Jo, jo, ky është proces, proces që na ka ndodhur që nga paslufta e deri sot dhe për fatin e keq s'kemi asnjë përpjekje që këtë ta ndalim. Madje, kur e shoh tash një garë, jo kanë ikur në kohë tuaj, jo në kohën tonë, po e shoh deri ku shkon paskrupullsia e këtyre njerëzve dhe më së paku e kanë gajlen se si Kosova po zbrazet. Unë jam i vetëdijshëm që askush nuk e ka shkopin magjik për t'i zgjidhur problemet, por së paku përkushtimin do të duhej ta kishim që ne jemi në funksion të asaj që të ndalet ky trend. Por, çka po shoh sidomos te kjo Qeveri? Nëse ne i rritim pagat në sektorin publik dhe puna e parë që bëhet ia rrit pagën vetes kryeministri, cili është mesazhi për njerëzit që jetojnë në Kosovë? Që ju, Zoti ju ndihmoftë juve, unë e kam për obligim dhe për mision ta rehatoj veten, familjen time, eventualisht dhe rrethin tim. Dhe, tash mesazhi që bart për këto është në funksion të mbytjes së shpresës. Cila ishte deklarata e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës, zotit Xhavit Haliti, me një emision. I thotë moderatorit: “Ka 2-3 milionë euro secili i kemi sot në Kosovë”, merreni me mend çka thotë, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, thotë “2-3 milionë euro secili sot i ka në Kosovë”. Njerëzit janë në rrezik për mbijetesë, për 200-300 euro dhe cili është mesazhi që u bart njerëzve që jetojnë në Kosovë? Ju që jeni larg politikës, ikni, se s'keni vend në Kosovë, sepse ne kah 2-3 milionë nuk i bëjmë as llaf.

E, cili është mesazhi kur dikush i bën 4 shtëpia në Marigona Residenc? E, cili është mesazhi kur Presidenti ndërton shtëpi luksoze? Cili është mesazhi kur ne një prokuror thotë: “Hej, kadal se i kemi diku 30 mijë veteranë të rrejshëm”, kërcënohet, detyrohet të ikë. Cili është mesazhi kur Policia e Kosovës përfshihet në krim të organizuar? Dhe, krejt këto nuk mund të shihen të izoluara. Punësimet familjare, disa herë kemi folur këtu, duhesh pasur nënën deputete, duhet pasur kryeministrin kunat, duhet pasur dhëndrin deputet për të hyrë në punë, përndryshe vaj halli për ty, merre valixhen, apliko diku dhe ik prej Kosovës. Dhe, kjo më pas kur lëshohen në nivel, domethënë nuk është bre shqetësim se krejt bota po lëviz! Hej, nuk jemi 1 miliard ne sikur kinezët, që mos ta kemi telashe pse njerëzit po na ikin. Ne duhet ta kemi shqetësim serioz. Unë mendoj ndër shqetësimet më serioze të këtij vendi mbytja e shpresës për të jetuar në Kosovë dhe po them, nuk është vetëm për të papunët, është edhe për njerëzit, të cilët madje kanë të ardhura të mira, por ia kemi mbytur shpresën se këtu mund të ketë rend dhe ligj, këtu mund të ketë shëndetësi cilësor, këtu mund të ketë arsim cilësor apo diçka të ngjashme.

Unë po e marr shembull në fshatin tim të lindjes, në Mushtisht të Suharekës, 250 shtëpi janë mbyllur, s'jeton asnjë njeri, krejt kanë ikur prej aty, ndër fshatrat më të mëdhenj në Kosovë. Vetëm në Prizren, në Gjykatën e Prizrenit e mora këtë statistikë, për muajin janar dhe shkurt 3 mijë e 400 kërkesa për certifikatë që s'janë nën hetime, shumica prej tyre lëshohen ose për heqje dorë nga shtetësia, ose për një vizë pune dhe kjo më pas na nxjerrë me një rrafsh se nuk është shqetësim, se krejt bota lëviz. More, po ju them përsëri, as LDK-së, as Vetëvendosjes, as PDK-së, as askujt nuk i duhet Kosova pa njerëz. Hiç nuk ka rëndësi a në kohën e Isa Mustafës paskan ikur 150 mijë apo sot po largohen 700 mijë!

Nuk është me rëndësi çfarë kohe, me rëndësi është që Kosova po zbrazet dhe ky duhet të jetë shqetësimi më themelor. Dhe, unë kam një propozim që në fund ne jo të nxjerrim një rezolutë, po Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës të kujdesen që ta shpallin gjendjen e jashtëzakonshme për një periudhë për ta trajtuar këtë tematikë, ta ngremë vigjilencën institucionale në maksimum, për të bërë projekte konkrete se si ta ndalim këtë trend të rrezikshëm për Kosovën. T'i heqim projektet e autostradave nga 1 miliard euro, për kënd po i shtrojmë ato? Për njerëzit që po ikin? T'i heqim festimet nga 500 mijë euro për pavarësi, për kënd po festojmë? Për njerëzit që po ikin? Për kënd do të jemi ne nesër deputetë këtu? Në fakt, për kë jam unë sot, po e shtroj pyetjen shumë themelore. Nëse vëllai im, familjarët e mi provojnë të ikin, atëherë çka jemi duke bërë ne këtu? Për t'i gëzuar disa privilegje individuale, unë mendoj që e kemi shumë gabim.

Përtej qasjes populliste, përtej asaj që mua më duket politike, ne duhet të sillemi si njerëz normalë, duhet t'i mbrojmë jo vetëm të rinjtë, por të gjithë ata, të cilët kanë filluar, për fatin e keq, ta projektojnë të ardhmen e tyre jashtë Kosovës. Po ikin mjekët, me qindra e mijëra, inxhinierët, njerëz të kualifikuar dhe krejt këto normalisht përgjigja përfundimtare kur po e shoh, tendencë për relativizim maksimal. Nuk guxojmë, unë po ju lus, të bëhemi bashkë për këtë temë, është ndër temat e rralla ku ne duhet të kemi konsensus nacional, se si në të vërtetë ta ndalim këtë trend. Nuk jam i sigurt që mund ta ndalim, por së paku dëshmojmë përpjekje, puna e parë që do duhej ta bënim do të ishte që as të mos flasim për rritje pagash në sektorin publik, por për ulje, së paku në solidaritet me ata që nuk punojnë, së paku të krijojmë hapësirë për bizneset dhe për ekonominë e lirë të tregut që të vijnë në konsideratë projektet zhvillimore të tyre, por jo të mendojmë që ne luksi na ka kapluar aq shumë sa që nuk po i shohim më as qindra njerëz duke pritur para ambasadave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Çështja për të cilën edhe unë kam nënshkruar kërkesën për seancë të rregullt, por që doli e jashtëzakonshme, është pikërisht migrimi i gjithë popullsisë, pa përjashtim, por çështja e migrimit nuk është një çështje vetëm që lidhet me sot, me dje, por ajo do të lidhet edhe në të

ardhmen, për shkak se njerëzit kërkojnë, kanë për të kërkuar një siguri më të mirë, një mirëqenie më të mirë dhe një jetesë po ashtu, në përgjithësi.

A do të jemi ne që do të sigurojnë këtu një gjendje të tillë, unë mendoj që ka mundësi, ka hapësira, ka edhe vend që të sigurohet. Po, ka edhe të meta, të cilat kemi qenë mjaft ndoshta të kushtëzuar, mjaft edhe të shantazhuar nga Bashkimi Evropian, me kushte ekstreme, të cilët kanë ndikuar edhe në humbjen e shpresave të njerëzve. Një nga to kanë qenë edhe kushtet për liberalizim, më '94-'98 standarde të cilat "jo i keni plotësuar, jo s'i keni plotësuar".

Edhe demarkacionin e futën në punë për standarde, edhe atë e plotësuan. Prapë nuk ka liberalizim, kështu që një nga humbësit e shpresës është pikërisht kërkesa për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, ndërsa Bashkimi Evropian është me kushtet ekstreme ndaj nesh. Cila është arsyeja që i kanë vendosur këto, është po ashtu edhe politikat e raporteve Kosovë-Serbi, që kanë hyrë si çështje e dialogut. Dialog i brendshëm, dialog teknik, dialog politik, dialog, dialog, edhe pa fund dialog.

Çështje tjetër që është po ashtu, është drejtësia një nga segmentet të cilat njerëzit e krijojnë sigurinë ose pasigurinë, ose e humbin shpresën apo e krijojnë besimin për të qëndruar. Sistemi i drejtësisë nuk është aktiv, është neglizhent, po prapë nuk duhet të akuzohen ata sa duhet të akuzohen deputetët me Kodin Penal që e kanë miratuar, i cili i ka dhënë mundësinë e humbjes së shpresës, sepse pas këtij Kodi janë bërë shumë ndryshime, të cilat në emër të demokracisë, është shkelur demokracia, është shkelur liria individuale, liria familjare dhe çdo gjë.

Çështja e arsimit dhe e edukimit po ashtu është një çështje mjaft e rëndësishme që kemi ngritur sa herë me vite të tëra nuk kemi arsim cilësor, nuk kemi edukim cilësor. Pikërisht hapja edhe pa kriter, hapja e fakulteteve me lëndë të njëjta, me programe të njëjta. Ku do të absorbohen ta zëmë mbi dy mijë juristë të regjistruar brenda një viti akademik? Ku do të absorbohen p.sh. diku 500 mjekë, po ashtu brenda një viti akademik, nëpër spitale, në Fakultet të Mjekësisë edhe në fakultete private? Prandaj nuk ka një planifikim të politikave të arsimit, dhe kjo është një nga ato që e ka ngritur këtë çështje.

Çështjet e migrimit nuk janë të sotshme. Migrimet kanë qenë shekullore. Po migrantët tanë kanë qenë shpeshherë edhe thelbi i çështjes kombëtare. Pikërisht nëse ju kujtohet Vaso Pashë Shkodrani apo Pashko Vasa me poemën e tij "O moj Shqypni", është pikërisht ajo poemë nga një migrant, nga një luftëtar, nga një republikan dhe nga një pasha që i bën thirrje shqiptarëve për mbrojtje dhe ngritje të identitetit.

Prandaj, për të pasur një mirëqenie, një qëndresë, një angazhim, deputetët diskutojnë, por barabarësia para ligjit edhe para drejtësisë është, që thanë edhe disa deputetë, që ishte një diskriminim për mua i papajtueshëm. Nuk është këtu çështja e një komuniteti. Këtu është çështja

e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh cilat komunitete. Sa janë nxënësit të shpërngulur të larguar ose të migruar nga Prizreni nga ajo parti, ose nga ajo qeveri, ose nga ai pushtet pse nga ky pushtet, njëjtë është Prishtina, njëjtë është Prizreni, njëjtë është Gjilani, njëjtë është Mitrovica, njëjtë Podujeva apo Ferizaj e të tjera. Njëjtë janë migrimet, të njëjtin qëllim e kanë.

Çështja a po zbrazet Kosova, duhet të diskutohet çështja e drejtësisë. Çështja e respektimit të ligjit. Për mua është çështje ndërtimi i politikave të qëndrueshme për zhvillim të vendit, të cilin ne e mbështesim dhe duhet ta mbështesim. Prandaj, ngritja e kritereve, forcimi i kritereve në edukim, në arsim, zhvillimi i politikave arsimore, politikave të zhvillimit ekonomik, përmirësimit të kushteve të jetesës, po një nga ato është drejtësia që duhet të jetë prioritet kryesor i Qeverisë dhe shtetit për të parandaluar dhe për të krijuar besimin te qytetarët se ky vend mund të zhvillohet, mund të qeveriset, mund të drejtohet dhe mund të jetë për të gjithë qytetarët e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës dhe deputetë të Kuvendit!

Njerëzit më shumë po ikin sesa që po shkojnë. Kur shkon, është e rëndësishme ku po shkon. Kur ikën, është e rëndësishme prej nga po ikë. Dhe këtu më shumë kemi të bëjmë me ata të cilët po ikin përgjithësisht prej Kosovës sesa me ata që specifikisht po shkojnë në ndonjë vend të caktuar.

Njerëzit ikin nga ky shtet, sepse iku edhe prokurori si puna e Elez Blakajt nga Kryeministri e Qeveria. Kosova është një vend prej nga nuk po ikin kriminelët, por po ikin prokurorët. Edhe ish-ambasadori amerikan Greg Delawie, me 15 gusht të vitit të kaluar pat thënë, po citoj: Kemi parë frikësim të hapur politik dhe institucional nëpërmjet kërcënimeve dhe sulmeve personale kundër një prokurori, sjellje që vetëm mbështetin pohimet e tij për kërcënime dhe presione politike, si arsye për dorëheqjen e tij. Kjo krijon mjedis armiqësor për cilindo prokuror apo gjykatës të ardhshëm. Për t'i kthyer njerëzit, ne duhet ta kthejmë njëherë Elez Blakajn. Për të pasur prokurorë e gjykatës në një sistem të drejtësisë, ne duhet ta kthejmë njëherë Elez Blakajn.

Emigrimi që ndodhë tek ne, natyrisht se ka shkaqe të fuqishme ekonomike. Neve na ka ikur paraja, e kur ikë paraja - ikin njerëzit. Me këtë deficit tregtar, ne po zbrazemi nga paraja e më pas edhe nga njerëzit. Ndërkohë, mbi 90% të fondit të kursimeve pensionale të Kosovës, i cili është rreth 1,7 miliardë euro ndodhet jashtë vendit. Banorët e Kosovës, qytetarët e Republikës, i kanë diku 3,5 miliardë kursime në 10 banka, prej të cilave 8 janë të huaja, dhe i kanë 2,7 miliardë kredi me kamata mesatarisht 7%, ndërkohë që interesi në depozita është vetëm 1%. Ne nuk kemi një bankë zhvillimore tonën, ndërkaq Bashkimi Evropian e ka BERZH-in. Pra, BE-ja ka një bankë zhvillimore për neve, e ne nuk e kemi për vete. Orientimi i gabuar socio-ekonomik natyrisht që shkakton edhe këtë lloj krize të madhe për njerëzit në shoqërinë dhe në vendin tonë.

Mirëpo, unë këtu dua të theksoj diçka e ndërlidhur, e megjithatë pak tjetër. Është hendeku i shkathtësive. Mungesa e lidhjes së ekonomisë me arsimin, të arsimit me ekonominë. Sa është e rëndësishme ekonomia, sa është e rëndësishme arsimi, edhe më i rëndësishëm është lidhja midis këtyre dyjave. Dhe, unë besoj që ky është mbase shkaku kryesor i ikjes së të rinjve.

Sipas raportit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë të vitit të kaluar, thuhet që “shkollat profesionale ballafaqohen me vështirësi të konsiderueshme financiare dhe shumë nga to kanë objekte të vjetra, që nuk ofrojnë kushte për të përgatitur studentët për tregun e punës. Studentëve po ashtu u mundon përvoja praktike si rezultat i mungesës së programeve të punës praktike. Kosova duhet të zhvillojë një qasje të ngjashme me atë të Gjermanisë sa i përket aftësimin profesional. Sistemi dual gjerman parasheh që studentët e shkollave profesionale të kombinojnë teorinë me përvojë praktik në sektor privat, duke kaluar tri ditë të javës në shkolla, ndërkaq dy ditë në kompani të sektorit privat”. Dhe, më tutje, pjesa më e madhe boshllëkut të shkathtësive raportohet në profile që nuk mbulohen nga sistemi arsimor në vend. P.sh. përkundër që inxhinieria e prodhimit është një shkathtësi shumë e kërkuar në mesin e kompanive të prodhimit, asnjë institucion arsimor në Kosovë, nuk përgatit kandidatë për këtë profil.

Boshllëku i shkathtësive është pra në thelb të gjendjes alarmante në të cilën gjendemi sot. Këtu unë do të kisha theksuar edhe një fenomen tjetër shoqëror është mungesa e banesave për çiftet e reja. Të gjithë jemi dëshmitarë se të rinjtë e të rejtat në të 20-tat e tyre fejojnë edhe kalojnë vite të tëra e nuk martohen se s’kanë ku martohen. Janë të panumërta rastet kur çiftet e reja dalin të banojnë me qira dhe detyrohen të kthehen te prindërit dhe ndoshta një ditë edhe ikin nga vendi, ndërkaq ne si infrastrukturë e mendojmë vetëm asfaltin, e jo banesat për çiftet e reja. Banesat për çiftet e reja janë tejet të rëndësishme në mënyrë që të mos ikë rinia.

Gjysma e remitançave, që dërgohet nga bashkatdhetarët tanë, shfrytëzohet për konsum të përditshëm. Vetëm 10% për investime. Ndoshta mërgata e Armenisë, hebreje, greke apo irlandeze sjellin më shumë para në vendet e tyre, mirëpo jo në raportin një me dy me buxhetin e shtetit sikurse që është te ne. Mërgata jonë i sjell mbi një miliard euro në vendlindje, ndërkaq buxhetin e shtetit e kemi dy miliard euro. Këso raporte nuk ka askund në Evropë, mbase edhe në botë është vështirë të gjendet.

Por, në vend se këto të jenë faktor ekonomik, janë veçse faktor social për mbijetesën nga muaji në muaj. Prandaj, ne kemi nevojë për një konferencë kombëtare të investitorëve, ku theksi është te diaspora, te mërgata jonë, por për këtë është e nevojshme sundimi i rendit dhe i ligjit në Kosovë. Sipas shënimeve të para dy vjetëve, s’besoj të jenë përmirësuar koha mesatare në Kosovë për zgjidhjen e kontesteve ekonomike është 658 ditë. Pra kur lexohen këto shifra është shumë vështirë të investojë edhe shqiptari ynë se lëre me një i huaj. Ndërkaq dihet se bizneset nuk kanë dëshirë që t’i shtrojnë binarët e hekurudhës në shkretëtirë. Duhet që dikush ta vendosë një shtresë paraprake. Pikërisht këtë mund ta bëjë mërgata jonë. Kur investon biznesmeni shqiptar

nga Gjermania, Zvicra e SHBA-të, shumë më kollaj vjen pastaj edhe biznesmeni gjerman, zviceran apo ai amerikan.

Ka një studim, i quajtur Kthimi i trurit dhe Diaspora shkencore shqiptare. Për Shqipërinë është bërë. Nuk ka lexuar diçka të ngjashme për Kosovën, po urgjentisht është e nevojshme, që thotë se duhet të ketë së paku 2500 shqiptarë me doktoratura dhe kandidatë të doktoratës në vendet e zhvilluara të OECD-së. Rreth 62 për qind të tyre punojnë në universitete dhe institucione hulumtuese, dhe gati 97 për qind e atyre që janë përgjigjur dhe që kanë përfunduar një doktoratë jashtë vendit, kanë gjetur punë që përpunet gjerësisht me nivelin e kualifikimit.

Ne e kemi edhe këtë problem të madh, jo vetëm që i kemi 20 mijë të rinj e të reja me fakultete e pa punë, po i kemi edhe një numër shumë të madh të njerëzve të cilët kanë mbaruar fakultetin, po nuk punojnë në profesion. Dhe kjo është shumë frustruese. Kur studion katër vjet, pesë vjet apo gjashtë vjet dhe në fund bën një punë për të cilën nuk të hyn në punë shkollimi yt, kjo me siguri se është shumë frustruese. Rreth 19 për qind të atyre që kanë doktoratë ose kandidatë për doktoratë jashtë, kanë studiuar ose janë duke studiuar shkenca sociale, 18 për qind biologji, matematikë ose fizikë, 17 për qind ekonomi dhe studime biznesi, 14 për qind mjekësi ose diçka që lidhet me këtë, 13 për qind inxhinieri apo ndërtimtari dhe 10 për qind shkenca kompjuterike apo elektronikë.

Diaspora shkencore shqiptare, veçanërisht gjenerata e parë mban lidhje të ngushta me vendin e origjinës. Sipas studimit, 96 për qind e shqiptarëve që kanë doktoruar mbajnë kontakte të rregullta me vendlindjen. Rreth 75 për qind vizitojnë Shqipërinë gjatë pushimeve, një herë ose më shumë gjatë vitit për të vizituar edhe prindërit, të afërmit dhe miqtë. Të dhënat e studimi tregojnë se 17,1 për qind e shqiptarëve që kanë doktoruar dëshirojnë të kthehen, 49,7 për qind thonë se ende nuk kanë vendosur dhe 33,2 për qind thonë se nuk duan të kthehen. Pra më shumë se çdo i gjashti dëshiron të kthehet. Gjysma nuk e kanë vendosur, ndërkaq një e treta nuk duan të kthehen. Pra, atje ka mendim për t'u kthyer dhe dëshirë për t'u kthyer, por kjo tashmë nuk varet prej tyre, kjo varet prej neve se çfarë shteti ndërtojmë ne, çfarë kushte ofrojmë për ta. Edhe shtetet tjera kanë pasur kriza të ngjashme sikurse ne por ia kanë dalë. Ka pafund përvoja nga të cilat mund të mësojmë në mënyrë që edhe ata që kanë menduar të ikin, të mos kenë arsye, por edhe ata që duan të kthehen po ashtu të kenë edhe arsye përveç se dëshirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Përkundër treguesve ekonomikë që ndryshojnë prej rajonit për të mirë, nga rritja e GDP-së krahasuar me vendet e rajonit është në nivel jo të kënaqshëm ekonomik, nivel shumë të mirë për Kosovën. Po ashtu edhe përkundër krijimit të vendeve të reja të punës për vitin 2018, megjithatë

kjo është e pamjaftueshme për ta ndalë këtë trend të migrimit në Kosovë. Edhe unë i dëgjoja kolegët e mi, m'u dukën disa së paku prej tyre një lloj retorike.

Po mundohem të jem pak më konkret se çka duhet të bëjmë ne si shoqëri. E para, politikën tonë buxhetore në raport me këtë fenomen të keq, ose ndaljes së këtij trendi të migrimit duhet ndryshuar. Pra, buxheti jonë duhet të jetë i krijuar së paku për vitin 2020, komplet konform përkrahjes së të rinjve dhe perspektivës së të rinjve në Kosovë.

E dyta, politika sociale po ashtu nuk është në nivelin e mjaftueshëm për ndaljen e këtij trendi. Politikat shëndetësore duhet të ndryshohen rrënjësisht e sidomos me sigurimin shëndetësor. Po e them edhe një element që ka të bëjë me rregullin. Dikush i thotë sundim i ligjit, po kjo terminologjia e sundimit të ligjit është bastarduar disi dhe është tepruar duke thënë sundimi i ligjit, sundimi i ligjit. Unë po them duhet vendosur një rregull, një rregull në funksionimin e mekanizmave tonë shtetërorë.

Pra, këto janë ato elementet kryesore të shoqërisë sonë, që është në duart tona, në duart e këtij Kuvendit për të ndërmarrë hapa konkretë. Po e përsëris edhe një herë, jorastësisht. E para, politika jonë buxhetore konform këtij ndaljes së këtij trendi ose këtij fenomeni. E dyta, politikat tona sociale në raport me ndaljen e këtij trendi. Edhe politikat shëndetësore që janë me rëndësi, si dhe mekanizmat, vendosja e një rregulli, po them një rregulli, që së paku e tutje të ketë një rregull. Kjo vendos edhe e thënë nga dikush edhe shpresëdhënien.

Zoti Visar Ymeri m'i mori disa elemente, edhe që u ndal me disa çështje që janë me rëndësi. Unë shpresoj që do t'i kemi parasysh, në qoftë se duam të kemi një rezolutë ose një rekomandim për mekanizmat tonë shtetërorë. Në fakt, këto janë ata hapa të cilët duhet vendosur.

Ne mund të flasim këtu, edhe retorika është një çështje që jo që e ndal, retorika nuk e ndal këtë trend të keq, por përkundrazi i jap portat e migrimit. Ne duhet ta ndalim këtu retorikën, duhet të bëjmë një analizë më të thellë, po unë e thash propozimin.

Edhe një herë, politikat, që qoftë se është kjo prioritet numër një, atëherë buxheti duhet të trajtohet, ky fenomen duhet të trajtohet me buxhet numër një. Në qoftë se politikat shëndetësore nuk i kemi në rregull, atëherë duhet vendosur konform këtij fenomeni. Politikat sociale edhe një lloj rregulli. Një lloj rregulli, mos të ndalemi se çka është bërë, po çka do të bëjmë sot e tutje.

Unë e ftoj edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës ta ketë parasysh këto elemente. Disi jemi mësuar të krijojmë një lloj, sa i përket për shembull buxhetit, ta krijojmë njëfarë standardi të UNMIK-ut. Qeveria jonë duhet ta ketë parasysh prioritetin në buxhet rreth përkrahjes së elementeve të punësimit edhe të rinjve. Unë e di se i kanë bërë disa elemente, disa punë mjaft të mira, po kjo nuk është e mjaftueshme.

Po ashtu është me rëndësi kur të vendosim dikë në krye të një institucioni. E përmendi dikush një prokuror. Prokurori e ka dhënë betimin që ai duhet ta kryejë punën e vet. Në qoftë se e vendosësh një prokuror, i cili e lëshon vendin e vet aq lehtë, atëherë në start është gabimi. Nuk guxojmë bartësit e institucioneve ta lëshojnë vendin aq lehtë, sepse atëherë po i ndihmon dikush e ka nxitur për ta rritur këtë trend.

Unë po dyshoj që rrjete të tilla janë përkrah politikave të tilla.

Element tjetër, dikush e përmendi ka qenë edhe më herët në media edhe Rusia, ose Serbia. Normalisht që ata janë të përzier në këtë çështje. Po nuk është e thënë çka bëjnë ata, po çka do të bëjmë ne. Ta ndalim retorikën dhe të bëjmë diçka konkrete. Ne do të jemi të hapur si Aleancë, pa marrë parasysh që Kryeministri është i partisë sonë, që t'i ndihmojmë kësaj çështjeje dhe ta vendosim prioritet numër një, edhe prioritet kohor, jo veç prioritet për nga rëndësia, po edhe prioritet kohor. Do të jemi shumë bashkëpunues në qoftë se vërtet kemi vendosur të bëjmë diçka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Seanca e jashtëzakonshme, e cila për mendimin tim edhe pse unë e kam nënshkruar, nuk ka pasur nevojë të mbahet fare, sepse shkaktarët kryesorë të kësaj ikje masive, të njerëzve tanë që tani po ikin nga dhuna psikologjike e shpirtërore e materiale që politika e këtij vendi ia ka sjellë që prej mbarimit të luftës e këndej.

Ikja masive e shqiptarëve në vitet e '90-ta ka qenë ikje nga terrori fizik i Milosheviqit, ndërsa ikja pas luftës, është ikje për shkak të politikave shumë të rënda, edhe politikave tepër të gabueshme, sidomos në aspektin e keqpërdorimit të parasë publike. Nuk ka krim më i madh, kob më i madh që mund t'i ndodhë një populli sesa keqpërdorimi i parasë publike.

Neve për shembull si deputetë të Republikës së Kosovës, jo të gjithë, por një pjesë bajagi e mirë nga ne jemi po ashtu në grupin e atyre keqpërdoruesve të parasë publike. Unë e admiroj kolegën time Shqipe Pantina që ka dhënë dorëheqje nga Komisioni Parlamentar në të cilin unë jam, pikërisht për shkak të udhëtimeve lidhje pa lidhje që i ka bërë komisioni ynë dhe për shkak se ne si komisione e si deputetë ju dërgojmë letra institucioneve shtetërore të huaja, edhe u bëjmë ftesë e lutje të na thërrasin në vizitë. D.m.th. nuk është që neve na thirr dikush në vizitë, po ne i lusim të na thërrasin në vizitë. E njëjta gjë ndodh me 95 për qind të zëvendësministrave të Republikës së Kosovës. kështu ka qenë edhe në të kaluarën, kështu është edhe sot, kështu ka për të qenë edhe nesër. Do të thotë vizita pa lidhje, vizita që edhe Kryetari i Parlamentit kur shkon, qoftë në Hungari, qoftë në Japoni, 70 për qind të delegacionit i merr krejt pa lidhje, bën be që po udhëton

me para të babës, e jo me para të taksapaguesve. Ne zgjedhim hotele të shtrenjta, bileta të shtrenjta të luksit, pa menduar që ato janë paratë e taksapaguesve të Kosovës.

Ne është dashur të mbajmë seancë të jashtëzakonshme p.sh. për keqpërdorimet e parave në ndërmarrjet publike. Po që të jem shumë konkret para qytetarëve të Republikës së Kosovës, edhe të tregoj arsyet pse po ikin njerëzit prej këtij vendi, ose arsyen pse unë edhe gruaja ime kemi mundur të bisedojmë për të ikur edhe ne prej këtij vendi, ku unë jam deputet, gruaja e ka një rrogë bajagi të mirë, i kemi dy vajza, por kushtet në të cilat ne jetojmë nuk janë normale. Sepse vajza ime shkon në një çerdhe të shtetit ku janë 23 fëmijë në një dhomë, ndërkohë që 10 deputetë të Kuvendit të Kosovës vetëm për bileta për gjashtë muaj i shpenzojnë 260 mijë euro. Ndërkohë kur miliona euro shpenzohen për makina të zyrtarëve qeveritarë. Ndërkohë kur një kryeministër i Holandës ose i Suedisë shkon në punë me biçikletë, ne i kemi këshilltarët e ministrave e të zëvendësministrave që vijnë me shoferë e vijnë me makina zyrtare në vendet e tyre të punës. Domethënë një zëvendësministër i Republikës së Kosovës e ka një zyre 10 metra, ndërkohë që një deputet i Republikës së Kosovës që është organi më i lartë legjislativ i këtij shteti nuk ka zyre. Nuk ka ku t'i presë qytetarët e Kosovës.

Më lejoni të nderuar qytetarë që t'ua japë disa shifra, pse njerëzit e kanë humbur shpresën në këtë vend. Sepse 1 873 zyrtarë të lartë publikë të këtij vendi, ushtrojnë më shumë sesa një funksion publik.

Gjyshja ime nuk e merr vesh këtë fjali po ia përkthej. Domethënë 1873 hajdutë të këtij vendi i marrin kah dy rroga me paratë e popullit. Jo të punojnë edhe në Kuvend edhe në një institucion privat, po punon edhe në Kuvend, sikurse unë ta marr edhe rrogën e deputetit edhe ta marr edhe një rrogë në Radiotelevizion të Kosovës ose në postë ose diku tjetër. Kjo ishte e para.

E dyta, 1451 funksionarë të këtij shteti i ushtrojnë dy funksione. 367 funksionarë i ushtrojnë tri funksione. 37 funksionarë të këtij vendi i ushtrojnë katër funksione. 13 funksionarë i ushtrojnë pesë funksione, pesë rroga. 2 funksionare, gjashtë rroga. 2 funksionarë të tjerë shtatë rroga, shtatë funksione. Dhe, njëri është kampion, i merr tetë rroga nga paratë e taksapaguesve të "Republikës së Burdushit".

Dhe tash vazhdojnë. Ne si deputetë si do t'i ikim përgjegjësisë, kur ne deputetët kemi votuar që të krijohen 65 agjenci. 65 agjenci ia hanë palcën kurrizore këtij vendi. Këtij populli. Paratë e taksapaguesve.

Agjenci lidhje - pa lidhje. Ministri lidhje - pa lidhje. Do të thotë ne si deputetë nuk kemi qenë në gjendje që ta zvogëlojmë numrin e agjencive.

Miliona euro shpenzime janë bërë për bisedimet në Bruksel, miliona dhe këto bisedime nuk kanë arritur që të përfshihen as qoftë në tri fjali të vetme. Të thuhet që, ne prej vitit 2011, 2012 e deri më sot kemi shkuar në Bruksel dhe ja shikoni, lexoni tre rreshta se çfarë rezultati kanë pasur bisedimet tona në Bruksel.

Unë e kam thënë njëherë këtu me shifra, shyqyr që Xhavit Haliti nuk është këtu se do të ma ndërpriste fjalën, e ai ma ndali fjalën se tha çka ka lidhje që kanë shpenzuar.

Plotë këtu mendojnë që ne kur shkojmë atje jashtë, unë s'po them të flemë në Bahnhof dhe as në sfungjerë, por jo të flemë në hotel 500-600 që kushton hoteli. Ku të duash sot nëpër botë mund ta paguash hotelin më të mirë në Bruksel, e në Paris e në Uashington me 150 dollarë.

Tani, shfrytëzimi i buxhetit për ndërtimin e rrugëve pa asnjë kriter. Cilët kryetarë të komunave kanë sjellë këtu projekte për ndërtimin e çerdheve? Për ndërtimin e azilit të pleqve. Po, hajde o burra zgjohuni edhe të ndërtojmë asfalt. Zoti e ka dënuar Kosovën me diçka, që s'ka lënë kurrfarë mundësie të shpohet ndonjë tunel, se më së shumti në tunele vidhet.

Kuku çfarë do të kishin bërë duke ndërtuar tunele. Krejt vrima-vrima do ta shihje Kosovën.

Tani, le të dal kush të dojë në foltore e le të ma arsyetojë pse është ndërtuar ura më e gjatë që e lidhë Kaçanikun me kufirin e Maqedonisë, pse? Veç që të vidhet në atë urë. Kurrfarë nevojë nuk ka pasur. Ka mundur që e gathë autostrada të bartet në anën tjetër dhe fare të mos ndërtohet ura. Po, e kanë bërë urën aty, sepse aty vidhet më kollaj.

Miliona euro të nderuar qytetarë të Kosovës vidhen gjoja në emër të trajnimeve. Të shkohet për t'u trajnuar në Maqedoni. Në Greqi. Në Shqipëri. Pse? Vetëm të marrin mëditje. E pse ne të mos bëjmë trajnime në vendet tona, në Brezovicë ose në Grykën e Rugovës ose në Prishtinë e tua lëmë paratë njerëzve tanë. Por jo, shkojmë atje e rrimë e lexojmë, po ne fakt nuk lexojmë asgjë dhe në fund i marrim ato mëditje edhe i fusim në xhep. Sepse fukaraja nuk ka as burri dhe as dinjitet dhe as moral, po as fytyrë e as karakter.

Një popull që ka shkuar që të marrë hua kripë e sheqer e miell, e ta ka matur gjyshja e komshinjtë me 'tëhollues' nuk mund të bëjë shtet. Nuk mund të bëjmë shtet ne, se ne jemi njerëz fukarenj. Edhe sado që vjedhim prapë nuk po ngopemi.

Prandaj, mbi bazën e kësaj, unë në fund po them diçka, që seancë të jashtëzakonshme duhet të thërrasim për Ferronikelin. Ne seancë të jashtëzakonshme duhet të thërrasim për keqpërdorimet e parasë publike. Për privatizim. Ndryshe, seanca e sotshme, me gjithë respektin e madh të kolegut tim deputet që është djalë i ri edhe i dhemb në zemër ika masive, unë mendoj që ne së pari duhet t'i ndalim keqpërdorimet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, t'i ndalim udhëtimet lidhje-pa

lidhje. Edhe udhëtimet e zyrtarëve dhe pastaj t'i themi këtij vendi e këtyre njerëzve mos ikni prej vendit tonë. Faleminderit kryesues që nuk ma ndërpreve fjalën.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Ilir Deda.

ILIR DEDA: Faleminderit! Nganjëherë po më duket që Milaimi është më opozitë se të gjithë ne të tjerët.

Mua po më fascinon pamundësia e kolegëve të mi që të dalin prej demagogjisë të cilën po e përdorim këtu, sepse demagogjia është rezultat i mungesës së njohurive të bollshme.

Ika në ditët e sotme është fenomen i rrezikshëm dhe i dhembshëm. Është e vërtetë që ne jetojmë me një kohë globale të lëvizjes së madhe të njerëzve. Ne shkojmë në Kroaci, kroatët shkojnë në Gjermani, gjermanët shkojnë në Amerikë dhe Kanada.

Njerëzit thonë se nuk po e lëshojnë Kosovën për shkak të trendit global. Njerëzit tanë po e lëshojnë Kosovën për shkak se shteti i Kosovës është pa substancë, dhe nuk është i ndërtuar për mirëqenie të qytetarëve. Tash po korret ajo që është mbjellë që 20 vjet.

Dua tua tregoj një rast personal. Para një muaji shkova ta marrë pasaportën e re, edhe në një grumbull të njerëzve të rinj, ishte edhe dikush i lindur në vitin 1999, tha seftë ka ardhur që ta marr pasaportën. E pyet; ku po shkon, në Gjermani apo në Kroaci? Tha, unë punoj mirëqenien e kemi të mirë në familje po nuk dua të jetoj në Kosovë.

Tash, brezi i lirisë ai i brez i lirisë i cili çdo pranverë është pjesë e vokabularit e shumicë së njerëzve në politikë, ai brez i lirisë për të cilin kjo Kosovë është dashur të bëhej sot, është duke iku nga Kosova sepse nuk ka kualitet të jetës të cilin ata e kërkojnë edhe natyrisht shkojnë në Perëndim.

Po për dallim prej valëve të tjera të popullit tonë që kanë shkuar në Perëndim, këta njerëz po shkojnë që të mos kthehen më. Unë nuk po e shoh është me të vërtetë brengë e atyre të cilët e udhëheqin shtetin e Kosovës që po zbrazet Kosova për shkak të kualitetit të keq të jetës.

Tash, çka u ofron Kosova të rinjve? Meritokracinë nuk ua afron. Po a e dini se çfarë u ofron Kosova? U ofron rrjet klientelist partiak i cili është e vetmja mundësi për punësim të njerëzve të rinj. Domethënë bëhu ti rob i një partie politike nëse do që të kesh vend pune. Por, kështu nuk ecet përpara.

Ajo që ne nuk jemi shndërruar në vend të mundësive për shkak të shtetit të zaptuar dhe vazhdimësisë në zaptim të shtetit. Mos ta harrojmë këtë klimën e përgjithshme të zhgënjimit

kolektiv e cila është në substancë e dëmshme për sistemin politik të Kosovës. Pse? Sepse kur qytetarët e Kosovës tërhiqen prej jetës politike, hapet rruga për autokraci.

Nuk mundet sistemi demokratik e përgjegjësia institucionale të funksionojë pa qytetarë. Pra, duhet të ketë angazhim konstant të tyre.

Tash, sot këtu në këtë temë shumë të rëndësishme, neve po na mungojnë ministrinë përgjegjëse në këtë debat në Kuvend. Edhe dua që t'i numëroj se cilat në këtë Qeveri prej 20 e kusur ministrive janë ministrinë përgjegjëse për punësimin e të rinjve.

Për shembull, po mungon; ministri për Diasporë e Investime Strategjike, ministri i Financave, ministri i Inovacionit e Ndërmarrësisë, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, ministri i Zhvillimit Ekonomik, ministrja e Bujqësisë, ministri i Zhvillimit Rajonal dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Dhjetë ministra do duhej të ishin sot këtu nëse duan me të vërtetë ta bëjnë një politikë zhvillimore për Kosovën dhe që të rinjtë të mos ikin nga këtu. Por, kjo nuk po ndodhë.

Ne duhet të jemi një vend ku edhe kuadrin ligjor duhet t'ia përshtatim zhvillimit. Për shembull, pse është Kosova ndër vendet e pakta në këtë rajon ku nuk ka garë mes komunave se cila komunë po sjellë më së shumti investitorë të huaj.

Nuk është zhvillimi i Kosovës vetëm te investitorët e huaj, por investitorët kredibil të huaj janë sinjal që perspektiva e zhvillimit dhe investimit në Kosovë është e tillë që garanton që edhe të tjerët të vijnë dhe të hapin vende të tjera të punës.

Dhe në fund, pse nuk është rregulluar sektori privat? Nuk mund të jetë zhvillim i qëndrueshëm ekonomik punësimi në kompani publike dhe mbushja e sektorit publik me militantë politik.

Zhvillimi i qëndrueshëm politik është kur e kemi një sektor të shëndoshë privat i cili e respekton së pari Ligjin e Punës, të cilin Qeveria mund ta stimulojë. Jo të vijnë sot kolegët e ndryshëm e të thonë, ne deputetët kështu ne deputetët ashtu, kur për shembull 100 mijë vende të punës të cilat ky shtet i humb me një investim kot se koti prej 1.4 miliardë euro në një autostradë e cila është ekonomikisht e panevojshme për Republikën e Kosovës. Normal që do të ikin 100 mijë veta. Ngase ti po i gjuan në asfalt e dihet pse gjuhen në asfalt.

Në fund, sikur ta kishim vërtetë brengë përcjelljen e zyrtarëve publikë, besoni se nuk do t'i kishim 22 ministri dhe 88 zëvendësministra të cilët shkojnë në udhëtime zyrtare pa asnjë rezultat të cilat kushtojnë 12 milionë euro nëse flasim me shifra.

Po, në fund t'i kthehemi asfaltit. Republika e Kosovës që 11 vjet shpenzon para në asfalt panevojshëm. E tash nëse me të vërtetë duam që ta ndalim këtë, në këtë rezolutën e përbashkët, hajde po e prishim këtë autostradën e re, sepse është e panevojshme.

Hajde po i krijojmë bashkë parakushtet e kjo nuk do të ndodhë, po ja po i testojmë deputetët e mazhorancës, qysh 1,4 miliard euro mund të hyjnë në zhvillim të hapjes së më shumë se 100 mijë vendeve të punës të qëndrueshme në Kosovë.

Mos ta harrojmë në fund, Kosova është e vogël po bazën e zhvillimit të vet do ta ketë në shërbimet cilat do t'i ofrojë. Ne kemi storie të jashtëzakonshme të suksesit, po këto storie të jashtëzakonshme të suksesit nuk kultivohen, nuk promovohen sepse ne jemi duke u shndërruar në një shoqëri të kriminalizuar, ku plaçkitja e bankave është bërë pjesë e përditshmërisë. Padrejtësia e madhe nuk i bën më përshtypje askujt.

E t'ju tregoj diçka kolegë të nderuar, nëse vazhdon zhgënjimi kolektiv i qytetarëve të Kosovës në shtetin e Kosovës, atëherë pyetja e ardhshme do të jetë, për çfarë e kemi krijuar ne shtetin? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e deputetit Haxhi Avdyli. Regjia, Haxhi Avdyli e ka fjalën ju lutem.

HAXHI AVDYLI: Faleminderit i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Plaga e mërgimit është një plagë e vjetër e popullit tonë e cila gjatë historisë ka pasur shumë shkaktarë të ndryshëm që nga shtypja që nga mos krijimi i perspektives nga pushtues të ndryshëm. Por, tani kjo e fundit e ka një rëndësi më të veçantë sepse po ndodh 20 vjet pas çlirimit kur ne qeverisim vet me këtë vend.

Tani ne kemi ikje dhe ikja për shkaqe ekonomike ka vazhduar gjithmonë, po kjo ikje e të rinjve të cilën po e shohim tani për shkak të dëshpërimit dhe humbjes së shpresës, kjo është pak më e rëndë.

Po ikin edhe të punësuarit. Po ikin edhe ata të cilët e kanë një gjendje ekonomike deri diku të mirë.

Në këtë moment neve duhet të na brengosë çdo gjë edhe e përgëzoj iniciuesin e këtij debati, Fidanin i cili e ka ngritur këtë çështje, sepse ne dimë që kjo nuk zgjidhet ndoshta me një seancë, por së paku tregon që ky është problemi kryesor i shoqërisë sonë kosovare që ne duhet ta diskutojmë patjetër.

Më brengos fakti se disa po relativizohet, veçanërisht nga deputetët e partive në pushtet, por kjo nuk bën të relativizohet sepse po shihet hapur se po del në pah që punësimi i militantëve, i familjarëve që po ndodh për qëllime elektorale, pra këto punësime po bëhen për rritje të votave. Ndërkaq ika e të rinjve të pakënaqur po relativizohet, sepse në njëfarë mënyre në ndërrijen e tyre sikur po kënaqen që po ikin votuesit e pakënaqur dhe po zbutet ajo balona e pakënaqësisë dhe në të njëjtën kohë këta të rinj duke u larguar nga Kosova po i rrisim remitencat apo dërgimi e parave në shtëpi.

Rritja e këtyre remitencave po e rrit apo po e stabilizon gjendjen ekonomike dhe stabilitetin makrofiskal duke krijuar vende të lira të punës në sektorin publik.

Ky qark po vazhdon duke punësuar militantë dhe në këtë mënyrë qëllimi i vetëm po del te marrja e pushtetit, apo ruajtja e pushtetit.

Nëse duam që t'i kemi disa propozime për zgjidhje, unë mendoj që një prej propozimeve është që të largohet nga pushteti kjo klasë politike e cila për 20 vite nuk po arrin të krijojë zhvillim ekonomik dhe punësim, por vetëm punësim të partive apo militantëve të partive dhe familjarëve të tyre.

Krijimi i kushteve për thithjen e investimeve veçanërisht nga diaspora, ku do të garantohej nga shteti ky investim e jo vetëm kërkim i haraçit.

Krijimi i politikave lehtësuese ekonomike për sektorin privat e jo vetëm të shikohet sektori privat për të vjelë taksa dhe penalizime. Krijimi apo rritja e investimeve në arsim në dije dhe edukim. Përmirësimi i politikave arsimore sipas nevojave të tregut e jo vetëm investim në asfalt e luks.

Të bëhet një lloj moratoriumi për punësim në organet e Qeverisë, punësimet e panevojshme, pastaj edhe moratorium edhe në administratë. Dhe punësim apo rritje të punësimit sipas nevojave të tregut dhe sipas meritave.

Ne e kemi tani rastin më të freskët, ku në webfaqen e Kryeministrit e kemi një lloj zyre të koordinatorit për kulturë që askush nuk e kupton se pse duhet të krijohet zyra e kulturës dhe pse duhet të ekzistojë kjo zyrë e kulturës kur ekziston Ministria e Kulturës dhe në këtë zyre të koordinatorit krijohen 92 vende të punës, kinse ekspertë arsimor për krijimin e do korrikulave apo shikim, leximin e teksteve shkollore dhe gjetjen e gabimeve.

Unë çuditëm sesi po gjejnë mënyra dhe zbrazëtira për punësim edhe atë kryesisht të militantëve partiakë.

Sa e lexova para pak çasteve që kryeministri paska deklaruar që është mirë dhe shyqyr që ka vende të punës edhe në Gjermani dhe për ata që s'kanë punë, shyqyr që mund të gjejnë vende pune edhe në Gjermani.

Kryeministri duhet ta dijë që ai është kryeministër i Kosovës dhe është paguar për të krijuar vende pune dhe perspektive ekonomike për Kosovën, ngase për të gjetur vende pune në Gjermani nuk do ketë nevojë për të qëndruar kryeministër ngase është kancelarja Merkel.

1 miliard euro po investohen në asfalt. Siç e thanë edhe kolegët tjerë paraprak, me këto 1 miliard euro kishim mundur të investonim në krijimin e vendeve të reja të punës veçanërisht në ndërmarrësi dhe ndërmarrje të vogla për të rinj, por edhe për çdo kosovar të interesuar.

Janë me miliarda euro të bllokuara në bankat ndërkombëtare dhe ato vendore të cilat nuk janë futur në zhvillim ekonomik dhe fatkeqësisht kjo akoma ne po vazhdojmë që të mendojmë që zhvillimi ekonomik fillon dhe mbaron nga asfalti dhe tenderi i asfaltit.

Pra, derisa ta kemi një Qeveri e cila e ka këtë mendësi, unë besoj që do të ketë një ndryshim të mirë edhe të kësaj gjendjeje në të cilën sot për sot gjendet Kosova. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, sipas radhës Daut. Deputeti Hajdar Beqa e ka fjalën. Dy minuta, replikë. Deputeti Daut Haradinaj, replikë dy minuta, ju lutem!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit ish-ministër i Kulturës!

Do të duhej që ti t'i replikoje deputetit në fjalë, sepse para 18 muajsh ke qenë ministër i Kulturës.

Sa i përket buxhetit të këtij viti dhe të viti të kaluar, të gjithë ne që jemi deputetë këtu e dimë që devijimi ose ndryshimi i atij buxheti në infrastrukturën rrugore është vetëm 0,3%, asnjë cent më shumë. Pra, duhet të bëhet vetëkritikë dhe autokritikë.

Sa i përket një autostrade që dikujt po i zë rrugën, bëhet fjalë për 625 mijë banorë. Bëhet fjalë për Istogun, Pejën, Gjakovën, Deçanin, Junikun, Rahovecin dhe nëse ju nuk i konsideroni këto territore si të Kosovës, atëherë ta dëgjojmë me zë.

Mos veproni kështu se nuk jeni korrektë. Jemi shumë dakord që ka krizë ekonomike. Nuk është e shkaktuar sot, por mos e harroni edhe një fakt, se sa shqiptarët e duan e vendin. Sot e nderojmë Agim Ramadanin. Ai e ka lënë vendin e vet, luksin e vet në Zvicër dhe ka ardhur dhe ka rënë dëshmor për këtë vend.

Në çdo kohë dhe në çdo rrethanë do të ketë njerëz mjaftueshëm. A duhet të bëhet më shumë për rininë tonë? Po, duhet të bëhet më shumë.

Por, jo gjithmonë domethënë edhe pandershëm se në fund të ditës sot është një qeveri nesër nuk është, vjen tjetra e kështu me radhë. Por, ne e dimë shumë mirë Sylë nuk është shkaktar i krizës ekonomike një qeveri e sotme dhe as një e djeshme. Po thoni jo kaq buxhet kaq buxhet. Nuk pajtohem që duhet...Kur flisnim më herët për zyrtarët e shtetit të cilët punojmë.

Të jemi më të sinqertë se në fund ditës janë zyrtarë të shtetit, deputetë. Nuk mundemi ne ta akuzojmë vetveten.

Po më vjen keq tash për Milaimin se kam shumë respekt e çmoj, por të kemi pak kujdes kur i fyejmë, sepse ndoshta...

KRYESUESI: Haxhi Avdyli, një minutë për replikë.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues!

Unë e di që replika bëhet vetëm kur përmendet emri. Unë e përmenda emrin kryeministrit Haradinaj. Besoj që kryeministër është Ramush Haradinaj dhe jo Dauti.

Përndryshe, mendoj që investimi në asfalt është i domosdoshëm dhe duhet çdo kund të shkojë asfalti, por duhet të shikohet se a ka pasur nevojë që çdo kund rreth e rreth Kosovës t'i bëjmë të gjitha ato autostrada milionëshe, kur dihet se do të mund të bënim investime më të vogla dhe t'i investonim të atyre parave në krijimin e vendeve të punës.

Pastaj në subvencionimin e ndërmarrjeve të vogla. Investimi në teknologji informative. Investime në bujqësi e shumë gjëra të tjera dhe të mos flasim për gjendjen në shëndetësi e cila është në gjendej alarmante.

Pra, me ato miliona do të mund ta ndihmonin krijimin e fondit për sigurime shëndetësore e cila do të ishte një zgjidhje e mirë për sektorin e shëndetësisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Milaim Zeka, dy minuta. Daut, e ke përfunduar.

MILAIM ZEKA: Daut Haradinaj e vazhdoi më herët, kështu deshi të më kritikojë mua dhe mua më pëlqejnë njerëzit, të cilët më kritikojnë.

Po kjo sëmundja e urës atje te Kaçaniku, ajo është 'Made in PDK-LDK', asfaltet janë sëmundje e këtyre dy partive politike, nevojë nuk kemi bash asfalt, sa i përket autostradës që e përmendi deputeti Haradinaj, autostrada mund të bëhet edhe me fonde ndërkombëtare, nuk ka kurrfarë problemi.

Unë fola veç për urën, ura ka qenë komplet, zoti Haradinaj, e panevojshme.

KRYESUESI: Daut, një minutë!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Faleminderit, kryesues!

Unë, thënë të drejtën, nuk jam ekspert i infrastrukturës dhe nuk e di a duhet a s'duhet, qe, për shembull, e kemi Milaimin që është i të gjitha fushave. Liburn Aliu nuk qenka këtu, se desha t'i them ai të na flasë pak.

Po, edhe një herë, doktor, nuk e pata të të kritikoj, sinqerisht, as nuk jam duke fyer, ne e dimë që është gjendja alarmante, po e thashë fakti që ne sa e duam Kosovën, e dimë të gjithë, por problemi i Kroacisë, problemi i Sllovenisë, problemi i Maqedonisë, problemi i Shqipërisë, domethënë të gjitha kanë dyndje, lëvizje, sepse njerëzit kanë të drejtë të kërkojnë një jetë më të mirë.

Ne jemi përgjegjës sot për sot qysh është situata, njëjtë sikur që do të jenë përgjegjës pasardhësit tanë, qoftë në Parlament, qoftë në Ekzekutiv. Lehtë është prej opozitës, për shembull, unë e mbaj në mend ish-ministrin Shala sa kritikën ia kam bërë këtu, po nuk ishte bash krejt njësoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mua s'më lejohet të replikoj nga këtu, kështu s'do të shkel Rregulloren, ndryshe unë do të kisha dy-tri përgjigje për zotin Haradinaj. Po sa për procedurë, zoti Abdyli, replika jepet jo vetëm në rastet kur një deputet i drejtohet tjetrit nominalisht, por kur edhe i referohet përmbajtjes së fjalës së tij ose kontekstit.

Vazhdojmë, Hajdar, ju kërkoj falje!

HAJDAR BEQA: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Realisht sa i përket debatit parlamentar që po e bëjmë sot lidhur me zbrazjen e vendit nga të rinjtë, edhe unë si deputet kam nënshkruar një kërkesë të tillë, edhe pse konsideroj që nuk ka qenë ky debat të bëhet seancë të jashtëzakonshëm, por konsideroj se një debat i tillë duhet të bëhet në të gjitha institucionet, edhe në nivelin lokal, edhe në nivelin qendror dhe të punojmë konkretisht në ndryshimin e gjendjes në vend, po jo vetëm të vajtojmë, sepse nuk konsideroj që Kuvendi është këtu për të vajtuar, apo kur je në pushtet të thuash një qëndrim tjetër dhe pas tre muajve kur je në opozitë të thuash diçka tjetër.

Edhe kur ka pasur Milaimi kryetarin që ka tash të partisë, zotin Limaj, ministër të Transportit, këto parti që janë në koalicion, edhe të tjerët, ndoshta kanë akuzuar pse kaq shumë asfalt. Edhe

kur e ka pasur LDK-ja ministrin, ka qenë e njëjta akuzë, po edhe kur e ka tash AAK-ja, është e njëjta akuzë, po të gjithë ne që jemi në terren dhe jemi në kontakt me qytetarët, është kërkesë mediate e qytetarëve që ajo përveç se ndikon në jetën e atyre dhe 700 mijë qytetarëve, ndikon në zhvillim ekonomik, sepse e lidh Kosovën edhe me Shqipërinë, e lidh Kosovën e bën më të afërt edhe me Shkupin, edhe me rajonin. Mendoj që ajo nuk do të ndikojë vetëm për atë trevë, po do të ndikojë për gjithë vendin.

Unë mendoj që ky debat i sotëm duhet të ndikojë në kthimin e shpresës, qytetarët ta kuptojnë që nuk jemi duke bërë debat vetëm për cikël elektoral, po se jemi të shqetësuar me ikjen e njerëzve tanë, familjarëve tanë nga vendi ynë.

Trendi i migracionit ka historikun e vet, mund të vlerësohet në periudha të ndryshme. Nuk do të hyj në histori, për arsye që ne i dimë arsyet pse kanë ikur njerëzit tanë para luftës, apo në kohë të ndryshme, por normalisht që në liri ikin për një jetë më të mirë, po ndoshta ka të rinj që ikin nga humbja e shpresës.

Ne kemi analiza nga institucione të ndryshme të trendit të ikjes. Nëse marrim vitin 2014, ka pasur një ikje më të madhe se në vitin 2019, nëse i shohim ato analiza, një ndër faktorët pse ka qenë një ikje e madhe, ndoshta ka qenë edhe vonesa e institucioneve, krijimit të institucioneve pas zgjedhjeve të vitit 2014, kanë qenë edhe bllokadat e asaj kohe kur partitë që i kanë humbur zgjedhjet e kanë shpallur fitoren, po nuk do të ndalemi të gjejmë fajtorin, sepse qytetarëve tanë u intereson çka ne si institucione po bëjmë konkretisht.

Shkalla e popullsisë që dëshiron të shpërngulet nga Kosova ka qenë në rritje sidomos nga viti 2014, ka një ulje në vitin 2019, nëse i marrim këto sondazhe, nëse i referohemi monitorimit Gallup international në vitin 2017 rreth 34% e qytetarëve tanë me dëshirë do të ikin nga vendi. Nuk është mirë debati për këtë temë të bëhet në nivel të akuzave ditore politike apo për cikël elektoral.

Trajtimi i këtij fenomeni do të jetë sfidë për gjithë spektrin politik, për të gjitha institucionet, si në nivelin lokal, ashtu në nivelin qendror, po ne duhet t'i bindim qytetarët se këtë debat nuk e kemi vetëm për kalkulime elektorale ditore, por e kemi me të vërtetë si pasojë e shqetësimeve që i kemi apo secili ndoshta kemi shumë njerëz me të cilët kemi kontakte për çdo ditë me ta dhe pas një ose dy ditësh largohen nga vendi.

Të rinjtë që janë motor i lëvizjes së shoqërisë, zhvillimit ekonomik dhe politik, ndryshimet pozitive në vend vijnë nga rinia, kanë ardhur në të kaluarën, po vijnë edhe tash, sepse rinia është e tashmja dhe e ardhmja e vendit tonë.

Rinia po ikën për një jetë më të mirë, u tha edhe nga shumë kolegë, po të njëjtën kohë pajtohem që po ik edhe në mungesë të perspektivës në vendin e tyre.

Shqetësim duhet të jetë jo vetëm të rinjtë e papunësuar që po ikin nga vendi, sepse ata ndoshta janë edhe të zhgënjyer, ndoshta kanë shumë vlera dhe nuk u është dhënë mundësi nga institucionet që të japin kontributin e tyre, po ne duhet të kuptojmë që në sistemin çfarë ne sot jetojmë në Republikën tonë duhet ta forcojmë edhe sektorin privat, duhet ta respektojmë Ligjin e punës në tërësi edhe të risim pagën minimale që nuk mundet shteti të ofrojë punësim për të gjithë, por t'u japë mundësi vlerave dhe janë profesionistë, pavarësisht bindjeve të tyre politike, konsideroj që u duhen institucioneve në të gjitha nivelet.

Ne kemi obligim si vend në shtetin tonë mundësia e punësimit të jetë e barabartë për të gjithë, pavarësisht përcaktimit politik. Thashë edhe më herët, vlera të fitojë në raport me antivlerën.

Mungesa e krijimit të hapësirës për realizimin e ideve të të rinjve për një jetë më të mirë dhe më dinjitoze, do të thotë është njëri prej faktorëve që po ndikon në ikjen e rinisë.

Unë them e kemi vërejtur në shumicën e rasteve, ka shumë shtete, sidomos Gjermania që po ofron viza pune edhe për punëtorë të spektrit të ndryshëm, po edhe për mjekë apo për profesione të ndryshme, ata ndoshta, edhe pse janë në punë, edhe burri, edhe gruaja, po shkojnë për një jetë më të mirë.

Po ne hallin e kemi te këta, të cilët nuk po e gjejnë një jetë elementare dhe mendoj që duhet t'u krijojmë kushte përmes infrastrukturës ligjore dhe krijimit të hapësirës së barabartë.

Ne i kemi vërejtur konkurset për vende pune që po ndodhin jashtë vendit. Ne kemi pasur rastin, e kam parë personalisht në Prizren, ku një organizatë ndërkombëtare ka hapur një konkurs, ka pasur mijëra qytetarë nga Republika e Kosovës që kanë shkuar për të konkurruar.

Prizrenin e udhëheq Lëvizja Vetëvendosje dhe është befasi se kur i dëgjon disa deputetë të Lëvizjes Vetëvendosjes mendon që jem duke folur për ndonjë shtet tjetër, kur atyre u bie ndonjë rast të merren me pushtetin, veprojnë ndoshta shumë më vrazhdë se sa kanë vepruar individët, po marr për shembull të keq, edhe nëse e marrin Komunën e Prishtinës kur është udhëhequr nga Vetëvendosja, por edhe nëse e marrim sot Prizrenin kemi informata të përditshme që edhe trendi i ikjes atje është ndoshta më i madh se sa në qytete të tjera.

Ikja e trurit do të na kushtojë në të tashmen dhe në të ardhmen. Ne duhet t'i analizojmë faktorët që po ndikojnë në rritjen e migrimit. Unë mendoj se ne duhet ta forcojmë sektorin privat në tërësi dhe në të njëjtën kohë ta luftojmë ekonominë informale, me të vetmin qëllim që të rritet zhvillimi

ekonomik, të rritim pagën minimale, të kemi një strategji kombëtare për të joshur investitorët, me theks të veçantë investitorët nga diaspora, ne e dimë rolin e diasporës në të kaluarën.

Diaspora çdo herë ka qenë fuqi për ndryshime, ka qenë fuqi edhe për lirinë që e kemi ne sot dhe jam shumë optimist në bazë të kontakteve që kemi me njerëzit tanë atje, ata janë fuqi ekonomike nëse ne u krijojmë hapësirë dhe i garantojmë me ligje, të cilat konsideroj i kemi të mirë që ata kapitalin e tyre ta investojnë në vendin e tyre.

Të vazhdojmë të punojmë në forcimin e sundimit të ligjit. Ne kemi bërë shumë ligje në Kuvend, sidomos në vitin e fundit që ndikojnë direkt në garantimin e një, në këtë rast të sundimit të ligjit, por mendoj që duhet të bëjmë edhe më tepër që të kemi gjykata më efikase që të mos presin qindra lëndë, po të zgjidhen më shpejt, sidomos lëndët që kanë të bëjnë me biznesin.

Ndoshta njëri prej faktorëve ka qenë që i vetmi shtet në rajon kemi mbetur të izoluar, edhe pse konsideroj që i kemi plotësuar kriteret në raport me ato që na i ka dhënë BE-ja, por lëvizja e lirë ka ndikuar që edhe më shumë do të thotë të ikin qytetarët.

Unë mendoj që duhet ta nxjerrim një rezolutë të mundshme, të respektueshme, të harmonizuar nga të gjitha forcat politike që të ndikojmë direkt në kthimin e shpresës së qytetarëve, e në veçanti të rinjve, e jo të humbim shpresën e tyre për kalkulimet tona ditore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Arbër Rexhaj, replikë. Pastaj Miliam Zeka, prit Milaim, Arbër, dy minuta.

ARBËR REXHAJ: Hajdar Beqa përnjëmend ka të drejtë kur flet për Lëvizjen Vetëvendosje, pra flet për një perspektivë tjetër, për një plan tjetër, siç e etabloi.

Përnjëmend kur flet për Vetëvendosjen duhet paraprakisht të pastrohej, e pastaj të flasë, e para.

E dyta, ikjet që po ndodhin në Republikën e Kosovës kanë të bëjnë me të gjitha komunat e Kosovës dhe këtu varen shumë faktorë, të cilat i përmenda më parë dhe sigurisht për këto faktori kryesor është edhe kjo Qeveri, por edhe qeveritë të cilat kanë qenë edhe më parë.

E përmendi një rast të një kompanie private dhe e përzien Komunën e Prizrenit, nuk e di çka ka lidhje ajo kompani private me Komunën e Prizrenit. Po sigurisht këtë e bënë për arsye që dëshiron tash ta përqendrojë vëmendjen edhe krejt këtë ikje masive të cilën po e bënë PAN-i dhe qeveritë e kaluara, dëshiron megjithatë nga pak ta njollosë, ta spërkatë me faj edhe Lëvizjen Vetëvendosje.

Prandaj, veç po dua t'ia përkujtoj, edhe pse nuk desha, po meqenëse kërkoi vetë. Sa të akuzuar, pra nën hetime sa drejtorë të dënuar dhe madje deri në fund të mandatit të tyre e kanë pasur ish-kryetarin e tyre. Prandaj, kur flet për Lëvizjen Vetëvendosje Hajdar Beqa duhet ta dijë që përnjëmend po flet për një planet tjetër, sepse në konceptimet e tij, se si është mësuar ai ta shohë PDK-në, për të vërtetë Lëvizja Vetëvendosje është planet tjetër.

KRYESUESI: Deputeti Milaim Zeka, dy minuta replikë!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

E para, deputeti në fjalë, s'po i përmend emrin të mos mund të replikojë me mua, foli për ikjen e trurit.

Është mirë t'i bëhet trurit nganjëherë 'refresh', Hajdar, se a e ke parë, kompjuteri bllokohet të mos i bëhet 'refresh'. E bëja 'refresh' pak trurit e mendo që Fatmir Limaj ka qenë ministër i partisë tënde, ka qenë ministër i PDK-së dhe i ka zbatuar urdhrat e shefave tu. Fatmir Lima është kryetar i Nismës dhe jam krenar që bashkë me Nismën, edhe me PAN-in, kam ardhur këtu. I kam 980 vota, Hajdar, në Gjakovë, kam vota edhe në Gllogjan, në çdo territor të Kosovës kam vota. Unë jam në radhë të parë deputet i PAN-it, deputet i Republikës së Kosovës që përfaqësoj edhe interesat e qytetarëve e të votuesve edhe të partive opozitare.

Prandaj, nuk është mirë këtu, unë flas shumë konkretisht, edhe dardhat shtroni në asfalt, në qoftë se juve ju duket mirë të shtrua veç asfalt, vazhdoni, po nuk fola me tendencë negative dhe nuk është mirë ta fyesh Fatmir Limën se e ke jaran, e ke pasur në parti edhe kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hajdar Beqa, dy minuta, për të dy kundër-replikat.

HAJDAR BEQA: Faleminderit!

T'i drejtona më shkurt Milaimit, i kisha thënë është mirë të koncentrohej se unë thashë ka qenë ministër yni realisht dhe nuk ka zbatuar urdhra, po ka qenë njëri prej shefave të partisë, sepse ka qenë nënkryetar i partisë, e kam respektuar edhe në atë kohë, edhe në këtë kohë dhe mendoj që ka bërë një punë të mirë, po unë thashë që kërkesa për infrastrukturë rrugore edhe më tutje po vazhdon, sepse qytetarët po kërkojnë një gjë të tillë.

Ndoshta nuk e ka kuptuar çka kam thënë unë Milaimi, po në të njëjtën frymë besoj që kemi biseduar.

Sa i përket Arbrit, unë thashë kështu dhe qëndroj prapë asaj që thashë. Ju Vetëvendosja që vajtoni çdo herë që po të ishit ju bëni mrekulli, ju kemi parë presionet që ia keni bërë kryetarit të kaluar në Prishtinë, ju kemi parë pazaret që i keni bërë pa kryetarin, ndoshta edhe me kryetarin në Prishtinë, ju kemi parë punësimet që i keni bërë, të paligjshme, diku rreth 400 në Prishtinë dhe

si pasojë apo rezultat i atyre, ju ka ikur kryetari me 12 deputetë dhe nuk di qysh flisni për ta menaxhuar shtetin, kur nuk mund ta menaxhoni një parti, po nuk dua të flasë për ju se po flisni vetë për veten.

Sa i përket Prizrenit, kemi informata shumë konkrete gati përditë, kryetari i Prizrenit që është nga Lëvizja Vetëvendosje lyp dorëheqje nga presioni që ia bëni ju dhe nga pazaret që i bëni ju në Prishtinë për Prizrenin pa hanxhiun, sepse mendoni që tash Prizreni është i Vetëvendosjes, po Prizreni është i qytetarëve, Prizreni është i Republikës së Kosovës, është i Kosovës.

Edhe nuk kisha pasur dëshirë të merrem me ty, Arbër, se merren qytetarët, kur shkojmë në zgjedhje, e shohim ku jemi secili. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë punën sipas radhës. Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Zoti nënkryetar, Hajdari është shumë qesharak për ta marrë seriozisht, prandaj nuk do të merrem me të.

Qysh në fillim të fjalës time, së pari jam goxha e shqetësuar lidhur me deklaratat e deputetëve, sidomos nga koalicioni, por jo vetëm, që thonë që i kanë rënë pishman që e kanë nënshkruar këtë seancë të jashtëzakonshme. Do të ishte mirë t'i bini pishman për do vendime të tjera që i keni marrë dhe këtë po e them për shkak se pa dyshim që kjo seancë e jashtëzakonshme është shumë e rëndësishme, sepse Kosova sërish po përballlet me një largim në heshtje të qytetarëve të Republikës së Kosovës, sepse ka një humbje të madhe të shpresës dhe kjo shihet, ka një dëshpërim të madh dhe kjo duket.

Nga ajo pak çka kemi parë në media, por sigurisht edhe në takime të shumta që kemi pasur me qytetarë, sidomos me të rinj e të rejtat, dëshpërimi i madh që kanë me pushtetin thjesht e bënë të vështirë jetesën në Kosovë.

E kam thënë edhe në paraqitje e tjera publike, por po e them edhe këtu në Kuvend që sot, 20 vjet pas luftës, është sfidë e madhe të jesh qytetare dhe qytetar i Republikës së Kosovës, sepse askush nuk e ka besuar 20 vjet pas luftës që ne do të përballemi me një gjendje të tillë.

Kryeministri Haradinaj, në fakt, do të duhej të ishte këtu, të paktën për dy arsye, për të na treguar se si e adreson këtë eksod, e dimë që s'ka vizion, as vullnet, por të paktën do të duhej të ishte këtu, para së gjithash dhe mbi të gjitha të distancohej nga deklaratat skandaloze të këshilltarit të tij Halil Matoshi, i cili thotë po mundohem ta parafrazoj: "Zërat që adresojnë ikjen e të rinjve nga Kosova janë të paguar nga Rusia", pra kështu deklaroi këshilltari politik i kryeministrit të vendit, Halil Matoshi.

Dhe të bëjë një deklaratë të tillë ose duhesh të jesh i verbuar nga pushteti dhe nga luksi, në mënyrë që të mos mund të shohësh përtej vetes, ose unë nuk di si s'po shohin këta njerëz. Dhe, po ashtu kryeministri do të duhej të ishte këtu dhe të na tregonte se si mund të qëndrojë ende kryeministër teksa sheh kolonat e gjata të të rinjve, të rejave, vajzave e grave, para ambasadave. Dhe, e keni parë edhe sot në media, s'ka asnjë plan, s'ka asnjë strategji, po pagën vetes 3 mijë euro ia ka bërë, e për çka ia ka bërë vetes pagën 3 mijë euro? Për të thënë që s'kam plan se si ta zhvilloj vendin, ky kryeministër duhet të shkojë në shtëpi. Dhe, që pesë orë ka filluar kjo seancë, ai nuk e ka marrë mundin as edhe një minutë të jetë në këtë seancë, duke shpërfillur kështu deputetët e Kuvendit, por në fakt, duke e shpërfillur edhe problemin e madh me të cilin po ballafaqohet Kosova.

Dhe, po është e vërtetë, nuk është përgjegjësia vetëm te kjo qeveri, pajtohem plotësisht me këtë konstatim, sepse asnjë prej qeverive nuk e ka pasur në plan mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës, pra kanë pasur orientim të gabuar socio-ekonomik. Ta zëmë, privatizimin neoliberal që e kanë bërë secila qeveri, sidomos pas shpalljes së pavarësisë, e ka sjellë vendin në një situatë të tillë. Pra, modelin e njëjtë e kemi parë që nga 2007, 2008, 2009 e deri në 2019. Pra, këtë gjendje mos u mundoni ta përgjithësoni, sepse kjo gjendje ka autorë, ka emra të përveçëm, ka emra e mbiemra, prandaj përgjegjësit duhet të japin përgjegjësi, sepse ne refuzojmë ta trajtojmë këtë çështje sikurse të gjithë paskemi faj. Jo, nuk është kështu. Nëse sot dikush po e mbytko një person, një njeri, a tash të gjithë jemi fajtorë, jo. Është fajtor ai që e ka bërë aktin kriminal, prandaj po, këtu ka emra dhe mbiemra dhe ka emra, siç thashë të përveçëm.

Diskutimin tim dua ta zhvendos në një këndvështrim që unë besoj, të paktën, që është i rëndësishëm dhe po mundohem vetëm t'i përmend apo t'i rendis problemet, me të cilat ballafaqohet shumica e familjeve sot. Për shembull, nuk po flas për të papunët, sepse dihet si është gjendja e tyre, po mundohem të flas me ata të cilët të paktën e kanë një pagë mesatare. Ta zëmë, paga mesatare në Kosovë për një qift, njëri e ka 500 tjetri e ka 500, çifti i ri, nëse kursejnë rreth 3 mijë euro në vit dhe për të kursyer nuk duhet të bësh as pushime dhe as aktivitete të tjera, do t'i duhen 20 vjet për ta blerë një banesë, për të cilën foli edhe kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti.

Tash, të kursesh në Kosovë, ne po e dimë që është tepër vështirë, pra i bie që të futesh në kredi. Për shembull, për të bërë një krahasim me zyrtarët e lartë, në këto 10 vjet kemi parë një shpërputhje të pasurive të zyrtarëve të lartë në të ardhurat që i kanë. Pra, pasuri këto që nuk i kanë pasur para postit publik, por pas. Pra, përditë qytetarët shohin se si njerëzit në këtë mes, në këtë kuptim, e kam fjalën për zyrtarët e lartë, që i kanë pasur fqinj, pra ata e familjet e tyre, nga një jetë normale, kanë kapërcyer në një jetë luksoze. Besoni, as veshjet, as fotografitë nëpër vendet luksoze nuk mund të justifikohen me pagat publike, lëre më pasuria e paluajtshme dhe e luajtshme kudo që kanë. Dhe, kur ne i kritikojmë këta, paturpësisht po na thonë “e po, ne s'jemi komunistë”, thuajse pluralizmi i lejon vjedhjen e parasë publike për llogari private.

Kudo në demokracitë e konsoliduara zyrtari i lartë politik dallohet për jetë të vetëpërbajtur dhe, me pak raste përjashtimesh, të cilëve do të mund t'u burojnë pasuria nga trashëgimia. Tash, qytetarët nuk mundën ta kapërdijnë këtë situatë, prandaj edhe largohen nga vendi, sepse kjo Qeveri, sikurse edhe qeveritë e tjera, s'kanë lënë vend për të tjerët, pos për vete dhe për të vetët. Më tutje në Kosovë nuk ka asnjë program nga asnjë qeveri se si adresohet kjo, çdo çift i ri që ka fatin të jetë në punë përballet, ta zëmë, me mungesën e çerdhes publike, përjashto këtu Prishtinën, ku ka më shumë çerdhe publike me kosto të përballueshme, kudo tjetër është e pamundur.

Ta zëmë, vetëm për një grip që i bie fëmijës, të mos flasim këtu për shpenzime të tjera që dalin nga sëmundje të tjera, prindërit shpenzojnë deri 100 euro për fëmijën në barna dhe në analiza, s'po flas për kontrole, për shkak se ato do të mund të bëheshin edhe në shtëpitë e shëndetit. Në anën tjetër, s'ka sigurim shëndetësor, nuk ekziston sigurimi shëndetësor, në fakt, është, por nuk zbatohet dhe në rast të ndonjë sëmundje të fëmijëve apo njërit prej prindërve, familja me këto të ardhura thjesht gjendet para kolapsit financiar. Vetëm një shpenzim shtesë i paplanifikuar në muaj po të hyri ndërmjet, natyrisht që kjo është e papërballueshme dhe e fut një familje në borxhe të reja, përveç tashmë kredive që i kanë.

Tash, tjetra nëse një familje do të ketë një kontest gjyqësor civil për pronën, për shembull, do t'i duhej të presë mesatarisht 4 deri në 5 vjet që të nisnin procedurat dhe shpenzimet për ta bërë këtë. I kalojnë shumëfishin dhe natyrisht që kjo është e papërballueshme për familjet që kanë gjendje mesatare. Siç edhe dihet, shumica e familjeve në Kosovë vetëm për arsye të shpenzimeve nuk kanë asnjë mundësi ta ndajnë pronën me dokumente të anëtarët e tjerë të familjes dhe, po ashtu, çmimi i energjisë elektrike, faturat janë të papërballueshme, por edhe mungesa e energjisë elektrike. Për shembull, në fshatrat e Ferizajt: Zllatar, Dardani, Mirosalë, Bibaj, Fshat i Vjetër që 42 orë janë pa rrymë, e tash pastaj e sjell edhe mungesën e ujit. Qysh të jetosh në Kosovë kur s'ke as rrymë, as ujë, qysh të jetosh?

Natyrisht që ik, sepse ky shtet nuk ka treguar seriozitet për mirëqenien e qytetarëve dhe, po sot mund të bëjmë rezoluta sa të duam, por pika e vetme që na duhet si deputetë të Kuvendit është kërkesa për dorëheqje të kësaj Qeverie, ose rrëzimi i Qeverisë Haradinaj, sepse këta njerëz kanë dëshmuar se nuk e duan as barazinë, as mirëqenien, as zhvillimin dhe as drejtësinë. Prandaj, Qeveria Haradinaj duhet të shkojë në shtëpi, çdo ditë e saj në pushtet, është një ditë më pak shpresë për qytetarët dhe për Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hajdar Beqa, replikë, dy minuta!

HAJDAR BEQA: Faleminderit! Zonja Haxhiu i ka ato deklaratat e veta, nganjëherë ia shkruajnë në parti, nganjëherë i thotë edhe vetë, ndoshta sot i ka thënë vetë. Unë e them këtë shumë seriozisht, pas eksodit të ikjeve të qytetarëve tonë që kanë qenë ato skenat, besoj nëse e kthejmë

në retrospektivë, i sheh edhe Albulena, por i shohin edhe qytetarët e vendit tonë, flas për vitet 2014-2015, sipas shumë analizave dhe mediave, por në të njëjtën kohë edhe deklarimeve që i keni bërë ju dhe vizitave që i bënit në atë kohë të Stacion të Autobusëve, do të thotë ka dalë që ka qëndruar Vetëvendosja.

Ndoshta po ju duhet një kauzë e tillë prapë, por nuk është mirë kauzat në emër të rritjes së partisë suaj t' i dëmtoni qytetarët, se edhe pse e dinë, ju e dini që kauzat kurrë s' i keni pasur seriozisht, as s' i keni pasur serioze, por ndoshta një pjesë e qytetarëve kanë menduar që i keni serioze. E di që ju janë harxhuar, Albulenë, kauzat, se jua kanë marrë edhe koalicioni që i kemi fituar zgjedhjet, por ua kanë marrë edhe të tjerët dhe jeni duke lobuar apo jeni duke analizuar të gjeni një kauzë të re, por qysh po e shoh, do t'ju duhet kohë për ta gjetur një kauzë.

Andaj, nuk kisha replikuar më shumë me ty, veç kisha thënë që dallimi mes neve dhe juve është kështu: ne të paktën kur kanë probleme qytetarët dhe kur kanë sfida, ballafaqohemi me ta, shkojmë, bashkëpunojmë me ta, e ju i vajtoni këtu prej mediave, prej konferencave për media, prej vendeve të ndryshme, por nuk merreni direkt me problemet që kanë qytetarët. Atë e keni parë edhe vetë, edhe ato vota që i keni marrë shpejt e shpejt në 2017-ën, për tre muaj ditë u janë zvogëluar 100 mijë vota, po të ishin bërë edhe një palë zgjedhje pas tre muajve, do të kishit problem me prag. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Vërtet s'po e kuptoj këtë urgjencë të thirrjes të kësaj seance, sepse kjo ka mundur të jetë në një seancë të rregullt, sepse s'ka asgjë të jashtëzakonshme për të qenë seancë e jashtëzakonshme dhe kemi mundur që sot t' i votojmë dhe të futemi në pikat e rendit të ditës të seancës, e cila ka qenë e thirrur për sot, në mënyrë që të trajtohet dhe deputetët të përgatiten saktë me shifra dhe me të dhëna se çfarë në fakt po ndodh në Kosovë. Por, po më duket që opozita ka ngelur pa kauzë, qysh e tha edhe Hajdari dhe tash po mundohen që me thirrjen e këtyre seancave të jashtëzakonshme, që nuk kanë asgjë të jashtëzakonshme, të mundohen të bëjnë diçka dhe po i referohem edhe Lëvizjes Vetëvendosje, se vërtet kanë ngelur pa kauzë, sepse Qeveria Haradinaj dhe zoti Haradinaj po punon dhe po e kryen edhe punën e Qeverisë, por edhe punën e opozitës, kështu që ju veç vazhdoni të thirrni seanca të jashtëzakonshme.

Nëse veç i analizojmë të dhënat dhe për të argumentuar atë se çka ka të jashtëzakonshme këtu, i kemi shifrat e tre vjetëve të fundit që tregojnë saktë. 2015 – 67 mijë e 545 persona që janë regjistruar që kanë kërkuar qëndrim në vendet e ndryshme të Evropës. Ndërsa, viti 2018 – 3 mijë e 515, dikush që di matematikën, e sheh që 100%, 200%, 300% ka rënë kjo shifër e personave, të cilët po largohen nga Kosova dhe kjo po e demanton atë se për çka është dashur të thirret kjo

seancë e jashtëzakonshme. Motivet që po thonë, jo asfaltet, jo punësimet, jo shëndetësia, jo sigurimet shëndetësore, vërtet ka deputetë që jemi edhe mandatet e kaluara dhe të gjithë kemi punuar që ta kemi ligjin e sigurimeve shëndetësore dhe e kemi pas mbytur ministrin Imet Rrahmani duke i thënë “kur po fillon implementimi”, se ju e dini që zakonisht kur amendamentohen dhe kur votohen ligjet në Parlamentin e Kosovës, është afati kohor gjashtëmujor që të hyjë ligji në fuqi. Dhe, meqenëse s’ka hyrë ai i ligj i sigurimeve shëndetësore në fuqi, ne të vetmin presion që kemi mundur ta bëjmë, në mënyrë që edhe Kosova dhe qytetarët e Kosovës ta gëzojnë të drejtën e sigurimeve shëndetësore, ju kemi drejtuar në forma të ndryshme ministrit dhe ndoshta edhe pak e kemi rënduar për shkak se s’ka ndodhur kjo dhe edhe sot po vazhdon situatë e njëjtë. Ju e dini se Qeveria ka ndarë para më shumë se sa viteve të tjera për shëndetësi, në mënyrë që qytetarët të kenë një mirëqenie shëndetësore, por prapë do të mbesim me shpresë se së shpejti do të kemi edhe datën kur do të ketë ose do të implementohen sigurimet shëndetësore.

Së paku, shteti i Kosovës ka rritje ekonomike dhe kjo është një rritje e verifikueshme që është 4.2% dhe këto shifra që po i them nuk janë shifra që po i themi ne si deputetë ndoshta të opozitës, por janë shifra që na i kanë thënë edhe në takimet që i kemi pasur, qoftë në Strasburg, Bruksel me ndërkombëtarët, sepse ju e dini që një kusht për liberalizim të vizave ka qenë që të bjerë migrimi dhe tash, edhe zyrtarët evropianë po thonë që Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizim të vizave dhe është e drejtë e tyre për të lëvizur lirshëm. Po i shoh disa reportazhe që po bëhen prej disa televizioneve para ambasadave të ndryshme dhe duhet thënë se të gjithë ata që po kërkojnë viza nuk janë njerëz që po dëshirojnë të ikin dhe të mos kthehen, sepse ka njerëz që shkojnë për vizita familjare, që shkojnë për vizita turistike, këtu t’i cekim edhe vizat e punës, por personat që kanë aplikuar edhe për avancim profesional dhe nuk janë të gjithë ata persona që po dëshirojnë të ikin dhe të mos kthehen më në Kosovë.

Edhe ne e bashkëndejmë atë se të gjithëve na pengon ajo që njerëzit po e braktisin Kosovën, qoftë për arsye ekonomike apo arsye të tjera dhe ne duhet të ofrojmë kushte që qytetarët të qëndrojnë në Kosovë dhe duhet të jetë edhe angazhim i qeverisë në këtë drejtim, por së paku kryeministri Haradinaj nuk po thotë që qytetarët po ikin, po kanë iphone me vete, po ikin ndoshta prej zorit, ndoshta për vende pune, por megjithatë janë disa kushte pak më të mira se po ikin ndoshta se po sigurojnë një vend pune dhe në momentin që shkojnë në vendet perëndimore, e kanë një punë të sigurt, e kanë një vend ku të qëndrojnë dhe dashtë Zoti që ata në momentin e duhur të kthehen dhe të bashkëveprojnë në Kosovë, sikurse edhe plot të tjerë që po kthehen, sepse e kemi edhe një shifër, se në vitin 2018, 727 persona janë kthyer prej Perëndimit, të cilët tash po jetojnë dhe po punojnë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Imet Rrahmani, replikë, dy minuta. Regjia deputetit Imet Rrahmani fjalën!

IMET RRAHMANI: Faleminderit!

Kërkoj falje për këtë shqetësim, unë koleges Kadrijaj i falënderohem që më përmendi emrin dhe më dha mundësinë që të jap një përgjigje për këtë çka ngriti kjo.

Unë së paku kam qenë ministër aq i përgjegjshëm që pothuajse 99% të pyetjeve parlamentare që na u kanë shtruar neve si pjesë e Qeverisë, kemi ardhur këtu para deputetëve dhe ju kemi përgjigjur dhe nuk e kemi konsideruar atë presion me qëllim, por ideja ka qenë që të bashkëpunojmë bashkë me Kuvendin dhe të zgjidhim problemet që rëndojnë jetën e qytetarëve. Një nga to ka qenë edhe Ligji për sigurimet shëndetësore, unë jap informatën se kemi pas punuar shumë në implementimin e këtij ligji edhe si ish-anëtare e Komisionit për Shëndetësi besoj që pajtohesh që bashkë me juve jemi pas dakorduar që me urgjencë, jashtë procedurave parlamentare ta bëjmë plotësimin dhe ndryshimin e ligjit, i cili do të hapte rrugë që dokumentet që i kemi pas punuar në Ministri të Shëndetësisë edhe aktet e tjera, t'i harmonizojmë dhe ta implementojmë ligjin. Ju e dini që ai ligj ka pas kaluar në Qeverinë Mustafa, është dashur të procedohej në Parlament dhe nuk ka ardhur me rënien e Qeverisë as në vitin 2018, as në vitin 2019, nuk është në plan legjislativ. Ky është veç një argument që këta ministra dhe kjo qeveri nuk janë të përgjegjshëm para Parlamentit, para qytetarëve dhe nuk e kanë ndërmend fare t'i adresojnë problemet, të cilat prekin direkt jetën e qytetarëve, një ndër to është edhe sigurimi shëndetësor.

Unë këtu, për të mos marrë kohë shumë, se edhe ashtu e kemi kohën e kufizuar, mund t'i listoj nja 10-15 veprime, të cilat i kemi bërë në Qeverinë Mustafa për të implementuar këtë ligj, e që sot fatkeqësisht janë kthyer në pikën zero.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, deputetja Time Kadrijaj, një minutë!

TIME KADRIJAJ: Po, faleminderit! Unë thashë, ka deputetë që ndoshta janë për herë të parë dhe e cekën se për shembull një prej arsyeve që qytetarët po largohen, po largohen për shkak se nuk ka sigurime shëndetësore dhe unë nëse e thashë që e kemi bërë presion, unë mendova ministrit i kemi bërë presion në kuptimin pozitiv, në mënyrë që të implementohet, se të gjithë kemi qenë të shqetësuar dhe të gjithë mendoj jemi të interesuar që të ketë sigurime shëndetësore. Atëherë, unë nuk e di pse deputetët po thonë, gjendja që është në shëndetësi, nuk është gjendje e këtij viti ose e vitit të kaluar, apo e dy vjetëve, por kjo gjendje e rëndë në shëndetësi është gjendje që është trashëguar prej pasluftës dhe ne e dimë shumë mirë se kush ka udhëhequr me Ministrinë e Shëndetësisë dhe cilët janë ministrat, të cilët e kanë udhëhequr sektorin e shëndetësisë.

Andaj, po më vjen keq që disa deputetë po kërkojnë të gjenden përgjegjës, po përgjegjësia e ka një emër dhe e ka... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Mendoj që tema për migrimin, largimin apo ikjen siç dëgjuam shumë terma këtu, është një temë që duhet të diskutohet e të debatohet me seriozitetin më të lartë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe nga deputetët dhe nga të gjitha grupet parlamentare dhe mendoj që është njëra ndër temat që më së paku duhet të kalkulohet për kalkulime elektorale apo politike. Jemi para një gjendjeje e cila në vazhdimësi e ka goditur qytetarin e Kosovës dhe veçmas shqiptarët, si në periudhën e paraluftës, si në periudhën pas luftës, edhe pse shkaqet dhe arsyet janë të ndryshme, nuk janë të njëjta. E thanë shumë kolegë deputetë këtu.

Është e vërtetë që do të thoja kështu shtëpi për shtëpi apo familje për familje po goditet nga kjo ndodhi që po i ndodh vendin tonë, e veçmas gjeneratës së re e cila po e lëndon, dhe unë mendoj që ky lëndim si pasojë nëse më lejohet ta them, do ta them kështu shumë popullorçe e sakaton të ardhmen tonë për brezat e ardhshëm dhe për substancën e familjes sonë dhe shoqërinë, në përgjithësi.

Po cilat janë shkaqet? Mendoj që ka shumë faktorë të cilët e determinojnë një situatë të tillë, duke filluar nga kjo përplasja jonë dhe nga mosbashkëpunimi i partive politike për të ofruar më të mirën për vendin dhe asnjë temë, mund të konstatojmë, ama asnjë temë nuk po na bën bashkë në rolin tonë për të ardhur në një përfundim i cili do të ishte në interesin e zhvillimit të vendit dhe të qytetarëve. Kjo është ndoshta baza e asaj e cila e ka thyer shpresën dhe siç u tha edhe më herët nga dikush e ka vrarë shpresën e qytetarëve të vendit. Është një temë që unë mendoj duhet ta shohim secili pozicionin tonë, qoftë si individë, qoftë si grupe politike, se së paku të ketë tema të cilat janë në interes tonin të përbashkët dhe të qytetarëve se së paku na ofrojnë në trajtimin e tyre tema në formë të përbashkët.

U përmendën edhe tema të tjera, për shembull, sistemi i drejtësisë. Shteti i së drejtës është duke munguar. Mendoj se ka hapësirë dhe duhet të luftohet shumë më shumë ekonomia joformale, të luftohet shumë më shumë monopolet që janë, të cilat po e mbytin zhvillimin dhe iniciativën e ndërmarrësisë private, e cila mendoj se duhet të ishte njëra nga bartësit kryesorë të punësimit dhe të zhvillimit, e cila do ta ruante njeriun e Kosovës në vendin e tij dhe do t'i ofronte mundësinë për të punuar dhe për ta zhvilluar vetveten.

Por, edhe sistemi i arsimit me të gjitha ato që kanë ndodhur që nga paslufta e deri tani e mban përgjegjësinë e vet dhe nuk është në funksion të ngritjes së kapaciteteve dhe mundësive për të shfrytëzuar edhe atë pak dije që e marrin njerëzit tanë në këto institucione, sepse edhe këto lënë

shumë për të dëshiruar që jemi në një mundësi për të krijuar një balancë ndërmjet asaj që e prodhojnë shkollat tona dhe asaj që mund të jetë kërkesë e tregut apo kërkesë e punës.

Mendoj që faktorët i kalojnë edhe mundësitë tona, edhe gjendjen e tonë të brendshme. Njëri prej faktorëve mund të jetë edhe izolimi që i është bërë Kosovës. edhe kjo është vetëm në vetëdijen e qytetarëve tanë dhe në gjendjen e të rinjve që të jetojë në një vend të izoluar është bukur e trishtueshme, kur të gjitha vendet përreth dhe rajoni lëviz lirshëm dhe e ka mundësinë për të lëvizur lirshëm dhe për t'i shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i ofron Evropa e bashkuar apo Bashkimi Evropian.

Këto janë tema të cilat ne duhet t'i trajtojmë me kujdes. Unë mendoj që ne duhet në fund të këtij debati të dalim të bashkuar dhe të nxjerrim një rezolutë, por jo vetëm të mbetet një rezolutë, e Qeveria të marrë detyrë dhe përgjegjësi, që sidomos në planifikimet e ardhshme buxhetore të adresojë buxhetimet e sakta, të cilat do të ngrisin kapacitete dhe do të ofrojnë mundësi punësimi real për të rinjtë duke ofruar në bazë të shkollimit dhe të kërkesës së tregut.

Nisma dhe ne do ta japim kontributin tonë në çdo iniciativë dhe në çdo planifikim i cili është real për ta zhvilluar të ardhmen dhe për të garantuar një punësim të të rinjve tanë dhe veçmas atyre që kanë përgatitje intelektuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

Serioziteti i institucioneve të Republikës së Kosovës për këtë seancë me këtë temë kaq të rëndësishme, pra mosprezenca as e Kryeministrit dhe e asnjë ministri këtu është vërtet shumë shqetësuese.

Unë mendoj se ne nuk kemi nevojë që ta politizojmë edhe këtë temë që është një plagë e popullit dhe kombit tonë. Dhe nuk kemi nevojë dhe nuk kemi mundësi të sidomos koalicioni qeverisës të fillojë të debatojë e të flasë se çka kanë bërë qeveritë e tjera përpara, por ne duhet ta shtrojmë këtë problem ashtu si është e të diskutojmë çka mund të bëjmë që vërtet ikja, ose largimi ose migrimi i shqiptarëve të Republikës së Kosovës është shqetësuese.

Njëkohësisht nuk mund të pajtohemi me disa kolegë të mi deputetë që flasin ose vajtojnë me lot të krokodilit e që përdorin metodën bëj çfarë të them unë, po mos bëj çka bëj unë. Unë po ju drejtohem atyre që i përgjithësojnë gjërat dhe po ju them se jo të gjithë deputetët kemi nga dy, tri e shtatë paga, jo të gjithë deputetët shkojnë në ekskursione me paratë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, jo të gjithë deputetët jemi të papërgjegjshëm dhe të paditur. Prandaj, kur dikush merr guximin të flasë për deputetë, duhet të flasë me emra, sepse pasi jam anëtare e këtij Kuvendi,

prandaj po e them, se ne nuk jemi një shportë me molla këtu, as nuk jemi një kope delesh, por jemi njerëz me emra e mbiemra dhe secili kemi përgjegjësinë e papërgjegjësishë po edhe të përgjegjësishë veç e veç. Prandaj, kërkoj të ketë diferencë, sepse është e vërtetë se kemi diferencë të madhe këtu mes vetes si kolegë deputetë.

Sa i përket temës të cilën e kemi ngritur grupi ynë parlamentar, unë kisha pasur për të shtuar se ikja, migrimi, shpërngulja, shkuarja e shqiptarëve është plagë e historisë tonë të gjatë e të mundimshme e të dhimbshme. Por, ikja, shpërngulja, migrimi apo shkuarja e shqiptarëve në historinë e re të Kosovës së pavarur është e dhimbshme, por dhe duhet ta turpërojë klasën politike në Kosovë. Së paku duhet t'ia bëjmë vetes që të gjithë politikanët dy pyetje: pse rinia jonë po ikën dhe si po ikën ajo? Papunësia u përmend, nepotizimi, pabarazia, drejtësia e munguar, shëndetësia e kolapsuar, arsimi ynë jashtë normave të normales së cilësisë, krimi i organizuar, korrupsioni e të tjera.

Pse ikin edhe ata të cilët janë të punësuar, por edhe ata ikin, pse? Sepse ka dëshpërim, nuk ka shpresë. Gjithmonë ka pasur lëvizje të popullatave në mbarë botën për një jetë më të mirë, ka edhe sot. Por, si dhe në çfarë kushtesh ikin qytetarët e globit dhe në çfarë kushtesh ikin qytetarët e Republikës së Kosovës? Kjo duhet të jetë shqetësuese për neve, përveç të tjerave.

Të rinjtë tanë për dallim prej të gjitha shtetet e Evropës dhe ato të regjionit nuk kanë liberalizim të vizave. Prandaj, për shkak të papërgjegjësishë së politikës në Kosovë, për shkak të byrokracisë dhe padrejtësisë së Bashkësisë Evropiane, për shkak të sekserëve e të kompanive të transportit, popullata jonë plaçkitet, i fyhet dinjiteti për të dalë në një shtet evropian. Kam informata që me mijëra viza siç janë sllovene e të tjera po shiten këto ditë nga 3 mijë euro dhe ata qytetarë mashtrohen për vend pune përmes kompanive shqiptare fiktive që janë në bashkëpunim me ndërmarrjet e transportit këtu, e ndoshta edhe prej politikës së caktuar. Ata qytetarë kur mbërrijnë në shtetin e caktuar, që plaçkiten nga tre mijë euro, që presin me orë të tëra para ambasadave të caktuara, kur mbërrijnë në atë shtet të caktuar bredhin rrugëve pa para, pa punë, pa dinjitet.

Migrimet e llojit të tillë janë krim i organizuar nga firmat pra shqiptare dhe me ta duhet të merret drejtësia, duhet të merren institucionet e Republikës së Kosovës dhe nuk duhet t'i mbyllim sytë dhe ta kthejmë këtë temë duke u përplasur pozitë e opozitë. Kjo duhet të jetë shqetësim i vërtetë. Askush s'ka të drejtë ta pengojë të lëvizë qytetari për një jetë, për një profesion, për një studim të caktuar. Por jo të bëhet organizim, ose krim i organizuar për të larguar qytetarët e Republikës së Kosovës jashtë.

Përmirësimi i gjendjes në vend, që njerëzit të mos e humbin shpresën, këtë duhet dhe jemi përgjegjës të gjithë, edhe duhet ta bëjmë, sepse Kosova duhet të bëhet. Nuk mund t'i ikim askush

përgjegjësisë dhe nuk duhet t'i ikim. Unë nuk dua tash të marrë kohën se çfarë duhet të bëhet për zhvillimin ekonomik se u fol mjaft asfalt e pa asfalt. Të gjitha duhet të bëhen, kolegë të nderuar.

Unë nëse flas në aspektin ekonomik, si ekonomiste, dikush ngul këmbë se për një zhvillim të mirëfilltë duhet të jetë infrastruktura rrugore. Dikush ngul këmbë se duhet një bujqësi më shumë të zhvillohet. Dikush te një fushë tjetër. Por që të gjitha në qoftë se do të ishin zhvilluar ose investuar me një kontroll dhe me një ndershmëri që vërtet ai buxhet të mos keqpërdoret, atëherë nuk ka fort rëndësi a është shtruar asfalt apo është bërë një fushë tjetër. Megjithatë ne duhet të jemi të përgjegjshëm që vërtet zhvillimi të jetë dhe ne të jemi shumë transparentë me shpenzimet e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Duhet ta kemi parasysh arsimin çfarë niveli e kemi. Nuk mund të ecim tutje, për ta kthyer një besim, një shpresë, një mirëqenie në vend, pa përmirësuar cilësinë e arsimit të cilën e kemi në vend. Nuk mundemi me këtë shëndetësi. Neve pacientët tanë na vdesin nëpër spitale, për shkak të pakujdesisë dhe për shkak të kimit të organizuar që është në spitalet tona. Po e theksoj kam pasur rastin këto ditë të jem vetë në spital. Pacientët tanë vdesin nëse nuk kanë para të hyjnë në operacione të caktuara. Ata fyhen dhe plaçkiten nga persona të cilët i paguan taksapaguesi dhe ne si deputetë ndajmë buxhetin për ta. Por në mesin e tyre ka edhe mjekë të ndershëm e të mirë i cili po ballafaqohet me mjekë të cilët nuk duhet të jenë aty.

Kemi problem me drejtësinë, që në mesin e tyre kemi njerëz të cilët vërtet duan të ndajnë drejtësi dhe kemi të tjerë të cilët janë në mesin e tyre që vërtet nuk duan dhe punojnë në të kundërtën. Siguria pra e kështu me radhë.

Kemi mundësi për të ndryshuar gjendjen dhe kemi obligim kolegë të nderuar deputetë dhe natyrisht uroj që ne në fund të kësaj seance të dalim me një zë, sepse kjo temë është shqetësim dhe duhet të jetë shqetësim real, e jo të ndahemi pozitë e opozitë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së nuk ka të paraqitur. Radhën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku. Nuk është këtu. Atëherë fjalën deputetes Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

U tha edhe më herët që shifrat e publikuara nga institucionet dhe organizatat kredibile në lidhje me emigrimin vërtet janë alarmante. Bazuar në të dhënat e EUROSTAT-it, shtetasit e Republikës së Kosovës, të gjitha trendët e tregojnë se kategoria e migrimit për qëllime të punësimit, ka shënuar një rritje të dukshme. Ndërkaq raporti i Fronteks-it e vë në theks ndryshimin e rrugëve të migrimit të parregullt për të hyrë në vendet e BE-së, duke dominuar rruga a Ballkanit

Perëndimor, në veçanti kufiri Serbi-Hungari, ku pasur një rritje të konsiderueshme të migrimit të parregullt. Pra, sot, 20 vjet pas luftës, qytetarët e këtij vendi marrin drejtimin drejt Serbisë për një jetë më të mirë në vendet e Evropës.

Po aq alarmante, madje edhe më shumë alarmante është gjendja e përgjithshme që ekziston në vend, mungesa e seriozitetit për trajtimin e situatës së krijuar dhe mbi të gjitha mungesa e përkushtimit për të ndryshuar gjendjen reale në vendin tonë. Mungesa e angazhimit dhe përkushtimit për ta përmirësuar cilësinë në arsim, për ta rritur zhvillimin ekonomik, për të ofruar mundësi të barabarta e për të mundësuar mirëqenie për secilin qytetar të këtij vendi, ashtu që energjia e të rinjve e të rejave tona mos të jetë e orientuar drejt ambasadave për të marrë vizat, apo edhe për të shikuar sesi ilegalisht të kalojnë kufirin, por të jetë e orientuar drejt arsimimit dhe zhvillimit të tyre personal, gjë që këtu nuk po ndodh.

Sipas të dhënave të publikuara nga vetë autoriteti qeveritar për migrim që u publikua në mars të këtij viti, më shumë se gjysma e qytetarëve kosovarë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, më konkretisht 62 për qind e tyre janë të moshës prej 18 deri në 34 vjeç, duke u përcjellë pasta nga grupmoshat 35 vjeç e më lart me 19 për qind dhe grupmosha nën 18 vjeç, po ashtu me 19 për qind. Prej tyre, 23 për qind janë gra e vajza. Pra, është e dukshme që të rinjtë dhe moshja e mesme si alternativë për një jetë më të mirë e shohin vetëm largimin nga vendi. Përkundër kësaj, Qeveria akoma nuk e sheh si prioritet zhvillimin ekonomik, edhe pse në mënyrë deklarative flasim për rritje ekonomike, por këtë nuk e kanë shprehur me veprime, konkretisht me buxhetim adekuat.

Buxhetimi dhe në përgjithësi projektet publike kanë kuptim kur i adresojmë projektet zhvillimore, të cilat si rezultat përfundimtar kanë pastaj zhvillimin ekonomik të shoqëruar me barazi sociale dhe ekonomike dhe si rrjedhojë e kësaj edhe krijimin e vendeve të reja të punës. Por prej shpalljes së pavarësisë, pra për një dekadë tashmë asnjë buxhet i qeverive të Kosovës nuk e ka pasur synim këtë çështje. Edhe projektbuxheti i viti 2019 nuk i dedikohet të papunëve të cilët janë në kërkim të një vendi të punës. Ky projektbuxhet nuk i dedikohet as studiuesve e profesionistëve, të cilët e kanë vullnetin dhe dëshirën për hulumtime dhe kërkim shkencor të cilat do të duhej të ishin shumë të nevojshme dhe shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit.

Pra, në këtë projektbuxhet nuk ka financim për projekte që nxisin punësimin dhe aftësimin e fuqisë punëtore dhe nuk ka as projekte që mbështesin shkencën e hulumtimit. Përkundrazi, në këtë projektbuxhet mund të gjenden renovimet e ndërtesave dhe blerjeve të pajisjeve, qoftë për Zyrën e Presidentit dhe të Kryeministrit në vlerë prej 750 mijë eurove. Për ndërtimin e ndërtesës së Zyrës së Presidentit në vlerë prej gjysmë milioni eurove. Paga e mëditje për zyrtarët e Presidentit dhe Kryeministrit në vlerën 5,9 milionë euro, si dhe 12 milionë euro të dedikuara për

mallra dhe shërbime, por jo buxhet për hulumtime shkencore, jo buxhet për t'i përkrahur iniciativat e të rinjve të këtij vendi.

Edhe këtë vit, po ashtu nuk kemi asnjë projekt kapital për Trepçën dhe asnjë projekt për kërkim shkencor.

Zhvillimi ekonomik e shtetëror, nevojat për hulumtim shkencor e kërkesat e të punësuarve dhe të papunëve nuk mund t'i adresojë me përbërje të përsëritur e të vjetër të buxhetit dhe të pushtetit. Pra, këto buxhete të orientuara në asfalt po vazhdojnë të pamundësojnë zhvillimin e vërtetë të vendit.

Buxheti i Kosovës për këtë vit ka në thelb dy të vërteta që Qeveria po mundohet t'i fshehë. E para, si rezultat i dështimit të realizimit të investimeve nga viti në vit, nga gjithsej 604 milionë euro të investimeve kapitale të nivelit qendror që janë paraparë, 496.8 milionë euro do të jenë në fakt investime në projekte të cilat kanë filluar në vitet e kaluara dhe që janë përsëritur vit pas viti pa arritur të përfundohen. Dhe e dyta, buxheti planifikon të shtojë edhe më shumë borxhin publik për gjeneratat e ardhshme. Dhe këto investime në borxhet publike nuk janë në këmbim të projekteve zhvillimore apo të luftimit të varfërisë, por janë projekte të cilat do të duhej të ishin realizuar ka kohë tashmë.

Aq e lartë ka qenë pangopësia e qeveritarëve sa edhe financimin e ndihmës sociale e kanë zvogëluar për 1,3 milion euro. Derisa nuk ka angazhim e punës në zvogëlimin e boshllëkut të shkathtësive të ekonomisë së tregut dhe tregun e punës për të rinj. Në bazë të rezultateve të anketës së analizës së boshllëkut të shkathtësive me fokus në sektorin e prodhimit, të tregtisë dhe shërbimeve, konfirmohet mospërputhja e madhe në mes të asaj që kërkohet nga bizneset dhe asaj se çfarë po ofrojnë institucionet tona arsimore. Lidhja ndërmjet institucioneve arsimore në të gjitha nivelet dhe sektorët privatë, është e dobët dhe shumë profile në ekonomi janë të tejfurnizuara, derisa në anën tjetër ka një mungesë të konsiderueshme në profile të tjera të cilat janë shumë të kërkuara në tregun e punës. Shumë responentë që kanë marrë pjesë në këtë anketë, e kanë shprehur nevojën për hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për edukim dhe punësim, si një mënyrë për planifikimin më të mirë të nevojave për fuqi punëtore.

Por nuk ka asnjë veprim konkret në këtë drejtim nga Ministria e Arsimit dhe nga ministrinë e tjera të linjës. Shkollat profesionale vazhdojnë të mbeten në disavantazh dhe kryesisht si zgjedhje e dytë për nxënësit të cilët nuk kanë arritur të pranohen në gjimnaze. Pavarësisht kësaj, duhet theksuar se vendet e reja të punës pritet që më së shumti të krijoheshin pikërisht për profilet që u përshtaten të diplomuarve nga shkollat profesionale.

Por, institucionet nuk po punojnë në ngritjen e vetëdijes së prindërve dhe nxënësve të nivelit të shkollës së mesme të ulët në mënyrë që t'i vetëdijësojnë ata për rëndësinë e ndjekjes së shkollave profesionale si një opsion që t'u mundësonte avancimin në karrierë.

Nëse i shohim rezultatet e një studimi për rininë të bërë nga FES, në pjesën në lidhje me emigrimin dhe punësimin është përmendur se mungesa e shpresës për ta gjetur një punë dhe për përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike, janë disa nga arsye që i shtyjnë rreth 47% të të rinjve shqiptarë të Kosovës që të kenë nga një qëllim i moderuar deri te qëllimi i fortë për të mërguar në të ardhmen e afërt.

Gjithashtu, pakënaqësia me arsimin, korrupsioni, besimi i ulët tek institucionet dhe çështje të tilla të ngjashme kanë pasur rritjen e ankesave dhe pakënaqësitë duke kontribuar drejt një kreacioni sipas rezultateve të këtij hulumtimi.

Ndërkaq, një numër i madh i të rinjve nga Kosova do të pranonin të kryenin në vende tjera një punë, për të cilën fare nuk do të merrej në konsideratë nga popullsia lokale. Pra, përveç kësaj motivimi për të migruar për arsye arsimore mbetet relativisht i ulët te të rinjtë tanë, duke krijuar kështu një prishje të ekuilibrit mes dëshirës për të migruar dhe punuar në vendin e destinacionit dhe etjes për një arsimin dhe zhvillim më të madh për veten e tyre.

Këto statistika janë vetëm disa nga treguesit e shumtë se Qeveria ka dështuar të përmbushë obligimet e saj institucionale për të krijuar kushte e mundësi për të rinjtë tanë për një edukim e arsimim të mirëfilltë, që nuk ofron një diplomë më tepër, por që ofron një konkurrencë të vërtetë e të mirëfilltë për tregun e punës, që ofron zhvillim ekonomik e përparim.

Qytetarët e Kosovës meritojnë më shumë e më mirë, por kjo Qeveri as nuk di dhe as nuk do të bëjë më mirë për Kosovë, sepse në radhë të parë e ka interesin e tyre të ngushtë. Andaj, kjo Qeveri vërtetë duhet të lëshojë rrugë për qeveri të cilat në vëmendje dhe në fokus i kanë qytetarët e Kosovës dhe ofrimin e mundësive për të rinjtë e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete. Tani fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, nënkryetar!

Së pari, mendoj se është pak e padrejtë që vazhdimisht të kritikojmë se sot nuk është kryeministri këtu përderisa jashtë procedurave Kryesia e Kuvendit ka vendosur që të thërrasë një seancë të jashtëzakonshme, pikërisht sot para seancës së rregullt për të cilën jemi përgatitur dhe kryesisht për shkak se kemi një numër të madh të bordeve të cilat kanë mbetur peng tani e një kohë të gjatë.

I kemi gjashtë seanca të papërfunduara me ligje goxha të rëndësishme. Kemi njerëz të cilët janë në procedura tani e sa kohë dhe këto procedura zvarriten për shkak të seancave të jashtëzakonshme.

Tani çka është e jashtëzakonshme në këtë debat që ne sot po e thërrasim dhe po e mbajmë, unë do të thosha, asgjë.

Është krejt e zakonshme që deputetët e opozitës e kritikojnë Qeverinë, sepse kjo është punë e tyre. Mirëpo, nuk është asgjë e zakonshme si veprim largimi i qytetarëve të vendit, sepse kjo po ndodh tani e mund të them edhe me dekada të tëra.

Mua më kujtohet në vitin 2014 e patëm thirr vet një seancë të jashtëzakonshme. Asokohe ne ishim në opozitë. Patën ikur brenda pak ditëve rreth 150 mijë qytetarë. Patën ikur në të zezën. Pati ndodhur tragjedia e Tisas edhe tragjeditë e tjera të cilat asokohe kërkonin ose të paktën ne si deputetë konsideronin që duhet ta kishim një seancë të jashtëzakonshme.

Në atë seancë të jashtëzakonshme e kemi pasur një dakordim dhe një rezolutë me 17 pika. Nuk është që ndonjëra nga ato pika është implementuar ose zbatuar. Të tjerët kanë qenë në pushtet atëherë. Ata të cilët sot po thërrasim seancë të jashtëzakonshme për një proces i cili kryesisht lidhet me viza pune.

Mesa kam kuptuar nga takimet e shumta me qytetarë, njerëzit për një vizë pune presim dy-tri vite. Pra, vala e këtyre vizave të cilat i kanë marrë tani në këtë fazë kur shtetet e fuqishme të Bashkimit Evropian kanë nevojë për fuqi punëtore, vjen dy vjet pasi të njëjtit kanë aplikuar për to. Pra, dy vjet më parë kur krejt tjetër kush ka qenë në pushtet.

Nuk e kam mendjen që të provojë që të shfajësojë as njërin dhe as tjetrin, por mendoj që kjo kërkon një trajtim shumë më të thellë se akuza dhe kundër-akuza në këtë Kuvend dhe në një seancë e cila po zgjat shtatë-tetë orë edhe nuk është që po prodhon diçka konkrete për ta përmirësuar gjendjen e qytetarëve në vend.

Pra, nuk është që ne si deputetë po ofrojmë zgjidhje konkrete sesi të ndalet largimi i të rinjve nga vendi.

Mendoj se një ndër temat që do të duhej të trajtohet këtu është edhe izolimi i padrejtë i qytetarëve tonë nga ana e Bashkimit Evropian, faktor ky i cili sigurisht që në kuptimin psikologjik ndikon tek të rinjtë dhe të rejtat të cilët në momentin e parë kur kanë një mundësi kërkojnë mënyra për ta gjetur një vizë, për të siguruar një vizë dhe për të dalë dhe për ta parë botën. Është e drejtë e tyre.

Ne e dimë që me shkop magjik nuk janë përmirësuar as neglizhencat dhe as dështimet nga e kaluara. Nuk dua ta fyej askënd. Nuk dua ta përsëris që kur ka ndodhur Tisa, dikush ka thënë se po ikin me Iphone. Megjithatë, po dua theksoj që për shembull rritja e pagave në sektorin publik.

Rritja e pensioneve, rritja e pagës bazë, e cila do të ndodhë në sektorin privat, ku pajtohem me disa deputetë që e trajtuan, është në gjendje goxha të rëndë, janë vetëm disa nga veprimet të cilat ndodhën së fundmi dhe të cilat janë shpresëdhënëse që angazhimi ynë i përbashkët Kuvend dhe Qeveri do të sjellë të mira për vendin.

Në fund të fundit ne s'kemi atdhe tjetër edhe atdheu ynë nuk ndahet në pozitë dhe opozitë. Prandaj, në disa çështje siç është kjo sot duhet të jemi bashkë dhe të ofrojmë alternativa dhe të gjejmë zgjidhje të përbashkëta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani ia jap fjalën deputetit Arben Gashi.

ARBEN GASHI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Tema që ne po e diskutojmë sot këtu, është një temë jashtëzakonisht e rëndësishme për të cilën ne duhet të gjejmë konsensus politik. Problemi është se të gjithë ne që folëm deri tani këtu sot, qasjen që e kemi parciale.

E kemi qasje parciale dhe qasje akuzuese për njëri-tjetrin kur e dimë të gjithë që gjithsecili individualisht apo si grup politik apo si shoqëri politike kemi dështuar t'i arrijmë objektivat madhore të këtij vendi.

Nëse marrim dhe i shohim ciklet politike që kanë ndodhur në Kosovë, gjithmonë të paktën në këto 40 vite të fundit kemi pasur një besim social që do të kemi ndryshim. Kemi pasur një besim në një kauzë madhore dhe një kauzë për arritjen e një qëllimi.

Për shembull në vitet e '80-ta në kuadër të represionit të aparatit shtetëror jugosllav, shqiptarët e Kosovës kanë besuar në Republikën e Kosovës. Edhe pse kanë qenë të burgosur. Edhe pse kanë qenë të përndjekur, prapë kanë besuar sepse kanë pasur një kauzë.

Në vitet e '90-ta nën pushtimin total, shqiptarët e Kosovës kanë besuar në pavarësinë e Kosovës. Në fund të viteve të '90-ta kanë luftuar për pavarësinë e Kosovës. Edhe pse të zhvendosur me dhunë rreth 1 milion refugjatë jashtë Kosovës, janë kthyer brenda një muaji të gjithë në Kosovë.

Me fillimin e viteve 2000 kanë besuar në shtetin e Kosovës. Në fund të vitit 2008-2009 ka ardhur pavarësia e Kosovës dhe që nga atëherë ka humbur orientimi politik i udhëheqësve të Kosovës, i lidërshipit kosovar dhe i kauzës politike.

Sot ne u ofrojmë qytetarëve atë ditore çka kërkohet. Nëse marrim dhe i këqyrim disa elemente, elementi i parë ka të bëjë me arsimin. Çfarë arsimimi ofrojmë ne sot? Fëmijët tanë sot në shkollë, në sistemin parafillor, fillor, fillor të mesëm, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkojnë tri orë deri në katër orë në shkolla publike.

Ndërkohë, që një pjesëtar i familjes është i detyruar që ta lëshojë vendin e punës, ose burri ose gruaja duhet të qëndrojë me fëmijë në shtëpi. Fëmija nuk edukohet mirë. Familja humb të ardhurat dhe hyn në ciklin negativ.

Elementi i dytë është sistemi shëndetësor. Sot, mjekët përballen me sfida të jashtëzakonshme, sepse nuk kanë mjete dhe gjëra të nevojshme për shërimin e pacientëve të tyre.

Problemi i tretë është siguria juridike në punë. Dhe, nëse i shohim dy sektorë të cilët punësojnë sot në Kosovë; sektori publik është sektori më atraktiv ngase pagat në sektorin publik të paktën në fund të muajit dalin, ndërsa në sektorin privat sot punëtorët punojnë deri në 12, 13 dhe 15 orë pa siguri, pa kontratë, pa kontribute pensionale, pa asnjë gjë.

Elementi i katërt, të cilin ne duhet ta shohim po ashtu, ka të bëjë me besimin social. Në çka beson sot shoqëria jonë? Në çka beson që do të ndërtohet shoqëria jonë sot? Cila është oferta që japim gjithsecili si individë në politikë, apo si parti politike.

Ne sot jemi shndërruar në individë apo grupe politike të kauzës ditore. Ne sot nëse i marrim dhe i shohim investimet e 10-15 vjetëve të fundit në infrastrukturë publike. Është e vërtetë që Kosova ka pasur nevojë për rrugë. Është e vërtetë që Kosova ka pasur nevojë autostrada, por është e vërtetë që Kosova po e mbyll këtë cikël.

Kosova ka nevojë për arsim cilësor. Ka nevojë që fëmija të dërgohet në orën 8:00 në shkollë dhe të merret në orën 14:00. Ka nevojë që prindërit të punojnë. Ka nevojë që kur e çon fëmijën, prindin ose veten në spital ta marrësh shërbimin. Ka nevojë që kur nënshkruan një kontratë për marrëdhënie pune qoftë në sektorin publik apo privat të ketë garanci juridike se ajo kontratë do të respektohet.

Ka nevojë që të ketë garanci edhe siguri që kur shkon të kërkosh drejtësi në institucionet e drejtësisë merr drejtësi dhe jo padrejtësi.

Sot, në institucionet e Kosovës, në Polici të Kosovës, Prokurori të Kosovës, Gjykata të Kosovës jepet padrejtësi. Sepse është ndërtuar sistemi i klientelizmit. Është ndërtuar sistemi i përfitimit dhe është ndërtuar sistemi i cili e dëmton të drejtën dhe interesin e qytetarëve.

Nëse e marrim dhe i shohim investimet kryesore dhe e bëjmë një analizë të vogël. Për shembull Austria i ka 83 mijë e 879 kilometra katror, 1719 kilometra autostradë. Norvegjia i ka 5 milionë banorë, 74 mijë kilometra katror, 3 800 kilometra autostradë, ndërkohë që GDP e ka 62 mijë euro për...

Kosova ka autostradë 100 kilometra Prishtinë-Prizren. Autostradë 100 kilometra Prishtinë-Shkup. Autostradë 50-60 kilometra Prishtinë-Gjilan. Autostradë 40 kilometra Prishtinë - Podujevë. Autostradë 60 kilometra Prishtinë - Mitrovicë. Autostradë Prishtinë - Pejë. Autostradë Istog - Pejë - Deçan - Junik - Gjakovë - Prizren.

Kujt i duhet këto autostrada, ndërkohë që nëse e shikon Austrinë, Norvegjinë, Zvicrën, Slloveninë, Maqedoninë si fqinjë, krejt po dalin që kanë autostrada për kilometër katror, për numër banori për GDP për kapacitet ekonomik më pak se ne.

Ku po shkojmë? Cili është orientimi strategjik? Sepse po thonë se populli po kërkon rrugë, po kërkon autostrada. Sa veta do të kalojnë nëpër këto autostrada? Të gjitha do të bëhen me pagesë, ndërkohë që nuk ka shkolla. Nuk ka arsim. Nuk ka shëndetësi. Nuk ka mirëqenie sociale.

Pastaj, nuk ka garanci juridike që do të jepet drejtësi në institucionet e drejtësisë, dhe nuk ka garanci që kur e nënshkruan një kontratë pune në sektorin privat t'i do ta marrësh pagën në fund të muajit. Që ti do të punosh tetë orë në ditë. Që brenda tetë orëve do ta kesh një orë pushim. Që kushtet e punës do të jenë të dinjitetshme. Që paga ka me qenë e dinjitetshme dhe shumë elemente të tjera të cilat nuk iu ofrohen sot dhe nuk iu garantohen qytetarit kosovar.

Asnjëri prej nesh këtu nuk po i diskutojmë këto probleme. Të gjithë po themi mos flitni, sepse është interesant se autostradat po i duan njerëzit. Të gjithë po bëjmë sondazhe, po porositim, po paguajmë.

E paguan LDK-ja, e paguan PDK-ja, e paguan AAK-ja, Vetëvendosje, Nisma, PSD-ja, të gjithë paguajmë sondazhe. Dhe sondazhet janë se nesër mbahen zgjedhjet cilën parti do ta votosh? Cili është kandidati që ju e preferoni për kryeministër? Cilat janë çështjet që ju dëshironi t'i keni? Dhe, ia vendosim autostradën, rrugën atë tjetrën dhe këtë tjetrën, dhe e orientojmë publikun dhe atë dëshirë vijmë dhe ua themi në Kuvend.

Ndërkohë që mungon lidhësi. Mungon guximi sesi do ta ndryshojmë vendin. Mungon guximi të themi që ne duhet ta bëjmë mësimin gjithëditor në Kosovë. Mungon guximi të themi se ne duhet të kemi çerdhe publike për secilin fëmijë që lind në Kosovë. Mungon guximi të themi që ne do të garantojmë...Sot i kemi sa, 100 inspektorë të punës, do t'i bëjmë 500 inspektorë të punës në mënyrë që të garantojnë që kontrata e punës në sektorin privat do të respektohet. Mungon ai guxim dhe askush nuk e thotë, sepse llogarit që diku do ta humbë një votë.

Mungon guximi të themi se rruga Istog - Pejë - Deçan - Junik - Gjakovë - Prizren s'ka fizibilitet. Ku të çon ajo rrugë? Unë me familjarët e mi në Pejë, duke biseduar para dy ditëve, jo mos fol kundër kësaj rruge, sepse i humbim votat në Dukagjin. Pse? Sepse duhet të bëhet rrugë. Ku të çon kjo rrugë? Ku shkon ti prej Istogut në Prizren?

40 vjet i kishte një afërm imi dhe e kam pyetur; sa herë ke shkuar në jetën tënde në Prizren? Katër herë, tha. Për çka ke shkuar? Me shëtit tha. Edhe sa herë do të shkosh për 40 vjet të tjera, ndoshta edhe dy herë. A bëhen 1 miliard e 600 milionë euro investime se do të shkosh edhe katër herë 10 kilometra më shkurt në Prizren.

Ndërkohë që Pejë deri te ura e Klinës është autostradë, lidhu dhe shko kah të duash në autostradë.

Autostrada në të gjitha anët, ndërkaq ne edhe 1 miliard e 600 milionë euro i planifikojmë të bëjmë autostradë, ndërkohë që popullsia në bie. Ne planifikojmë t'i japim 1 miliard e 600 milionë euro për autostradë ndërsa nuk kemi çerdhe publike për fëmijët tanë.

Fëmijët s'ke pse i çon në shkollë, sepse fëmija jonë shkon tri orë në shkollë, ndërsa fëmija i austriakut, zviceranit, sllovenit, kroatit shkon tetë orë në shkollë dhe kur të kthehet në shtëpi është fëmijë i cili do të ketë rekracion dhe aktivitet dhe të kënaqet me prindërit e vet.

Ne nuk jemi konkurrues dhe këto njerëzit në Kosovë po i ndejnë. Ata nuk po i artikulojnë sepse ne me sondazhe po ua qesim se çfarë duhet të artikulojnë ata, por ata i ndejnë në secilën ditë të jetës së tyre dhe janë lodhur prej kësaj pakënaqësie. Janë lodhur prej mungesës së guximit. Janë lodhur prej mungesës së lidhshpimit që të thuhet boll më.

Hajde ta bëjmë shkollën, çerdhen, shëndetësinë, arsimin, sigurinë juridike për kontratë të punës në sektorin publik dhe sigurinë që do të ndahet drejtësi në këtë vend kur të shkosh në polici, gjykatë apo prokurori. Këto kryhen, zgjidhet problemi. Njerëzit mendojnë të bëjnë edhe fëmijë të tjerë edhe t'i rritin fëmijët këtu dhe t'i rritin në këtë vend.

Përndryshe, nuk ka të ardhme në këtë vend.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Një temë vërtet e qëlluar e duhur, vetëm se vërejtja është për mënyrën. Mënyrën e ngutshme që të debatohet dhe të diskutohet një çështje, e cila është shumë thelbësore për të ardhmen e vendit, dhe për arsyen se pse po ndodh ikja.

Ne duhet që në fillim të këtij debati të dallojmë faktin se apo flasim për migrimin apo po flasim për ikjen. Nëse flasim për migrimin, atëherë prej se ekziston njerëzimi ekziston edhe migrimi. Ne do duhej që këtë temën nëse e trajtojmë si migrim, ta trajtojmë me të dhëna të sakta.

Shumë diskutues iu referuan temës si një migrim i natyrshëm, i cili po ndodh sot në Kosovë. Ka ndodhur edhe në të kaluarën. Por, unë mendoj që vërtet ne po flasim për ikjen. Për ikjen nga Kosova të qytetarëve të saj. Të atyre që 20 vite më parë kishin ikur nga Kosova për shkak të dhunës nga pushtuesit, por menjëherë pas çlirimit u kthyen.

Unë dua ta marr shembull një të afërm timin me të cilin para disa ditësh po diskutonim. Ai në kohën e luftës, pra 20 vjet më parë kishte ikur nga Kosova si pasojë e dhunës nga pushtuesit serbë. Ishte vendosur në Kanada dhe Kanadaja menjëherë pas luftës me familjen e tij u kthye në Kosovë.

Para disa ditësh ai më tha që tani fëmijët po ia kërkojnë që të ikin nga Kosova për një jetë më të mirë në Perëndim dhe ata ia kërkonin miratimin e tij. Ne duhet që arsyet t'i peshojmë saktë, sepse kur ndodhi në vitin 2014-2015, ajo ikja masive dhe e orkestruar, të gjithë ata që ishin vendosur në shtetet e Bashkimit Evropian, ishin intervistuar nga shtetet atje, nga përgjegjës institucionalë dhe kishin dhënë edhe arsyet e tyre të ikjes nga Kosova.

Mund të themi lirisht se disa nga ato arsye janë edhe të listuara në atë formë që disa kanë deklaruar, ose shumica prej tyre kishin deklaruar që mungesa e mirëfilltë e shërbimeve shëndetësore, e sigurimit shëndetësor, e sigurisë së përgjithshme, mungesa e vendeve të punës, e perspektivës për ta dhe për familjen e tyre i kishte detyruar të largoheshin nga Kosova.

Tani kur flasim për sigurinë e përgjithshme, ne mund të marrim shembuj të ndryshëm. Ne mund të krahasojmë pse iku Elez Blakaj, prokurori, e pse nuk iku Isa Mustafa.

Nëse prokurori Elez Blakaj është ndier i kërcënuar, atëherë mund të themi lirisht që Isa Mustafa, në detyrë si kryeministër, ishte edhe i sulmuar në vendin e tij të punës dhe në shtëpi, por Isa Mustafa qëndroi, ai nuk iku. Por Elez Blakaj iku dhe këto janë shembuj, të cilët ne mund t'i marrim nëse dëshirojmë nganjëherë ta atakojmë njëri-tjetrin, po nëse dëshirojmë të flasim drejt, dhe e kemi për obligim të flasim drejt, nuk ka shumë vend për t'u ofruar moralizime, nëse fëmijët i rritë jashtë vendit me siguri shëndetësore, me siguri të mirë publike, e po ashtu gjoja u çan hallin prokurorëve e fëmijëve të tjerë të Kosovës.

Pra, ne këtu që jemi deputetë pothuajse shumica fëmijët këtu i kemi. Mendoj që ne duhet të punojmë shumë më shumë jo për fëmijët tanë, sa më shumë për fëmijët e Kosovës për të pasur një siguri shëndetësore dhe publike për të gjithë.

Pra, më 2014 kemi miratuar Ligjin për sigurime shëndetësore, në vitin 2019 ai ligj as afër nuk duket që do të zbatohet, pra që ne të kemi sigurime shëndetësore dhe për çdo individ është e rëndësishme kjo.

Siguri e përgjithshme publike, si një prej faktorëve që njerëzit i shtyn të ikin prej Kosovës dhe mungesa e perspektivës, janë të varura drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik. Kosova sot ka një shkallë të lartë të ikjes së qytetarëve të saj, por ka edhe një shkallë të vogël të zhvillimit ekonomik.

Krahasuar me vendet të rajonit nuk do të duhej të ndodhte ikja, do të duhej të ishte më e vogël, por arsyt pse qytetarët e Kosovës ikin individualisht nga Kosova është se edhe vetë Bashkimi Evropian ua mohoi të drejtën që ata të lëvizin lirshëm në Bashkimin Evropian.

Prandaj, pas një periudhe të gjatë të izolimit, ata e kërkojnë që të shijojnë Bashkimin Evropian, edhe në formë individuale, sepse si shtet, si qytetarë, si tërësi na u mohua një gjë e tillë.

Ne sot duhet të prodhojmë strategji të mirëfillta pa dallim të partive politike, por në tërësi, duke i marrë të dhënat statistikore nga Enti i Statistikave të Kosovës që ato të jenë të sakta, të elaboruara mirë edhe nga ekspertët.

Pesë vjet më parë e këndeje vazhdimisht kam kërkuar një strategji për ruajtjen e kuadrit shëndetësor në Kosovë, nuk ka, as sot nuk ka. Sot ikin mjekët, ikin edhe pacientët. Me trendin e ikjes së personalit shëndetësor përballen edhe vende më të zhvilluara se Kosova, vendet që sot absorbojnë personelin shëndetësor kosovar, janë vende të cilave u ka ikur personeli i tyre. Ne duhet të prodhojmë një strategji të mirëfilltë për ruajtjen e këtij kuadri. E kam potencuar disa herë edhe për ish-ministrat, edhe për ministrin aktual që kjo strategji duhet të jetë qysh prej kohës së regjistrimit të këtij personeli në bankat universitare e deri tek ndarja e specializimeve e hartimit të programeve të mirëfillta sa i përket kësaj çështjeje.

Pra, ne mund të drejtojmë gishtin herë te njëra palë e herë te pala tjetër, po për të ndalur ikjen duhet të punojmë të gjithë së bashku. E ne duhet të jemi modeli më i mirë që vërtet ta ndalet ikja e të kthehet perspektiva në Kosovë duke punuar drejt dhe duke dhënë mundësinë zhvillimit ekonomik, avancimet të shërbimeve shëndetësore që ato të jenë shërbime shëndetësore të mirëfillta, sigurisë së përgjithshme publike dhe zhvillimin e një sistemi të drejtë të drejtësisë të paanshëm, i cili vërtet ndihmon zhvillimin e një shteti ligjor.

Unë besoj që pa dallim partive politike ne mund ta bëjmë një gjë të tillë nëse dëshirojmë të punojmë bashkë, e shpeshherë ato interesat tona politike, afatshkurtra, i përdorim sa për të prodhuar tema.

Prandaj, mendoj, edhe në fillim e thashë që kjo temë është dashur të diskutohet jo për nguti, por e peshuar dhe e analizuar mirë, sepse nuk po flasim për mërgime të zakonshme, por po flasim për ikje të qytetarëve, si pasojë e arsyeve të cilat i thashë më parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e ka deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës,

Për shkak të eksplimit shëkullor nga okupatori serb dhe keqeverisjes në këto 20 vjetët e fundit, Kosova për një pjesë të madhe të qytetarëve të saj, sidomos për gjeneratën e re është bërë vend i paperspektivë.

Orientimi i gabueshëm i investimeve, privatizimi skandaloz, e sidomos korrupsioni ka ndikuar që vendi të stagnojë ekonomikisht.

Mungesa e sigurisë, padrejtësitë e theksuara shoqërore, shërbimet e dobëta shëndetësore, e sidomos mungesa e sigurimeve shëndetësore e kanë rritur në masë të madhe pakënaqësinë e qytetarëve karshi politikave shterpe të prodhuar nga klasa politike që e ka sunduar vendin dy dekadat e fundit.

Mungesa e investimeve në arsimin e mirëfilltë për gjeneratën e re është kulmi i së keqes në këtë vend.

Prodhimi i kuadrove pa analizuar tregun e punës, pa kriteret e domosdoshme për çdo sistem të mirëfilltë të arsimit, diplomat që nuk po sigurojnë vende të punës po prodhojnë zhgënjim, por edhe ata që po punësohen në sektorin privat, ku ashiqare po u shkeljen të drejtat dhe ku pagesa nuk po ua siguron as nevojat elementare për jetë, nuk po ua zgjidh problemet, por vetëm sa po ua rrit bindjen të rinjve se në këtë vend nuk ka perspektivë.

Thirrja e kujtdo qoftë, e sidomos e atyre që kanë qenë në pushtet gjatë këtyre viteve, nuk e ndalin migrimin. Për ta reduktuar këtë të keqe të madhe që po i ndodh vendit, duhet të luftojmë seriozisht korrupsionin, por korrupsioni duhet të luftohet nga ata që vetë nuk janë të korruptuar. Investimet kapitale duhet të orientohen në arsim, shëndetësi dhe prodhim vendor, që pastaj edhe prodhon vende të punës, duhet të krijohen kushte dhe siguri për investime të huaja.

Unë po ndalem te ndikimi i arsimit në ndryshimin e gjendjes në të cilën jemi.

Për të arritur që të ndryshohet gjendja në këtë vend dhe të rinjtë të shohin perspektivë këtu, duhet të fillohet nga rritja e buxhetit për arsim, por edhe të përmirësohet mënyra e menaxhimit të tij. Të

gjithë fëmijët të përfshihen në çerdhe publike, të përkrahen fëmijët me aftësi të veçanta, mësimi në shkolla të bëhet tërëditor, shkollat të jenë të pajisura me laboratore, kabinete e biblioteka, punës praktike t'i kushtohet rëndësi e veçantë, orientimi i nxënësve për profesione të bëhet në fazë të hershme dhe hapja e drejtimeve qoftë në shkolla të mesme, qoftë në universitete, të bëhet në përputhje me nevojat e tregut. Po shumë e rëndësishme është dhe të bëhet depolitizimi i sistemit arsimor. Nëse angazhohemi që këto të arrihen në arsim, natyrisht që kjo do të ndikonte edhe në rritjen e perspektivës për të rinjtë, të cilët të gatshëm po e lëshojnë vendin.

Derisa punësimi, si e drejtë elementare e njeriut të bëhet privilegj, siç është aktualisht në Kosovë, migrimi nuk do të vazhdojë. Pavarësisht se për këtë gjendje të rëndë faktore janë qeveritë me radhë, është detyrë e kësaj Qeverie që të fillojë menjëherë të ndërmarrë masa konkrete për krijimin e kushteve për një jetë normale në vend. Por, qeveritarët sot nuk janë këtu, e kjo edhe më tutje e rrit zhgënjimin e atyre që presin masa nga ne dhe sidomos nga Qeveria.

Dhe, në fund, kisha dashur të ndalem pak te propozimi i deputetes Teuta Haxhiu, të cilën unë e përkrah plotësisht, madje jo vetëm për këtë mandat, po për të gjitha mandatet, jo vullnetarisht të ndodhin këto gjëra, por këto të ndodhin edhe me ligj, edhe pse propozime të tilla në këtë Kuvend në formë të amendamenteve ka pasur edhe më parë, ku është kërkuar që zyrtarëve të lartë me ligj t'u ndalohet angazhimi në më shumë se një vend pune, deputetëve të mos u jepen mëditje për seanca dhe as për komisione, sepse ata paguhen për këtë punë me rrogën që e marrin, deputetëve, ministrave, anëtarëve të bordeve të ndryshme të mos u lejohen paga aq të larta dhe kështu pak a shumë të ndihmohet në krijimin e një fondi për rritjen e punësimeve, por për t'i rritur punësimet në këtë vend, ka nevojë për një reformë shumë më të thellë, ku vërtet të gjithë ne do të angazhohemi bashkërisht që të rinjve tanë, të cilët nuk po shohin perspektivë në këtë vend, t'u krijojmë kushte për jetë normale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Rasim Selmanaj, nuk është. Atëherë, fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë që jeni prezentë në sallë,

Sot për çka jemi mbledhur, e humbi kuptimin plotësisht. Dihet mirëfilli se kërkesa e deputetëve për t'u shqyrtuar kjo pikë e rendit të ditës është para dy javëve. Ndërkaq sot u mblodhëm për të folur për një diçka u desh të flitet sikurse mbi ndërtimin e një kauze të madhe që po ndodh në Kosovë për të reflektuar negativisht në zhvillimet e mëtutjeshme institucionale dhe në agjendën e perspektivës pozitive të Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitet e ardhshme.

E shohim këtë, e dimë për eksodin e shqiptarëve. E folën edhe kolegët më herët, kryesisht zoti Gashi. Populli i Kosovës është i lidhur me vendin e vet, e dimë që janë dëbua një milion

shqiptarë me dhunë nga aparati i Milosheviqit në kohën e luftës, dhe mbi themelet e djegura të gjithë janë kthyer këtu.

Por ne e dimë edhe një diçka tjetër se janë vetëm 11 vjet që jemi shtet dhe këtë problemin e eksodit dhe migracionit e kanë edhe vendet anëtare G7, për shkak se gjithkush kërkon një jetë më të mirë. Ne për 11 vjet po duam të nxëmë rendin dhe të jemi në rresht me shtetet, në bazë të kritikave po flas, që janë me qindra vjet shtet.

I dimë problemet e zhvillimit ekonomik, i dimë problemet infrastrukturore, sepse sot u thirrëm të flasim krejt diçka tjetër, e folëm për asfalt, se Qeveria nuk është këtu dhe e dimë mirë se në orën 10:00 është vendosur që kjo pikë e rendit të ditës të hyjë në agjendën e Kuvendit dhe seancat që kanë qenë të planifikuara për sot janë shtyrë për të premtën dhe të hënën.

Qeveria për atë shkak s'ka qenë këtu, dhe u fol për rrëzimin e Qeverisë pse nuk janë sot pjesëmarrës këtu.

Unë kam arritur të një konkluzion që sot patëm edhe zbulime, se kemi një parti planetare tjetër këtu, po e dimë që janë parti satelitore dhe nuk kanë këmbëngulësi në atë qëndrueshmërinë e tyre afatgjate. Po në të gjitha ato që u bisedua, për çështjet investive nuk ka filluar gjithçka që një vit e tetë muaj me këtë Qeveri, më erdhi shumë mirë se edhe ato parti të tjera që kanë qenë më herët në pushtet, e kanë kuptuar se programi i tyre qeverisës nuk paska qenë në formën më të mirë dhe në planifikime si afatshkurtra dhe afatgjata.

Të gjitha ato investime që sot bëhen dhe po flitet shumë për asfaltin, për investime të tjera janë si rrjedhojë e një projektimi edhe të buxhetit, po edhe të një politike investive afatshkurtër e afatmesme në Republikën e Kosovës, që 90% prej tyre janë nga qeveritë e kaluara, deri edhe të planifikimi i buxhetit dhe nuk mund t'i iket asaj agjende sepse ne mbikëqyremi nga fondet, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar lidhur me këto çështje dhe si po shkon përfundimi i këtyre investimeve.

Kur e them këtë, ne po flasim për ikjen, nuk po ik askush, po shkojnë e po vijnë, po shkojnë e po vijnë qytetarët e Republikës së Kosovës. Kemi pasur rastin, u fol më herët në vitin 2015 kur ka pasur një ikje, po tani njerëzit në kohën e kësaj qeverie po shkojnë në mënyrë të ligjshme.

Agjendat ruse edhe serbe, po edhe të Lindjes nuk duhet të jenë kauza në Republikën e Kosovës sot dhe për të nxjerrë një pasqyrë para opinionit ndërkombëtar se ne jemi qytetarë që vetëm lëvizim dhe migrojmë. Sot asnjë qytetar i Republikës sa është koha e kësaj qeverisje nuk ka dalë në mënyrë ilegale jashtë Republikës së Kosovës.

E dimë diasporën tonë sa të fuqishme e kemi, na kanë mbajtur deri në përfundimin e luftës, edhe sot na mbajnë, të gjithë flasim sa janë remitenca, 600-700 milionë në vit, gati sa gjysma e buxhetit të Republikës së Kosovës vjen nga diaspora jonë e fuqishme.

Nuk kemi mundur t'u krijojmë kushte që ata të investojnë në Kosovë, është shumë e vërtetë. Ne s'kemi mundur t'u sigurojmë kushte institucioneve tona dhe atyre mekanizmave të tjerë prodhues në Kosovë, sepse as 24 orë rrymë s'kemi mundur për 10 vjet pas luftës t'u sigurojmë mundësi investive në Kosovë.

Sot është gjendja më e mirë, presim të jetë edhe më e mirë.

E dimë se prej qershorit deri në shtator gjithë diaspora shqiptare zbret në Kosovë, bile nganjëherë kam dëgjuar shumë qytetarë të thonë a janë gati të shkojnë se na lodhën, na kanë bllokuar krejt, e është e fuqishme.

Po prej 1 qershorit deri më 1 shtator e dimë se i kemi nja 30-40 mijë dasma, ne mund të flasim si të duam, po duhet të pasqyrojmë një realitet edhe të jemi të sinqertë. Edhe në ato dasma mbi 55% të njerëzve janë që martohen qytetarë që janë nga diaspora, ose na e marrin ndonjë djalë ose ndonjë çikë të mirë këtu. Të jemi objektiv në këtë rast edhe të jemi realistë, kështu ka filluar edhe është rritur emigracioni, e njerëzit tanë kanë shkuar jashtë edhe pas shpalljes së pavarësisë, edhe sot shkojnë, po kryesisht është edhe një pjesë tjetër, se një pjesë e inteligjencës, njerëzit që kanë kryer edhe kanë studiuar, një pjesë e tyre kanë studiuar edhe jashtë, po një pjesë edhe e mjekëve për shkak të burimeve më të mira financiare po e lëshojnë Kosovën.

Po fatmirësisht, edhe një herë po lutem, që askush nga Kosova, kjo vlen edhe për opinionin publik, por edhe për opinionin tonë institucional nuk është kah e lëshon Kosovën në mënyrë të paligjshme, merr një vizë, vizë pune, bashkim familjar, të gjitha këto ndodhin, edhe sot kur thirrmi dhe e pasqyrojmë këtë si të jashtëzakonshme, është në kohën kur ne jemi në prag të liberalizimit të vizave. Por, këta qytetarë e dinë mirëfilli se janë të lidhur për vendin e vet dhe vazhdimisht do të jenë pjesë e Kosovës, por nëse neve ose qeveritë e ardhshme, nëse s'e kanë bërë deri këtu, përpos rrethanave të këtyre investimeve të mëdha, si janë autostradat, që janë korridore të fuqishme, sepse ne nuk jemi vend bregdetar, sikurse po flitet për Norvegjinë apo dikë tjetër dhe të gjitha rrugët të çojnë deri në atë pjesë dhe fillon oqeani. Ata kanë vetëm rrugë për të dalë, ne lidhemi, Kosova është korridor i fuqishëm në Ballkan, duhet të jenë këto autostrada, por besoj se të investojmë edhe në infrastrukturën përcjellëse për investimet e tjera strategjike në rritjen e zhvillimit ekonomik në të ardhmen.

Kur flasim në përgjithësi, se morën tema dhe krejt temat politike po mundohemi t'i shkarkojmë në kohën e kësaj qeverisje, bile kur flasin deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, fjalën e parë e kanë "rrezimin e Qeverisë", ma ka marrë mendja se si janë të programuar këta njerëz, vetë nesër po të

jetë në Qeveri Albin Kurti, në javën e dytë të qeverisjes thonë “ta rrëzojmë Qeverinë Kurti”, ashtu e kanë programin, nuk pasqyrojnë asgjë objektive, mirëpo vetëm anën e errët të medaljes. E dimë që ka gabime në çdo qeverisje, mirëpo veç terr e zi të flitet për vendin e vet, me këtë subjekt satelit apo planetar, siç e thanë vetë, mund të ndodhë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë jam i detyruar të jap një sqarim për procedurën, meqë po përsëritet që disa herë. Kjo është një seancë e jashtëzakonshme. Seancat e jashtëzakonshme nuk i cakton Kryesia e Kuvendit, por deputetët, të cilët e kërkojnë. Kjo seancë është kërkuar më datën 29 mars dhe është bërë publike. Domethënë, edhe përfaqësuesit e Qeverisë e kanë pasur të njohur, por pavarësisht kësaj, Qeveria do duhej të kishte përfaqësuesit në seancë, e përsëris, këto seanca nuk i cakton Kryesia e Kuvendit.

Tani sipas radhës fjalën e ka deputeti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë!

Nënkryetar i Kuvendit,

Kolegë të nderuar,

Para se të hyj në temën e sotit, më duhet të theksoj një vërejtje serioze edhe ndaj kryeparlamentarit, por edhe të Kryesisë të Kuvendit, nuk mbahet mend keqmenaxhim më i madh i punës së Kuvendit se sa që po ndodh në këtë legjislaturë. Asnjë seancë nuk fillon me kohë, seancat caktohen në aso mënyre që pengon përgatitjen e deputetëve për të trajtuar temat përkatëse, për këtë temë kaq të rëndësishme na keni dhënë zero kohë të përgatitemi, edhe pse siç u theksua më herët, është kërkuar kohë më parë. E pastaj pas një orë debati sot kryeparlamentari na dërgon në pauzë, e nuk kthehet më, thjesht jemi bërë ne 120 deputetë këtu peng i agjendës personale të kryeparlamentarit dhe ai me disa njerëz të tjerë po investojnë shumë që të degradohet ky institucion, që është paraparë të jetë institucioni më i lartë i vendit. Shpërfillja e abuzimi që po i bëni këtij institucioni, por edhe shtetit e qytetarëve të këtij vendi, tregon mentalitetin antishtet që e kanë këta njerëz, që aktualisht mbajnë pozitat vendimmarrëse në këtë vend. Dhe, kjo të nderuar kolegë, është edhe baza dhe arsyeja pse Kosova po zbrazet.

Të dashur qytetarë,

Hipokrizia e treguar nga të ashtuquajturit liderë kur thërrasin qytetarët të mos ikin nga vendi, thjesht fyen inteligjencën edhe dinjitetin e qytetarëve tanë. Qytetarët tanë nuk po ikin vetëm nga varfëria, ata nuk po ikin vetëm nga hjekat, as edhe nga mungesa e vullnetit të tyre për t'u ballafaquar me vështirësitë që paraqet jeta në Kosovë. Ata po ikin nga ju që sot keni zaptuar çdo pore të shoqërisë. Po ikin nga ju që sot dilni dhe fyeni inteligjencën e tyre, ata po ikin nga ju që po na detyroni të thërrasim seanca të jashtëzakonshme, sepse na keni sjellë në gjendje të jashtëzakonshme. Po ikin nga abuzimi që sot ju ua bëni qytetarëve të këtij vendi dhe vetë shtetit ku ne jetojmë, ikin për të mos u kthyer më. Nuk dua të flas shumë për punësimet e familjarëve e militantëve, duke eliminuar tërësisht meritokracinë, e as për faktin që juve në pushtet ju ka

humbur tërësisht marrja, e qesheni kur ju flasim për krimet e keqpërdorimet që ju kryeni në baza ditore. Nuk dua të flas as për sektorët e ndryshëm që ju keni shkatërruar, si: drejtësia, shëndetësia, arsimi, ekonomia e shumë të tjera. Qytetarët i dinë të gjitha bëmat tuaja, sepse po jetojnë çdo ditë si viktimë e veprave tuaja. Prandaj, po ju them juve që sot jeni në pushtet, se çka keni prekur, keni rrënuar e keni shkatërruar dhe kjo ua ka humbur shpresën qytetarëve tanë. I keni detyruar që të mos e thërrasin më Kosovën atdhe. Këtyre qytetarëve që nuk iu nënshtruan as agresionit të egër të pushtetit serb me dekada, sot ua keni thyer shpirtin.

Sot, ju i keni detyruar që të marrin rrugën e kurbetit që shumë prej nesh e dimë sa është e rëndë. Nuk dua të flas sot as për mënyrat se si mund t'ua kthejmë shpresën qytetarëve tanë. Opsione dhe alternativa për këtë ka shumë, qoftë për reformë në drejtësi, zhvillim ekonomik, arsim cilësor apo diçka tjetër. Por, asnjë nga ato nuk mund të zbatohen përderisa ju që sot jeni në pushtet, qëndroni në skenën politike dhe merrni vendime kinse për këtë vend. Rrjedhimisht, për fund, unë nuk e marr dot të drejtën që të bëj thirrje që qytetarët të mos kërkojnë shpresë diku tjetër, por shfrytëzoj këtë rast që të lus ata që kanë vullnetin dhe mundësinë që të bashkojmë forcat nga Kosova apo nga vendqëndrimi juaj i ri me një qëllim të vetëm: të bashkohemi që të eliminojmë nga skena politike ata që po na eliminojnë nga atdheu dhe ta bëjmë këtë si parakusht për kthimin e shpresës për qytetarët, si parakusht për ditë më të mira për Kosovën dhe qytetarët e saj, si parakusht që gjeneratat e reja të mos detyrohen të kërkojnë shpresë diku tjetër, ashtu si kërkuam ne dikur nga abuzimi serb, e sot ju nga abuzimi prej zaptuesve vendorë të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani ia jap fjalën deputetes Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Shala!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Ikja e të rinjve është një temë shumë serioze, fakt është që ka një trend migrimi, i cili është duke u zhvilluar para syve tanë, i cili institucionalisht nuk guxon në asnjë mënyrë dhe në asnjë formë të anashkalohet edhe të neglizhohet.

Institucionet tona duhet të hetojnë shkaqet se pse po ndodh, qoftë edhe për të pasur statistika, në mënyrë që të bëhen analiza të mirëfillta rreth kësaj çështjeje. Deri më tani nuk kemi ndonjë statistikë të bazuar, ne edhe sot këtu si deputetë flasim thjesht mbi raportet e mediave dhe turmave që shohim para ambasadave. Kosova është një vend i vogël dhe në rast se ky trend vazhdon apo pëson rritje, atëherë ne gjendemi para një problemi serioz. Ka shumë deklarata në ajër, se ikja po ndodh për këtë apo për atë arsye dhe drejtim të gishtit mbi atë apo këtë bartës të fajit.

Por, një proces i tillë nuk është aq i thjeshtë sa për t'u mbyllur me deklaratat e tipit elektoral apo të zgjidhet me një seancë të jashtëzakonshme e ad hoc, siç është edhe kjo seancë e sotshme.

Migrimi është pjesë e zhvillimit të botës, pra për sa vjet ekziston njerëzimi, po aq do të ekzistojë edhe migrimi, dallimi duhet të bëhet nëse ky migrim ka për bazë një zgjedhje personale, pra nëse një person, me gjithë standardin që ka në një vend, është në kërkim të një vendi tjetër, ku ai mendon se mund të jetojë më mirë, apo ka për bazë dështimin institucional të një vendi, i cili nuk ofron mundësitë minimale për qytetarët e vet. E para, është diçka që ecën bashkë me njerëzimin dhe nuk do duhej të tërhiqte vëmendjen tonë, por të ndalemi te lloji i dytë i migrimit. Nëse dalim në terren, ne detyrimisht duhet ta pranojmë se përballemi me një ndjesi që ka lëshuar rrënjë në Kosovë dhe kjo është ndjesia e të mos pasurit shpresë. Pra, kemi të bëjmë me proces, i cili nëse i janë dashur 20 vjet për të lëshuar rrënjë, kërkon po aq vjet për ta çrrënjësuar. Pse ka ardhur deri te ky perceptim? Këtu duhet të bëhet një analizë dhe të fillohet me reformat përkatëse që ky perceptim të ndalet dhe gradualisht të eliminohet.

Pika tjetër është zhvillimi ekonomik dhe stabilizimi i sektorit privat. Për të qenë të gatshëm të përballemi me një problem të këtyre përmasave, ne duhet të ndalemi te hapat që janë ndërmarrë në ofrimin e kushteve në sektorin privat, sepse e dimë që Kosova nuk mund t'i punësojë të gjithë qytetarët e saj në Administratën Publike. Shpeshherë ekspertët e fushës ekonomike dhe zyrtarët përgjegjës flasin se Kosova ka rritje ekonomike, por sa kanë pësuar përmirësime kushtet e të punësuarve në sektorin privat? Secili që merret me studimin e proceseve të vendeve post konfliktuale ka hasur në një periudhë kohore, ku mbizotëron një lloj anarkie në tregun e punës dhe ku shfrytëzohet gjendja e rëndë e qytetarëve, të cilët kanë nevojë për mbijetesë.

E, Kosova është një vend i llojit klasik të kësaj kategorie. Problemi esencial te ne është që edhe 20 vjet pas çlirimit nuk shihen përmirësime përmbajtjesore të kushteve të atyre që janë të punësuar në sektorin privat, thjesht këta persona janë lënë në mëshirën e punëdhënësve të tyre, të cilët janë të orientuar ekskluzivisht në profitin e tyre personal. Ne mund të kemi bërë ca ligje, por a mjafton vetëm nxjerrja e këtyre ligjeve. Ku jemi ne në mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve, edhe në këtë pikë është koha e fundit për veprim, jo për fjalë të bukura, por për veprime konkrete. Në shumicën e rasteve punëtorët në sektorin privat trajtohen si skllëvër me orar të stërzgatur, pasiguri në punë, pa asnjë ditë pushimi në javë, për ta nuk ka festa zyrtare, nuk ka pushime vjetore me pagesë, për ta s'ka kontrata të mirëfillta pune e varg i gjatë i problemeve me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë. Ne kemi shumë gjenerata, të cilat kanë humbur dekada të jetës së tyre duke pritur me shpresën se do të bëhet mirë. Sot, në kushtet dhe mundësitë që ofrojnë shtetet e zhvilluara, të cilat kanë nevojë për fuqi punëtore, nuk mund të rrimë duarkryq dhe të presin që edhe gjeneratat e reja do të rrinë në atë modusin e pritjes.

Duhet që ne të jemi ata që kanë guxim për reforma dhe që kanë guximin, qoftë edhe për ta çrrënjësuar një sistem, i cili qytetarët e vet i shtyn drejt migrimit, në rast se vijmë në konstatim që defekti është te sistemi që ne vetë e kemi ndërtuar. Për të dalë ne dhe për të kërkuar që të ndalet ikja, ne duhet të prijmë me reforma përkatëse dhe me stimulime të natyrave të ndryshme, të cilat ndikojnë te secili që të mendojë dy herë para se të niset dhe ta marrë një rrugë të padëshiruar.

Edhe ditën kur kolegu ynë ka bërë kërkesën për të nënshkruar thirrjen për këtë seancë, unë personalisht e kam refuzuar me seriozitetin më të madh, sepse edhe atë ditë, edhe sot, e besoj që sot është bindur edhe vetë Fidani që tema e të rinjve nuk guxon të trajtohet në mënyrë të jashtëzakonshme, me seanca të përshpejtuara, në seanca ad hoc të thirrura sa për të bërë monologë politikë dhe elektorale.

Të rinjtë duhet të trajtohen me seriozitetin më të madh, duhet të kemi strategji, duhet të kemi platformë, duhet të kemi veprime konkrete që të rinjtë e Kosovës ta duan vendin e tyre dhe të gjejnë mundësi për të jetuar në Kosovë. Këtu sot u kritikua edhe mungesa e kryetarit të Kuvendit, se nuk paska qenë në seancë, atëherë ku mbetet kuptimi i pesë zëvendëskryetarëve që ka Parlamenti i Kosovës, nëse duhet që kryetari të lidhet nga karrigia e tij për të udhëhequr seancat. As kryetari dhe askush nuk mund ta lërë Kuvendin peng, por peng e lë secili deputet vendin e vet dhe përgjegjësinë, të cilën ai e mban. Sot, pajtohem me të gjithë ata që thanë “është dashur të jenë edhe ministrat, edhe kryeministri dhe e gjithë Qeveria këtu” që të paktën herë pas here ndoshta edhe të na korrigjojnë, edhe të na kritikojnë, po edhe të na japin përgjigje në shumë vërejtje që ne i dhamë sot, por megjithatë prapë po kthehem te hezitimi im për ta nënshkruar kërkesën për këtë seancë, sepse të rinjtë e Kosovës nuk guxojnë të trajtohen në mënyrë të përshpejtuar dhe thjesht sa për ta mbushur orën e seancës ose ditën e seancave parlamentare për të dalë dhe për të rrëfyer tek të rinjtë e Kosovës se qe ne e ngritëm debatin parlamentar.

Unë kisha dashur të di shumë në fund të kësaj seance cili do të jetë rezultati? A do të zgjidhen problemet e të rinjve duke e sharë kryeministrin Haradinaj apo kryetarin Veseli? Thjesht, nuk e kemi luksin që ne të merremi me njëri-tjetrin në seancat e tilla dhe me temat kaq të rëndësishme. U fol që sot është zaptuar shteti dhe po ikin qytetarët e Republikës së Kosovës, nga parafolësi im u diskutua ashpër dhe me zë të lartë, po ku ishte ai para 2-3 vjetëve, kur pikërisht partia e tij ishte në Qeveri, a duhet që edhe nga ajo parti të kërkojmë llogari ne sot? Prandaj, nuk guxojmë që gishtin t’ia drejtojmë njëri-tjetrit, duhet vetë të ndalemi dhe të mendojmë se çka secili në vetvete ka bërë për ndalimin e këtyre të rinjve për të mos migruar jashtë vendit. Dhe, një herë shfrytëzoj rastin dhe shpresoj shumë që kjo të jetë seanca e fundit që ne e thërrasim si seancë të jashtëzakonshme për të trajtuar problemet e të rinjve të Kosovës, por të ulemi, të bëjmë projekte, të bëjmë platformë, strategji, të monitorojmë ligjet, të cilat e rregullojnë jetën e qytetarit të Republikës së Kosovës dhe vetëm atëherë kur ne t’i kemi kryer punët dhe detyrat tona, ne do të mundemi dhe do të kemi mundësi që ta drejtojmë gishtin dika tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetes Saranda Bogujevci.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

Kisha dashur dy gjëra së pari t'i sqarojmë, e para është që u fol shumë rreth thirrjes së seancës, në fakt, propozimi ka qenë prej kryesuesit të Grupit të të Rinjve, zotit Rekalii, që ka qenë në pajtim me të gjithë anëtarët e tjerë domethënë të bordit të Grupit të të Rinjve, por edhe me nënshkrimin e deputetëve nga të gjitha subjektet politike. Domethënë, kjo nuk ka qenë veç dëshirë e Fidanit, por ka pasur edhe përkrahjen e të gjithëve dhe është dërguar me kohë, në fakt është situatë e jashtëzakonshme dhe mendoj që është shumë me rëndësi të diskutohen këto çështje.

Tjetra, sa i përket mospranisë së Kabinetit qeveritar këtu, është e paarsyeshme të thuhet se është thirrur seanca ad hoc, kur në fakt kemi pasur seancë tjetër që ata ishte dashur të jenë këtu, domethënë e kanë ditur që do të ketë seancë sot, sido që të jetë. Kështu që kjo është e paarsyeshme. U thanë shumë gjëra rreth situatës që e kemi sot dhe ikjen e të rinjve, unë dua t'ia nis nga aspekti i të rinjve dhe punën e tyre që e kam parë në Kosovë. Ka shumë të rinj që kanë punuar shumë, kanë kontribuar shumë për këtë vend, ende janë duke e bërë, me forcat e tyre janë duke u munduar që të punojnë dhe ta gjejnë veten këtu, por pa përkrahje. Prapë e ndërlihd, më vjen keq që nuk i kemi asnjë prej ministrive këtu, për shkak që njërin prej problemeve që i kam parë, qoftë kur kam qenë pjesë e Drejtorisë së Kulturës në Komunën e Prishtinës, është aspekti i financimit dhe krijimit të mundësive të rinjve për të mundur t'i zhvillojnë idetë e tyre, punën e tyre. Domethënë, nuk ka planifikim të mirëfilltë të buxhetit, nuk ka qëndrueshmëri, të rinjtë gjithherë kanë ardhur dhe ende e bëjnë me ide të ndryshme, jo vetëm për punësim, por edhe ide se si mund ta zhvillojnë vendin. Kështu që këto mundësi nuk u janë dhënë, nuk u janë hapur dyert në fakt që të mund ta zhvillojnë punën e tyre.

Tjetra është, po, po flasim se çka mendojmë se u nevojitet të rinjve dhe pse po largohen. Po, takohemi me të rinjtë, por a jemi duke i dëgjuar me të vërtetë se çfarë kanë nevojë. Unë mendoj që jo dhe mendoj që duhet të fillojmë me të vërtetë t'i dëgjojmë se si ata e shohin Kosovën, çka u nevojitet, çka u nevojitet për të pasur një jetë të mirë, një perspektivë. Po, është e vërtetë që nuk po largohen të rinjtë vetëm pse jetojnë në kushte të vështira, nuk kanë bukë të hanë, por po largohen plot të rinj që i kanë kushtet e mira, por nuk ka asnjë perspektivë. Dua ta përmend një përvojë personale kur jam kthyer prej Anglisë të jetoj në Kosovë, gjatë gjithë kohës kur jam takuar me qytetarët dhe me të rinjtë, më kanë thënë: "Pse je kthyer? Çka po lyp ti në Kosovë?"

Kam filluar me të vërtetë të mendoj pse është kjo pyetje dhe çka kam arritur të kuptoj është që fati im që me një vend tjetër më janë krijuar të gjitha mundësitë që të zhvillohem, të shkollohem, por edhe ta kem mundësinë të zgjedh me të vërtetë ku dua të jetoj jetën dhe ku dua unë të jap kontributin tim. E për fat të keq, këta të rinj nuk e kanë atë mundësi në Kosovë, është e dhimbshme që gjithë këto vite prej përfundimit të luftës jo vetëm që ballafaqohen me punësim, por jo vetëm që ballafaqohen me punësim, po ende qytetarët e vendit ballafaqohen me probleme siç u përmend më herët me rrymë, me ujë të pijshëm, edhe kjo, shumë herë e kam diskutuar, në kohën kur kam qenë fëmijë, para luftës jemi ballafaquar me këto probleme dhe të jemi në vitin

2019 dhe ende të kemi këto probleme dhe të rinjtë tanë të rriten në kësi kushtesh, është e papranueshme.

Unë kisha dashur shumë që ta di me të vërtetë çka duan të rinjtë që të ndryshohet dhe njëra prej gjërave që e kam kuptuar si deputete dhe pjesë e Komisionit ku shqyrtojmë edhe petitionet, është që përmes kësaj mënyre kemi mbërrirë të shohim shumë shqetësime edhe që e obligon edhe Kuvendin, po edhe Qeverinë të ndërmarrë hapa. Kështu që është edhe njëfarë forme njëfarë njoftimi ose thirrje për të gjithë që ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të kërkojnë llogari prej të gjithëve. Kaq. Nuk do ta zgjas më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Rasim Selmanaj, nuk është në sallë. Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar,

Kur po flitet për një temë e cila kërkon vëmendjen institucionale, natyrisht që është e pafalshme mungesa e Qeverisë. Përndryshe si do të kishte kuptim që të caktohen nga pesë-gjashtë zëvendësministra e të mos i lirojnë, të mos e kenë mirëkuptimin për shëfat e tyre ministra që në tema të tilla të jenë prezent këtu. Ky është ndoshta sinjali për pakujdesin ndaj rinisë dhe ky është sinjali që Kuvendi duhet të kërkojë shumë më shumë përgjegjësi nga ata dhe kjo është thirrja për qytetarët që të korrigjojnë apo ndoshta të shohin më qartë edhe momentet kur ata dalin në një ditë votim, të shohin qartë se kujt ia dedikojnë apo kujt ia japin besimin edhe vendosin për fatin e tyre.

Ta themi të drejtën një shumicë e madhe apo pjesa më e madhe e viteve të pasluftës flet për pakujdesinë e mjaftueshme, pakujdesin institucional dhe vetë buxheti nëse e bëjmë një analizë të buxhetit për rininë, na tregon se nuk kishte vëmendje të theksuar për atë që e meritojnë të rinjtë. Një buxhet shumë simbolik nuk ka garantuar perspektivë të rinjtë. Një pakujdesi institucionale nuk ka garantuar perspektivën për ta dhe në një formë ka qenë një kohë kur rininë ua kemi lënë në dorë mekanizmave joqeveritarë, ndonjëherë edhe donacioneve ndërkombëtare, për të projektuar ata qoftë të kampeve siç i kemi parë ndonjëherë të argëtimit apo më mirë të shfrenimit dhe forma të tjera dhe nuk kemi pasur politika nacionale të cilat sot kishin për të na dhënë neve mundësinë për të folur për më shumë kujdes ndaj të rinjve.

Shtuar kësaj edhe modelin jo të mirë të zgjidhjes së vetë projektit për Kosovën, ku ne vazhdojmë të kemi probleme madhore politike, si rezultat i kësaj edhe izolimi apo moslëvizja e lirë, e cila i bën njerëzit të ikin më shumë sesa do të kishin pasur mundësinë për një kohë shkëputje deri në arritjen e një perspektive më të mirë. Pastaj modeli i bërjes së politikës e cila me të vërtetë ka treguar se nuk është bërë një politikë e drejtë siç u përmend edhe nga folësit e tjerë, një privatizim i keq i cili ka ushqyer disa politikanë që kanë vënë monopole gjatë privatizimit të

aseteve shtetërore. Edhe ata janë vetëmjaftuar, janë ngopur aq shumë sa që nuk kanë ndjerë nevojë të projektojnë ardhmëri për dikë. Ata janë vetëmjaftuar të krijojnë servilë për vetveten, duke kalkuluar në numra se sa njerëz u duhen për ta arritur fitoren e tyre, një fitore e Pirros, e cila do t'u hakmerret atyre dhe të fëmijët e vet, ngase në një formë të tillë vrasin të ardhmen e cila nuk i duhet askujt në këtë formë

Ekonomia për fat të keq ka rënë në duart e krimit. Informaliteti i lartë i ka ushqyer të tillët. Unë përmenda për ngopje, po me gjasë ata nuk dinë edhe të ngopen. Pastaj bartja e mentalitetit monist të një pjese të politikbërësve, të cilët vazhdimisht kanë folur apo kanë krijuar klientelën e vet duke ushqyer sektorin publik, pa menduar asnjëherë edhe në krijimin e politikave të mira për sektorin privat. Atë e ka ngulfatur në forma të ndryshme dhe si rrjedhojë e krejt kësaj gjendjeje, sektori privat nuk është atraktiv për punësim. Edhe kur kemi punësim, kemi diskriminim. Në këtë rast, dua të përmendë diskriminim përpos të rinjve, posaçërisht po e veçoj aspektin gjinor diskriminues. Gjatë kësaj kohe duhet të flasim saktë se ka rënë shtimi natyror, ka ikur gjenerata reprodutive e trazuar prej luftës, gjatë dëbimit, ka ikur një pjesë reprodutive e cila pastaj natyrisht ka kërkuar edhe partnerë nga këto të cilët në njëfarë forme ka ndikuar në zbrazje, qoftë përmes edhe gjetjes së perspektives, por edhe të bashkimit familjar. Mandej ka krijuar debalancën gjinore që e lëndon edhe familjen, e që si rrjedhojë ka edhe shumë çështje dhe problematika në familje në përgjithësi. Kemi një numër shumë të madh të vajzave që u ikën ora biologjike në një situatë të paperspektivë dhe të papunësisë së theksuar dhe që bie më shumë barrë mbi to.

Po ashtu si politikë jo e drejtë është edhe mosorientimi i drejtë profesional, stigma shoqërore për disa profile, investimi në diçka të gabuar dhe pa perspektivë, reflektimi në gjendjen psiko-sociale dhe si rrjedhojë edhe zhgënjimi. Nuk besoj që ka mbetur deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës pa e parë një model të mirë, qoftë të shkollave, apo të ndërmarrësisë apo formave të tjera të zhvillimit në shtetet të cilat ne i quajmë të zhvilluara e të cilat janë atraktive për të rinjtë tanë. E dimë se këto shtete të cilat ne i pëlqejmë, i admirojmë, në sistemin e tyre të edukimit kanë 70 për qind të të rinjve i orientojnë në shkolla profesionale dhe aty jepet mundësia e profesioneve inovative, e që të ne edhe kur ka ndodhur orientime të tilla, ne e dimë ka pasur investime milionëshe nëpër disa vende, qoftë edhe për shkollim të mesëm të lartë profesionalë dhe profesorët e atyre shkollave kanë treguar se nëse në fillim janë regjistruar 200 nxënës, nuk ka shkuar një muaj apo dy, për çdo ditë u ka ikur nga një nxënës dhe me lidhjet partiake ka shkuar nëpër shkolla të tjera, qoftë të medicinës apo më atraktive që i kanë parë për treg të punës. Dhe për këtë fajtor jemi ne.

Edhe ato projekte inovative që ata kanë mundur t'i shfaqin, për fat të keq janë mbytur nga burokracia, nga nepotizmi, edhe siç i kemi përditë e më shumë punësimet politike të cilat me të vërtetë po krijojnë pasiguri. Të rinjtë tanë kanë pasiguri sociale, kanë pasiguri juridike dhe përgjithësisht për jetesë. Ata diskriminohen që nga pranimi në shkollë, ata për të gëzuar një të

drejtë presin deri në 10 vjet nëpër gjykata, e kur drejtësia guxon të flasë, e dini se çfarë ndodh. Ka qenë gjatë kohës së tërheqjes së ambasadorit britanik, i mandatit të kaluar, pati thënë se e pati lënë Kosovën në disa protesta duke mbrojtur disa zyrtarë të lartë të cilët e kanë keqpërdorur detyrën zyrtare dhe milionat, ai pati shprehur habinë. Në vendet e zhvilluara, njerëzit gëzohen kur flet drejtësia, vetëm në Kosovë protestohet dhe njerëzit i dalin në mbrojtje krimi. Unë frikësohem për perspektivën e këtij vendi.

Kështu që kjo për çdo ditë po na bind se ishte një deklaratë reale dhe me të vërtet kjo po i frikëson edhe të rinjtë në përgjithësi. Kur mbrohet në matrapazët, ata që për çdo ditë ia grabisin të ardhmen të rinjve.

Në një studim e pamë dy-tri ditë më parë që prezantoi se 40 për qind të britanikëve, BREXIT-i u ka shkaktuar pasiguri. Ndoshta kjo është edhe një sinjal për të parë se njerëzit që e kanë jetën e balancuar vërtet i shikojnë mirë proceset në të cilat zhyten. Çfarë sigurie kanë kosovarët kur ende dikush në hierarki të lartë, e jo më pak se President, flet për vizatim kufijsh. Faleminderit!

Nëse më lejohet ndoshta edhe një...

KRYESUESI: Mund të vazhdojë se ka kohë edhe një minutë e 45 sekonda.

LIRIE KAJTAZI: ...që u dha nga disa, pa dashur të përsëris pjesën tjetër, ndoshta është mirë të shihet, nuk është e lehtë të implementohet, por meqenëse ne të gjithë e prezantojmë, edhe vetë Agjencia e Statistikave flet që përqindja e popullatës, e rinisë në Kosovë është shumë e lartë sesa ajo e moshuar, ndoshta do të ishte mirë të mos shkohet në shabllonin e aftësisë së punës deri në moshën e pensionimit çfarë e kemi, 65 vjet. Sikur do të ishte mirë një solidaritet i gjeneratave, nëse zbritet për një vit kjo moshë në tregun e punës, do të hynte një pjesë e madhe e të rinjve, si pjesë e perspektivës apo e nxitjes së punësimit të të rinjve. Por mbi të gjitha duhet mbyllur me atë që politikën e drejta dhe orientimi në politika të tilla hap vende pune, hapë perspektivë dhe nuk mashtron qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shemsi Syla.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Në këtë vorbull politik të shoqërisë sonë, ku papunësia shënon rritje bashkë me korrupsionin e nepotizmin, ka krijuar një zhgënjim të madh te qytetarët. Të dëshpëruar, të revoltuar dhe të zemëruar me udhëheqjen institucionale në Kosovë, që e çoi këtë popull drejt zhgënjimit të madh, qytetarët e Kosovës kanë humbur ndjesinë ndaj shtetit që u ndërtua me kaq shumë sakrifica dhe shpëtimin po e kërkojnë jashtë vendit. Kështu Kosova po zbrazet e Qeveria me të madhe po

sistemon militantët partiakë në institucione shtetërore duke forcuar kështu votën klienteliste e duke e mundur edhe reagimin qytetar që nëpërmjet votës do të duhej ta dënonte këtë keqkeqverisje.

Korrupsioni e krimi i organizuar po bëhen mënyrë jetese, kurse mashtrimet, gënjeshttrat, premtimet sociale, arsimore e shëndetësore së bashku me përgjegjësitë e shtetndërtimit po bëhen fjalor i përditshëm premtimesh të rrejshme nga liderët institucionalë.

Të nderuar deputetë,

Pas 11 vjetësh që nga shpallja e pavarësisë, tani ka dalë për fushë e maska që na ka vënë dhe vazhdojnë të na vënë mashtruesit në emër të demokracisë liberale, që në fakt është totalitarizmi demokratik, sepse politika ka pushtuar çdo fushë e çdo anë të jetës shoqërore ku si ideologji kanë luksin, babëzinë e lakminë për pasurim marramendës, duke vjedhur e abuzuar me pushtetin e shtetit.

Kështu, Kosova ia ka hapur derën injorancës, servilitetit e mashtrimit, duke krijuar një kategori njerëzish që po bashkëjetojnë me korrupsionin, servilizmin e konformizmin. Kurse mësuesit dhe edukatorët e kombit, intelektualët, njerëzit e dijes e të shkencës janë bërë shpresë e njerëzve të përvojatur e të pashpresë, duke i shndërruar në shërbyes të vobektë të pushtetit politik.

Të nderuar deputetë,

Qeveritë e deritashme nuk arritën të kenë një sukses në hapjen e perspektivës zhvillimore, në rritjen e punësimit dhe të zhvillimit ekonomik, në reformat e arsimit e shëndetësisë, në politikat sociale, në rend dhe në sundim të ligjit dhe sidomos në tërheqjen e kapitalit të huaj e të investimeve në Kosovë.

Largimi nga Kosova, sidomos i të rinjve, dhe veçanërisht edhe kadrovetë të shkolluara është një dukur që rëndon dhe që konsiderohet plagë për të tashmen, po sidomos për të ardhmen e Kosovës. Kjo dukuri është shprehje e gjendjes jo të mirë ekonomike, e korrupsionit, e nepotizmit, e meritokracisë partiake, që shprehet me humbjen e shpresës dhe e mungesës së perspektivës se këtu mund të jetohet dhe të punohet ndershem, dhe sipas meritave të punës, të djersës dhe të kualifikimit përkatës.

Ikja e të rinjve nga Kosova është fakt i cili nuk duhet të injorohet siç ndodh zakonisht me partitë kur janë në pushtet që ata përpiqen që ta relativizojnë këtë dukuri, herë duke e cilësuar si propagandë të opozitës, e herë, siç po cilësohet sot, si lajm të rremë. Qeveria duhet ta pranojë këtë dukuri dhe të angazhohet për të gjetur mënyra, duke hartuar programe të veçanta për punësimin e të rinjve, që kjo ikje mos të jetë në të ardhmen kaq masive.

Shpërngulja e të rinjve nuk ndalet duke shndërruar shtetin në pronë të oligarkëve dhe klaneve mafioze, që menaxhojnë me politikën sot, ku nepotizmin e kanë bërë transparent dhe pothuajse edhe e kanë shpallur prioritet të qeverisjes. Për ta kthyer shpresën se në këtë vend mund të jetohet ndershëm dhe me dinjitet duhet të zbatohen ligjet, duke pasur barazi në radhë të parë për të gjithë qytetarët pa dallim, jo duke ua mohuar të drejtën për punë, sepse fillimisht duhet të punësohet djali, vajza, vëllai, dajallarët, tezet, tezakët, kunatat e kunetërit, militantët partiakë e të tjerë. Përmes një qeverisje ndryshe duhet të përmbysset ky realitet i trishtueshëm i raportit ekstrem midis të pasurve dhe të varfërve. Shpresa dhe besimi i qytetarëve në këtë shtet rikthehet atëherë kur iu sekuestrohet pasuria gjyqtarëve, prokurorëve, politikanëve, pushtetarëve të çdo niveli që nuk e justifikojnë me të ardhurat e tyre dhe kur aftësia profesionale bëhet kriter themelor për punësim, e jo lidhjet familjare siç është sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Muharrem Nitaj. Regjia, deputeti Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Po dua të jem i shkurtër. Sesa me interes është tema që po flasim, që po diskutojmë sot e dëshmon prania e deputetëve në sallë. Për fatin e keq nuk janë as ata dyzet e sa njerëz e kanë nënshkruar dhe e kanë kërkuar një seancë, edhe atë të jashtëzakonshme, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ajo që dua të them është që u dëgjuan shumë debate. Pjesa dërmuese e tyre për fatin e keq fjalime të lexuara, të përgatitura nuk e di se ku, edhe të shkapërderdhura, një pjesë e madhe e tyre pa ide. Natyrisht me sulme që edhe mund të jenë të natyrshme të kastës qeverisëse në Kosovë.

Ajo që dua të them është se unë besoj që do të pajtoheshin të gjithë në këtë sallë nëse jemi të ndershëm, se për sa i përket migrimit të popullsisë, ose largimit të njerëzve nga Kosova, nuk ka një situatë të re. Situata është shumë më e vjetër, ndoshta është më e vjetër edhe sesa vetë ne. Largimi i njerëzve nga Kosova ka filluar shumë moti. Në vitin 2000 një e treta e popullsisë së Kosovës jetonte jashtë vendit. Për fatin e keq ka vazhduar ky trend edhe pas vitit 2000, edhe pas pavarësisë së Kosovës, herë me ritme më të shpejta, herë me ritme më të ngadalshme dhe fajin nëse mund të themi e kanë të gjitha qeverisjes e derisotme dhe fajin e kanë politikën që janë drejtuar në këtë vend që nga vitit 2000, e në mënyrë të posaçme që nga viti 2008 e këtej.

Tema është shumë e ndejshme, është sensitive. Për ua nuk është shqetësuese largimi njerëzve. Për mua është shqetësues motivi pse ata e lëshojnë vendin. Tema thash është shumë sensitive, mirëpo të provohet për shembull në emër të një teme kaq të ndjeshme dhe në emër të një teme kaq të dhimbshme për popullin e Kosovës, të përfitohen poenë politike dhe të sulmohet një kastë qeverisëse, të sulmohet një njeri, të sulmohet një ministër, të sulmohet një politikë aktuale, unë

mendoj që nuk është e ndershme. Është për t'u habitur se asnjëri prej diskutuesve në këtë sallë, deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk reflektoi dhe askush prej tyre nuk foli për fajin e vet. Asnjëri prej tyre nuk foli për përgjegjësinë eventuale që e kanë pasur, qoftë si deputetë, qoftë si njerëz, qoftë si pjesë të strukturave qeverisëse.

Unë besoj për shembull që, të nderuar kolegë, i nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit, për ta adresuar siç duhet çështjen, e para duhet ta shohim vetën dhe e dyta duhet ta pranojmë përgjegjësinë individuale secili që e kemi.

Ne mund të flasim sa të doni dhe mund të diskutojmë edhe me ditë edhe me javë, mirëpo nuk besoj që do të mund ta zgjidhim problemin e largimit të njerëzve.

Nuk largohen njerëzit pahiri. Njerëzit largohen para së gjithash për shkaqe ekonomike. Për të kërkuar një jetë më të mirë edhe kjo do të vazhdojë pavarësisht se kush do të vijë në Qeveri, cilado strukturë politike nëse do të vijë edhe opozita e sotme nesër, mund të vazhdojë me ritme të njëjta ose ndoshta edhe më të forta deri në momentin që Kosova do të bëhet një vend i jetueshëm në kuptimin e stabilitetit ekonomik, e stabilitetit politik dhe e stabilitetit të funksionimit të rendit dhe ligjit.

Unë nuk po shoh që ky vend ka kapacitete që ta arrijë këtë objektiv. Tani, ndoshta do duhej që debati i sotëm të fokusohet në propozime dhe në ide konkrete se çfarë eventualisht do të mund të bënte Qeveria e Kosovës dhe çfarë do të mund të bënte Parlamenti i Kosovës që ky trend, i cili për mua është i zakonshëm, është po ai që ka qenë në vitin e kaluar, ndoshta edhe më i vogël sesa vitin e kaluar. Është i ngjashëm me vendet e rajonit. Por, thashë është shqetësues për shkak të motiveve të largimit të njerëzve, pra do ishte mirë që ky vend të krijonte sado-kudo një klimë që trendët ishin më të vogla.

Unë po shpresoj që ata njerëz që e kanë nënshkruar të paktën kërkesën për seancë të jashtëzakonshme do të mund të ktheheshin në Kuvend dhe eventualisht do të mund të jepnin kontributin e tyre për miratimin e një dokument që do të votohej në unitet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Hykmete Bajrami s'është në sallë. Fjalën e ka deputeti Imet Rrahmani.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolege deputete,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë do të flas mjaft shkurt në raport me disa të tjerë që detyrimisht u munduan që t'i mbushin 10 minuta fjalim.

E para, dua të rikujtoj sikur që e rikujtuan dy-tre kolegë të mi deputetë parafolës, situatën e qershorit të vitit '99, kur Kosova u ripopullua të themi kështu, pas zbrazjes nga okupatori edhe dhuna që ushtrohej mbi qytetarët e Kosovës.

Ata u kthyen sepse e donin shumë Kosovën. E kanë dashur atëherë e duan edhe sot sepse pati këtu edhe momente kur u vu në dyshim edhe dashuria për vendin. Ata kishin mundësinë në atë kohë kur ishin jashtë Kosovës të jetojnë në kushte shumë më të mira sesa që i prisnin rrethanat e krijuara në atë kohë në Kosovë.

U kthyen dhe shprehen dashurinë e madhe për atdheun, sepse kishin një shpresë. Kishin një shpresë që do të jetonin më mirë. Kishin një shpresë se do të bënin një shtet të vetin të lirë të barabartë për të gjithë, sepse liria dhe barazia iu kishte mohuar me decenie për të mos thënë me shekuj.

Ky besim në shtetin e ri që do të formohej dhe kjo shpresë, ne për 20 vjet që si politikë dhe si qeverisje e vendit nuk arritëm ta kultivojmë dhe ta bëjmë që të kemi një shtet të besueshëm, ku qytetarët do të ishin të barabartë.

Pra, ikja e rinisë është rezultat i humbjes së shpresës për një jetë normale, jo për një jetë më të mirë siç po thuhet. Të thuhet se po jetohej mirë dhe se rinia po kërkon diçka hala më mirë, është gabim.

Qytetarët po kërkojnë një jetë normale, të dinjitetshme dhe të sigurt në vendin e tyre. E kjo mundësi që të jetohej dinjitetshëm dhe kë kihat një perspektivë të sigurt është ngulfatur nga ata që kanë marrë përgjegjësi që do të garantojnë zhvillim ekonomik. Të garantojnë shtet ligjor dhe të garantojnë hapje të mundësive për jetë normale, jo për jetë më të mirë, sepse kosovarët nuk po jetojnë mirë.

Shtetit të cilit po ia kthen shpinën rinia, ata që do të duhej të ishin e ardhmja e tij, nuk ka arritur që për këto 20 vjet t'u ofrojë ngrohtësinë që ofron vendlindja. Ngrohtësinë që e ofron shteti dhe shtëpia dhe të jetuarit në liri.

Pse është kështu, ka shumë shkaqe, por mbi të gjitha është humbja e besimit se politika dhe pushteti nuk e ka vëmendjen te zgjidhja e problemeve bazike të qytetarëve. Dhe kjo është dominante. Kjo është dominante edhe nga qasja që po i bëhet kësaj seance dhe kësaj teme.

Nuk ka më dëshpëruese sesa të përpiqesh që të arsyetosh mungesën e Qeverisë sot në tërësi. Nuk ka më dëshpëruese se të përpiqesh t'i argumentosh mungesat e deputetëve dhe të udhëheqësve të Kuvendit.

Dështimi në zhvillimin ekonomik, shkollimi dhe pajisja e rinisë me diploma që nuk çojnë peshë në tregun e punës kanë shkaktuar një numër të madh të papunëve të dëshpëruar që rrugën e vetme e shohin të ikja jashtë vendit.

Edhe ata pak që kanë fatin të punësohen, çdo ditë i nënshtrohen shkeljeve të të drejtave të tyre në punë, sepse nuk po respektohen ligjet që i kemi sjellë vetë.

Çka do që do të shtojmë vetëm mund t'i përsërisim kolegët e mëhershëm, sepse nuk mund të themi diçka të re dhe që nuk dihet botërisht.

Prandaj, për fund unë bëj thirrje që të bëhemi serioz të gjithë, si politikëbërësit, si ne në Kuvend, si institucionet ekzekutive ato arsimore të drejtësisë, ta bëjmë kthesën e madhe, ta bëjmë shtetin, i cili do të ofrojë siguri dhe barazi për të gjithë.

T'i respektojmë ligjet, ta luftojmë korrupsionin dhe nepotizmin. Të hapim mundësi për shkollime për profesione që janë të përshtatshme për tregun e punës. Të krijojmë lehtësime për investime të jashtme.

Përndryshe, kështu siç është puna dhe nëse vazhdon ky trend, jo që nuk do të ketë punëtorë për investitorë të rinj, po nuk do të ketë punëtorë as për ato biznese që janë brenda vendit, tash dhe në investimet e tanishme.

Derisa t'i bëjmë këto ndryshime që kërkojnë kohë, unë iu kisha bashkuar propozimit të zonjës Lirie Kajtazi, pra si masë emergjente pse mos ta shqyrtojmë edhe përvojën e vendeve të ndryshme të cilat me një vendim kanë pensionuar një numër të caktuar të njerëzve, jo duke i dëmtuar në pagë dhe atë sasinë monetare që do t'ju jepej si kompensim, por thjesht për të liruar vende të punës.

Për të punësuar njerëz me shkollime adekuate dhe për ta zvogëluar papunësinë.

Ky veprim ndoshta do t'i kushtonte materialisht shtetin të Kosovës, por sigurisht do të jetë shumë më i vogël si kosto sesa humbja e përhershme e njerëzve të cilët tash nuk po shkojnë që të kthehen siç thanë edhe kolegët tjerë, por po shkojnë për të jetuar njëherë e përgjithmonë jashtë Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti i fundit i paraqitur është Valon Ramadani.

VALON RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Është për keqardhje fakti që sot 19 vjet pas luftës po mblidhemi për të diskutuar ikjen e të rinjve. Kjo ikje nuk po ndodh thjesht vetëm tani, por arrin kulminacionin muajve të fundit.

Gjendja është alarmante, pasi vetëm gjatë viteve 2013-2017, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, kanë emigruar më shumë se 170 mijë qytetarë. Po përballemi me rënie të fuqisë punëtore e me rruhdjen me të madhe të popullsisë në kohë paqeje.

Ikja ka vite që po ndodh, por në vazhdimësi është mohuar nga Qeveria. Këta të rinj po ikin nga halli, jo nga qejfi. Po ikin për një vend punë dhe jo për turizëm. Po ikin të papunë, por edhe të punësuar, e kjo e bën edhe më të rëndë gjendjen. Përveç shkallës së lartë të papunësisë, ajo që po i detyron këta njerëz të emigrojnë është humbja e shpresë si pasojë e korrupsionit.

Pastaj, familjarizimit në sektorin publik, mungesës së drejtësisë e barazisë.

Të rinjtë e përgatitur profesionalisht, mjekë, infermierë, inxhinierë nuk shohin të ardhme këtu e për këtë kontribuoi secila qeveri deri sot.

Nuk shohin të ardhme sepse u shkatërrua arsimi, shëndetësia e drejtësia. Nuk latë asnjë institucion pa e shtrirë ndikimin, pa punësuar familjarë e pa e shndërruar në pronë partiake.

Ju provuat që ta ngadalësoni këtë ikje, hapet universitete duke menduar se do t'i mbani të angazhuar dhe do ta harrojnë gjendjen reale e nuk do të revoltohen, mirëpo problemi qëndron se kur mbarojnë studimet ata kërkojnë punë, e punë nuk ka.

Të rinjtë e dëshpëruar marrin këtë rrugë sepse kuptojnë se shkollimi i tyre nuk ka kurrfarë vlere, duke qenë se ka kohë që përballemi me depresion ekonomik. Me një sektor privat të shkatërruar e me një sektor publik ku mund të punësohen vetëm tezakët ose fëmijët e politikanëve në pushtet apo militantët partiakë.

Fshatra të tëra po boshatisen. Numri i nxënësve po bie dhe prapë asnjë reagim. A thua jeni aq të paaftë sa për të kuptuar se kjo ikje e kjo rënie në natalitet prej 15,4% do të ketë ndikim të madh në ekonomi.

Nuk ka investitorë seriozë të jashtëm që do të investonte në një vend ku nuk ka fuqi punëtore. Mungesa e fuqisë punëtore do t'i detyronte investitorët të bënin rritje pagash e të humbin fuqinë konkurruese. Po s'patën treg nuk kanë arsye për të investuar.

Kjo ikje si pasojë e nepotizmit e korrupsionit e bën Kosovën një vend të pasigurt për të investuar. Ajo çfarë na duhet është një qeveri që do t'i ndryshonte politikat. Deri sot nuk ka pasur një program qeveritar që ka reflektuar në këtë gjendje.

Opsioni i vetëm i pushtetit është ndërtimi i sa më shumë autostradave. Kosova mund të jetë vendi me më së shumti autostrada në proporcion me territorin dhe popullsinë.

Autostrada nuk e zhvilloi vendin, por e varfëroi. Shtoi korrupsionin dhe i ngriti kompanitë klienteliste të politikës.

Prandaj, Kosovës i duhet një Qeveri që reflekton mbi këtë gjendje të rëndë. Krijon program për luftimin e varfërisë, përmirësimin e arsimit, shëndetësisë dhe lufton krimin e korrupsionin.

Në vend se të kemi një grup shoqëror që ka privilegje dhe mbanë më shumë se një vend pune, duhet të hapen mundësitë për sa më shumë qytetarë.

Zhvillimi i shoqërisë përveç tjerash duhet të synojë ngritjen e dinjitetit të gruas. Këtu duhet zbatuar politika që janë treguar të suksesshme duke e hequr tatimin mbi të ardhurat për gratë. Duke siguruar kredi me normë të interesit të ulët për të sapomartuarit. Duke e ulur moshën e pensionimit, mundësohet prosperitet për qytetarët që me automatizëm ndikon në zhvillim ekonomik.

Mirëpo, është parë tashmë se kjo nuk arrihet me mentalitetin e tashëm politik. Duhet një qeveri ndryshe. E përgjegjshme, e ndërgjegjshme dhe që ka aftësi për krijimin e politikave të mirëfillta ekonomike, e cila kështu do ta respektonë dinjitetin e qytetarit. Prandaj, duhet ndryshim i mentalitetit qeverisës të cilin e ka vetëm Lëvizja Vetëvendosje. Kësisoj, qytetari e ka mundësinë për ta ndryshuar këtë me votën e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e propozuesit të çështjes. Ka pesë minuta kohë për fjalën përfundimtare.

FIDAN REKALIU: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

Dua t'i falënderoj të gjithë ata deputetë të cilët kontribuuan gjatë kësaj seance të jashtëzakonshme. Ashtu siç kërkova unë fillim të seancës, si iniciues i kësaj seance. Ashtu siç kërkova që së bashku nga të gjitha grupet parlamentare politike të cilat janë në Kuvendin e Kosovës, të dërgohet nga një përfaqësues dhe së bashku ta bëjmë një rezolutë unifikuese nga të gjitha grupet parlamentare. Pra, në momentin kur do ta përfundojmë rezolutën bashkërisht me grupet e tjera parlamentare, atëherë do ta njoftojmë Kryesinë e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ne s'kemi kuorum, edhe po ta kishim një tekst unifikuar, kështu që unë detyrohem ta ndërpresë seancën. Mirupafshim në seancën e radhës, e cila do të mbahet nesër, në orën 10:00.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*